FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 115

Tiranë – E mërkurë, 2 gusht 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 168, datë 27.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	14095
Dekret i Presidentit nr. 169, datë 27.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	14095
Dekret i Presidentit nr. 175, datë 28.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	14095
Dekret i Presidentit nr. 176, datë 28.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	14096
Dekret i Presidentit nr. 177, datë 28.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	14096
Dekret i Presidentit nr. 178, datë 28.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	14096
Dekret i Presidentit nr. 179, datë 28.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	14097
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 447, datë 26.7.2023	Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2024–2026	14097
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 26.7.2023	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030	14141
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 468, datë 26.7.2023	Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës	14193
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 474, datë 1.8.2023	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pasurive 1/54 dhe 1/44, me vendndodhje në njësinë administrative Tiranë, zona kadastrale 8160, dhe për disa shtesa në vendimin nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar	14197

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 1.8.2023	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Shkëlqim Agolli.....	14201
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 435, datë 25.7.2023	Për miratimin e "Rregullores për metodologjinë e përcaktimit të masës së dënimit në procesin e inspektimit të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet për subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime rrezatimi jonizues pa licencë"	14201
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 439, datë 25.7.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Kosova.....	14204
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 440, datë 25.7.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Maqedonia e Veriut.....	14206

DEKRET
Nr. 168, datë 27.7.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 8, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Ymer Abdyl Kurpali
2. Sërije Osman Kallabak
3. Vegim Shefqet Bajrami
4. Mustafa Arif Berisha
5. Altin Haki Rexha
6. Mirlind Beqë Rexha
7. Alban Haxhi Hoti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 169, datë 27.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13 si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Enea Thanas Maneka
2. Joli Gjergji Dallamango
3. Amarildo Idriz Tusha
4. Florian Maliq Veshaj
5. Andi Skënder Rexha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 175, datë 28.7.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Besnik Ahmet Binaku
2. Floni Albert Grezda
3. Besart Rrustem Gjuraj
4. Vullnet Zulfi Koçinaj
5. Agim Xhevit Nasimi.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 176, datë 28.7.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Fatos Shefqet Bajrami
2. Asllan Zaim Pulaj
3. Ibrahim Sadik Maçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 177, datë 28.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Neziha Fatmir Pelit (Kapllani)
2. Serida Ylli Canaj (Nazaj)
3. Edison Robert Aliko
4. Kreshnik Luan Hajçe
5. Aria Kreshnik Hajçe
6. Lian Kreshnik Hajçe
7. Deon Kreshnik Hajçe

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 178, datë 28.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93, të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Zamir Kujtim Sadikaj
2. Afrim Cen Sulaj
3. David Nexhat Lami
4. Ardjana Luan Dashi (Goga)
5. Anisa Agron Dashi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 179, datë 28.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Daniela Ilia Shyti
2. Georgios Nikolaos Kentzeas
3. Lefter Sulejman Rami
4. Bora Lefter Rami
5. Niko Pashuk Boga

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 447, datë 26.7.2023

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE PRIORITARE 2024–2026

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2024–2026, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), si dhe të gjitha institucionet e tjera të administratës shtetërore, që janë pjesë e procesit të buxhetimit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

DOKUMENTI I POLITIKAVE PRIORITARE 2024–2026

KRYEMINISTRIA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA SHTETËRORE E PROGRAMIMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS (SASPAC)
Korrik 2023

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
HYRJE
A. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM EVROPIAN 2022–2030
B. KUADRI STRATEGJIK (STRATEGJITË SEKTORIALE/ NDËRSEKTORIALE)
KREU I. REFORMAT AFATMESME DHE AFATGJATA TË QEVERISË SHQIPTARE
Integrimi në Bashkimin Evropian Reforma në Drejtësi
KREU II. PËRPARËSITË AFATSHKURTRA DHE AFATMESME TË QEVERISË
Efektet e pasojave të përgjithshme të krizës energjetike dhe çmimeve të mallrave në aspektin ekonomik dhe social në Shqipëri
Kriza e energjisë dhe kriza në çmimet e mallrave
Paketa e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës
Politika e pagave
Arsimi i lartë
Lufta kundër korrupsionit
Digjitalizimi
Bujqësia
Turizmi
Energjia

PROGRAMET IPA 2022–2027 DHE FUSHAT PRIORITARE TË TYRE
PROGRAMET E BASHKËPUNIMIT ME BANKËN BOTËRORE
KREU III. KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL
Zhvillimet më të fundit makroekonomike
Politikat fiskale
Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm
Përshkrimi i Risqeve financiare
KREU IV. PROGRAME PRIORITARE TË REJA PËR PERIUDHËN 2024–2026
Programi i garancisë rinore
Programi i kodimit për fëmijët e klasave të para (i)
Programi i nxitjes së kodimit për të rinjtë
2024 – Viti i Pyjeve
KREU V. LISTA UNIKE E PROJEKTEVE ME RËNDËSI KOMBËTARE
Akronime dhe shkurtime

Përmbledhje ekzekutive

Hartimi i Dokumenti të Politikave Prioritare është i parashikuar në kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2023, bazuar në VKM-në nr. 172, datë 24.3.2023, i referohet VKM-së nr. 31, datë 27.1.2023, "Për miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2024–2026" si pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar.

Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP), është përgatitur nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), pranë Kryeministrisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me qëllim orientimin e përgjithshëm e racional të drejtimit të procesit të shpërndarjes së burimeve financiare midis sektorëve.

Bazat referenciale për draftimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2024–2026, janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 100 dhe 102;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 16;
- Programi i Qeverisë 2021–2025;
- VKM nr. 172, datë 24.3.2023, "Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2023";
- Udhëzimi nr. 4, datë 20.2.2023 "Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit, mbi bazën e të cilit përcaktohet mënyra dhe procedura e vlerësimit të projektit të investimit publik";
- Plani Kombëtar i Integrimit Evropian 2023–2025, VKM nr. 122, datë 1.3.2023;
- Dokumentet e Kuadrit Strategjik Kombëtar (*Strategjitë Sektoriale dhe Ndërsektoriale, Planet e Veprimit, dokumentet e politikave të miratuara deri në dhjetor 2022 etj.*);
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030;
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026;
- Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030;
- Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022–2025;
- Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027;
- Strategjia Ndërsektoriale Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026;
- Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe plani i veprimit 2022–2029;
- Strategjia Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Miturit 2022–2026;
- Strategjia Kombëtare e Energjisë 2015–2030;
- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030;
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2014;
- Dokumenti i Kontributit Kombëtar të Përcaktuar 2021–2030;
- Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës 2022–2030;
- VKM nr. 594, datë 10.9.2014 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit";
- VKM nr. 412, datë 19.6.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit";
- Korniza e Partneritetit me Bankën Botërore 2023–2027;
- Dokumenti i Përgjigjes Strategjike Kombëtare IPA III 2021–2027 – Shqipëri (2022);
- Prioritetet e Programit IPA 2021&2024;
- Kuadri i Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm me Kombet e Bashkuara 2022–2026;
- Rishikimi Multidimensional i Ballkanit Perëndimor – nga Analiza në Veprim, OECD 2022;
- Prioritetet e Programit IPARD III (*Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural*) 2021–2027;
- Prioritetet e Marrëvështjes së Huasë (2022) midis Këshillit të Ministrave dhe Agjencisë Franceze

për Zhvillim për Mbështetjen e Barazisë Gjinore në Aksesin ndaj Mundësive Ekonomike;

- Programi i Bashkëpunimit Zviceran 2022-2025;

- Programi i Reformave Ekonomike ERP 2023–2025, VKM 116, datë 1.3.2023;

- Dakordësimet e Komitetit të Planifikimit Strategjik, janar 2022 – janar 2023.

Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP) përbën një fazë të ndërmjetme midis kuadrit makro-fiskal trevjeçar dhe përcaktimit të tavaneve buxhetore përkatëse. Tavanet e shpenzimeve për vitet 2024 dhe 2025 janë përcaktuar gjatë PBA 2023–2025. Megjithatë është e vetëkuptueshme, që gjatë kësaj periudhe kohore mund të dalin në pah disa prioritete, të cilat duhet të shqyrtohen nga Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), përpara se të përfshihen në tavanet e PBA.

HYRJE

Përmbajtja e Dokumentit të Politikave Prioritare bazohet në disa dokumente qendrore politikash, me vizionin dhe objektivat e tyre, si: Programi Politik i Qeverisë 2021–2025, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, PKIE 2023–2025, Programin e Reformave Ekonomike 2023–2025, Kuadrin e Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm me Kombet e Bashkuara 2022–2026 dhe angazhimet në përmbushjen e OZHQ-ve. Vlen të përmendet edhe kuadri strategjik i Integrimit të Shqipërisë në BE, në kuptimin e rritjes së harmonizimit të prioriteteve të politikave.

A. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM EVROPIAN 2022–2030

SKZHIE III është koordinuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC). Ky dokument përbën kuadrin e politikave afatgjata më të rëndësishme të Qeverisë Shqiptare, i cili parashtron vizionin e zhvillimit dhe prioritetet strategjike të Shqipërisë, si një ekonomi në nivelin e sipërm të grupit me të ardhura mesatare.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2030 shtrihet në harkun kohor 2022–2030 dhe vijon zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2016–2020 (SKZHI II) në të gjitha fushat strategjike të zhvillimit të Shqipërisë dhe procesit të integrimit të saj në Bashkimin Evropian. Në dallim nga ciklet e mëparshme të kuadrit strategjik, SKZHIE 2030 synon të pasqyrojë prioritetet e zhvillimit në një periudhë relativisht më të gjatë kohore, duke konsideruar:

- Harmonizimin e zbatimit të SKZHIE 2030 me arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), pjesë e Agjendës 2030, për të cilat Shqipëria është plotësisht e angazhuar deri në përfundimin e procesit në vitin 2030;

- Ndërtimin dhe zbatimin e një vizioni afatgjatë për zhvillimin e vendit;

- Shtrirjen deri në vitin 2030 të disa prej strategjive të rëndësishme sektoriale të miratuara, apo në proces përgatitjeje;

- Dobinë e ndërtimit të një kuadri strategjik afatgjatë që ndihmon procesin e integrimit të Shqipërisë në BE brenda një kornize të qartë e të qëndrueshme strategjike;

- mbështetjen e procesit të buxhetimit afatmesëm (PBA) duke ndërtuar projeksione afatgjata të shpenzimeve buxhetore për arritjen e synimeve strategjike dhe objektivave të politikave për zhvillimin e vendit.

Procesi i hartimit të SKZHIE 2030 siç është përmendur më lart është realizuar përmes koordinimit nga ana e SASPAC dhe angazhimit të një numri të konsiderueshëm institucionesh shtetërore ku përfshihen të gjitha Ministritë e qeverisë shqiptare, institucione të pavarura, agjenci të rëndësishme zbatuese të politikave sektoriale, përfaqësues të qeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm të përfshirë.

Përgjatë këtij procesi, SKZHIE III është shoqëruar me konsultime me palët e interesit, shoqërinë civile, përfaqësuesit e biznesit, akademinë dhe organizatat ndërkombëtare të pranishme në Tiranë, mbi çdo fushë politike zhvillimi.

SKZHIE 2022–2030 është dokumenti kryesor strategjik që jep drejtimet dhe përcakton përparësitë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit duke përcaktuar vizionin për zhvillimin e demokracisë, zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit gjatë periudhës 2022–2030 si: *"Shqipëria 2030: "Një ekonomi dinamike, pjesë e Bashkimit Evropian dhe rajonit, që ofron kushte të barabarta për rritjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të saj mbështetur në një demokraci funksionale që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut".*

SKZHIE III paraqet se si ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive të mëposhtme:

- Nxitjen e ritmeve të zhvillimit të vendit, duke gjeneruar rritje ekonomike të qëndrueshme, me fokus të qartë të zhvillimit të gjelbër dhe digjital, përmes një stabiliteti makroekonomik dhe financiar;
- Arritjen e standardeve që u shërbejnë qytetarëve, rritjes së mirëqenies dhe sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre, veçanërisht të rinjve/të rejave dhe vajzave e grave;
- Transformimin e Shqipërisë në një vend me standarde që i përgjigjen anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian;
- Ndërtimin e politikave që rrisin konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike të vendit, duke e integruar denjësisht atë me vendet e rajonit dhe Bashkimit Evropian.

Mbështetur në vizionin për zhvillimin e vendit, SKZHIE III mbështetet në një qëllim parësor që synon integrimin e plotë të vendit në Bashkimin Evropian dhe tre shtylla kryesore:

1. Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë;
2. Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër;
3. Kohezioni social.

Gjithashtu SKZHIE 2030 përcakton edhe përparësitë kryesore të kësaj strategjie në fushat e mëposhtme:

- integrimi evropian;
- lufta ndaj korrupsionit;
- energjia;
- bujqësia;
- turizmi;
- digjitalizimi.

B. KUADRI STRATEGJIK (STRATEGJITË SEKTORIALE/NDËRSEKTORIALE)

Prioritetet e zhvillimit të vendit përcaktohen dhe institucionalizohen përmes kuadrit strategjik, i cili konsiston në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian dhe strategjitë sektoriale/ ndërsektoriale.

Tabela: Kostoja e zbatimit të dokumenteve strategjikë 2024–2026 (në mijë lekë)

Nr.	STRATEGJIA	2024	2025	2026	Totali 2024–2026
1	Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026	10,825,000	8,412,500	2,875,000	22,112,500
2	Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030	44,897,500	44,897,500	44,897,500	134,692,500
3	Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe Plani i saj i Veprimit	10,517,401	11,230,786	11,658	21,759,845
4	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Miturit 2022–2026	334,851	364,042	2,217,599	2,916,491
5	Strategjia Kombëtare e Energjisë 2015–2030	48,604,000	48,604,000	48,604,000	145,812,000
6	Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018–2027	21,882,600	21,882,600	21,882,600	65,647,800
7	Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2019–2031 dhe Plani i Veprimit	8,338,402	7,876,910	7,940,910	24,156,221
8	Strategjia për zhvillimin e biznesit dhe investimeve 2021–2027 dhe të Planit të saj të veprimit	1,200,942	1,200,942	1,200,942	3,602,825
Strategjitë Sektoriale që janë akoma në proces dhe që përfundojnë më 2025					
9	Strategjia kundër krimit të organizuar dhe krimet e rënda 2021–2025	3,590,329	3,626,340		7,216,669
10	Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022–2025	199,986	199,986		399,971

11	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2025 dhe Plani i saj i Veprimit	830,924	830,924		1,661,848
12	Strategjia e Strehimit Social 2016–2025	726,071	726,071		1,452,142
	TOTALI	**152,944,534**	**150,849,130**	**127,751,735**	**431,545,400**

Totali i fondeve të nevojshme për të financuar aktivitetet/masat specifike të strategjive të mësipërme të cilat do të kontribuojnë drejtpërdrejtë në realizimin e objektivave specifikë dhe atyre strategjikë kap vlerën e afro 431.5 miliardë lekë.

KREU I

1.1 REFORMAT AFATMESME DHE AFATGJATA TË QEVERISË SHQIPTARE

1. Integrimi i Bashkimit Evropian

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është synimi politik dhe strategjik i Shqipërisë dhe i sistemeve të saj ligjore, ekonomike dhe institucionale. Procesi i anëtarësimit në BE përfaqëson një mbështetje për demokratizimin e Shqipërisë, konsolidimin e institucioneve dhe të sundimit të ligjit dhe proceseve të vazhdueshme të reformave themelore në drejtim të Bashkimit Evropian dhe anëtarësimit. Qeveria është e vendosur të kryejë përpjekje të qëndrueshme në lidhje me prioritetet kyçe që kanë të bëjnë me reformën gjyqësore, politikën kundër korrupsionit, luftën kundër krimit të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe reformën në administrimin publik (administrata publike në veçanti), të cilat mbeten prioritete edhe në kuadër të procesit të negociatave (sidomos në lidhje me kapitullin 23 dhe 24).

Me vendimin nr. 424, datë 22.6.2022 u miratua Deklarata Hapëse e Republikës së Shqipërisë, Pozicioni i Përgjithshëm, në kuadër të Konferencës së Parë Ndërqeveritare për Anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Më 19 korrik 2022 u zhvillua Konferenca Ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, ku Shqipërisë iu dha formalisht korniza e përgjithshme dhe kuadri negociues për anëtarësimin. Komisioni filloi menjëherë procesin e shqyrtimit dhe që prej shtatorit 2022 ka filluar procesi i shqyrtimit analitik të *acquis* të BE-së (*screening*).

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022, vlerëson se Shqipëria ka bërë progres, të një niveli të caktuar, për 32 nga 33 kapitujt e *acquis*-it të BE, ashtu si edhe në të gjitha kriteret e integrimit në BE. Raporti njeh faktin se qeveria ka vazhduar në rrugën e reformave për integrimin në BE, si edhe përgëzon Shqipërinë për qasjen plotësisht në linjë me BE për çështje të politikës së jashtme dhe sigurisë. Raporti thekson veçanërisht, se Shqipëria ka bërë progres të kënaqshëm dhe të mirë në të gjithë kapitujt e grupimit 1, ose grupkapitulli themelor i procesit të integrimit në BE.

Çdo veprim i ndërmarrë nga Qeveria në kuadër të **reformës së sistemit të drejtësisë** dhe sundimit të ligjit ka për qëllim përfundimtar krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, efikas dhe llogaridhënës në Shqipëri, i cili është në gjendje të ofrojë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente, si dhe për të zbatuar legjislacionin e përafruar me *acquis*-në e BE-së. Strukturat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë ngritur dhe janë funksionale.

Përparim është arritur edhe në reformën e **administratës publike** me plotësimin dhe zbatimin e kuadrit strategjik dhe atij ligjor. Vlerësimi i monitorimit të SIGMA-s për vitin 2021 tregon se Shqipëria është në pararojë krahasuar me fqinjët në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke shënuar vlera më të larta se mesatarja rajonale për të gjashtë parimet kryesore të BE-së për administrimin publik, mbi bazën e të cilave kryhet vlerësimi. Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike është zbatuar plotësisht, duke përmirësuar eficiencën e investimeve publike. Në këtë raport, fusha e prokurimit publik në Shqipëri është vlerësuar me nota të larta në treguesit përkatës duke marrë vlerësim maksimal sa i takon cilësisë së kuadrit ligjor në fushën e prokurimit, kapaciteteve institucionale në nivel qendror për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në fushën e prokurimit në mënyrë efektive dhe eficiente, si dhe sistemit të shqyrtimit të ankesave. Qeveria Shqiptare është e angazhuar për zbatimin e një reforme të mirëfilltë, për trajtimin dhe vlerësimin e bazuar në merita dhe angazhimin e punonjësve duke krijuar një rrjet institucional efektiv dhe efikas që ofron shërbime më të mira për qytetarët.

Lufta kundër korrupsionit është një prioritet kyç i Qeverisë Shqiptare. Drejtimet kryesore të politikës antikorrupsion përfshijnë një sërë veprimesh për parandalimin e korrupsionit, forcimin e institucioneve, monitorimin e përgjithshëm nga organizatat e shoqërisë civile, si dhe dënimin administrativ dhe penal të zyrtarëve të korruptuar. Fillimi i procesit për hartimin e draftit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2023–2030 do të vijoje me tej me kontributin në reduktimin e qëndrueshëm të korrupsionit.

Edhe pse verifikimi i anëtarëve të gjyqësorit është një proces administrativ, progresi në këtë fushë është i rëndësishëm për të vlerësuar Shqipërinë në luftën kundër korrupsionit. Përparim i mirë ka vazhduar përmes konsolidimit të mëtejshëm të përpjekjeve për krijimin e një baze të dhënash të forta për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e çështjeve të nivelit të lartë të korrupsionit.

Për më tepër, Qeveria Shqiptare angazhohet për **mbrojtjen e të drejtave të njeriut** dhe në veçanti për zbatimin e mëtejshëm të politikave kundër diskriminimit, për të përmirësuar situatën në lidhje me të drejtat sociale me fokus të veçantë në grupet e rrezikuara dhe të miturit. Reformat janë në fushën e të drejtave të pronësisë, si dhe në planin e veprimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së për kthimin dhe kompensimin e pronës.

Shqipëria ka ratifikuar të gjitha Konventat mbi *të drejtat e njeriut* në kuadrin e OKB-së, si dhe një sërë Konventash të Këshillit të Evropës. Traktatet dhe konventat ndërkombëtare dhe rekomandimet e organeve monitoruese luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e të drejtave të njeriut. Institucionet kombëtare zbatojnë Kushtetutën dhe kuadrin ligjor për të garantuar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave themelore, si të drejtat politike, ekonomike, dhe sociale. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2017 "*Për mbrojtjen e pakicave kombëtare*" janë hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore të paketës së zbatimit të ligjit.

Metodologjia e re e anëtarësimit kërkon vazhdimësinë e reformave dhe politikave të koordinuara dhe të njëkohshme në të gjithë sektorët, për plotësimin e kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe detyrimeve të MSA-së. Sfidat kryesore lidhen me domosdoshmërinë e: (i) vazhdimit të mëtejshëm dhe thellimit në zbatimin e reformave themelore, duke përfshirë reformën në drejtësi, funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformës së administratës publike; (ii) përmbushjes së të gjitha detyrimeve të MSA-së dhe harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së sikurse kërkohet nga MSA-ja dhe anëtarësimi në BE; (iii) angazhimit të përgjithshëm për finalizimin e procesit *screening*, plotësimin e kritereve për hapjen e negociatave në grupimin themelorët dhe më pas në grupimet e tjera; (iv) koordinimin dhe integrimin vertikal dhe horizontal të politikave dhe reformave të lidhura me procesin e anëtarësimit.

Procesi i integrimit evropian i jep shtysë arritjes së të gjithë Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, pjesë e Agjendës 2030 dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhet me realizimin e Objektivit 16: "Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet" dhe synimit 16.6 "Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet".

2. Reforma në drejtësi

Gjatë viteve të fundit sistemi i drejtësisë ka qenë në qendër të reformave më të thella e njëkohësisht më të rëndësishme në funksion të përmbushjes së standardeve evropiane. Ndryshimet kushtetuese dhe paketa e ligjeve organike të miratuara në kuadrin e reformës së drejtësisë përmbajnë dispozita të përcaktuara qartë që garantojnë pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin, integritetin e sistemit gjyqësor, si dhe përmirësimin e mekanizmave llogaridhënës dhe monitorues të funksionimit të saj. Në kuadër të kësaj reforme, një hap vendimtar shënoi ngritja e organeve të qeverisjes së gjyqësorit, si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, si dhe u krijua një kuadër institucional i plotë për hetimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar që përfshin Prokurorinë e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Byronë Kombëtare të Hetimit, si dhe Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe atë të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2025 pasqyron fazën e dytë të Reformës në Drejtësi duke synuar gjatë periudhës së shtrirjes, konsolidimin e kuadrit institucional, zbatimin e politikave moderne evropiane në drejtësinë penale, përmirësimin e

infrastrukturës së sistemit të drejtësisë dhe mundësi të reja për teknologjinë e informacionit, përfshi zgjidhje inovative elektronike, që mbështesin një rritje thelbësore të efikasitetit dhe transparencës në sistemin e drejtësisë.

Në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025, pasqyrohen qëllimet dhe objektivat për promovimin e shtetit të së drejtës në nivel kombëtar e ndërkombëtar dhe qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë; zhvillimin e institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet; sigurimin e vendimmarrjes së përgjegjshme, përfshirëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet; garantimin e qasjes në informacionin zyrtar; mbrojtje të të drejtave themelore në përputhje me legjislacionin vendas dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë më 12 tetor 2022, Shqipëria ka bërë përparim të mirë, veçanërisht përmes zbatimit të vazhdueshëm dhe konsolidimit të reformës gjithëpërfshirëse në drejtësi.

Me gjithë arritjet tepër të rëndësishme, jetësimi me sukses i Reformës në Drejtësi kërkon vëmendje të shtuar gjithashtu edhe mbi përgjegjësitë që burojnë për institucionet e përfshira, të cilat kërkojnë përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve sipas standardeve Evropiane, si dhe përmirësimin e infrastrukturës së sektorit dhe krijimi i një baze të dhënash elektronike për gjyqësorin të cilat ndikojnë në rritjen e efikasitetit, llogaridhënies, forcimit të besimit të publikut dhe transparencës në këtë sektor duke ndihmuar edhe eliminimin e *backlog*-ut. Zbatimi i fazës së mëtejshme deri më 2030 do të përqendrohet në ofrimin e shërbimeve në sektorin e drejtësisë në nivelet e standardeve evropiane dhe do të synojë të eliminojë *backlog*-un dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Vizioni "Shqipëria një shtet me një sistem drejtësie të bazuar në llogaridhënie, transparencë që garanton pavarësi e qëndrueshmëri dhe ofron shërbime të ngjashme nga sektori i drejtësisë të BE-së" do të jetësohet përmes katër qëllimeve të politikës:

- Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficiencën dhe llogaridhënien;

- Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane;

- Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit;

- Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjitha institucionet e sektorit.

Reforma në Drejtësi lidhet me Agjendën 2030 në kuadër të realizimit të Objektivit 16: "Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet" dhe synimit 16.6 "Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet" dhe 16.10 "Sigurimi i aksesit të publikut në informacion dhe mbrojtja e lirive themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare."

KREU II
2.1 PËRPARËSITË AFATSHKURTRA DHE AFATMESME TË QEVERISË

Efektet e pasojave të përgjithshme të krizës energjetike dhe çmimeve të mallrave në aspektin ekonomik dhe social në Shqipëri

Paqartësia lidhur me efektet e goditjes së fundit nga kriza e energjisë dhe rritja e çmimeve në ekonominë tonë mbetet ende e lartë. Por me siguri impakti në ekonomi do të jetë i konsiderueshëm. Aktualisht ne parashikojmë një rritje prej rreth 3.2% për këtë vit dhe rreth 3% për vitin tjetër, nga respektivisht rreth 4% që parashikohej për secilin vit përpara kësaj goditje. Sidomos parashikimi i rritjes për vitin tjetër rrethohet nga një paqartësi e lartë. Nëse disa prej ekonomive kryesore botërore, përfshirë edhe një pjesë të atyre të BE-së, do të kalojnë në një recension gjatë vitit që vjen, atëherë ka shumë të ngjarë që edhe rritja për ekonominë tonë të jetë ndjeshëm më e ulët se sa 3%. Por megjithatë, deri më tani skenari për një recension të

ekonomisë sonë gjatë vitit që vjen duket ende me pak gjasa të ndodhë.

Efekt i rëndësishëm për financat publike është gjithashtu rritja e ndjeshme e kostos së borxhit (shpenzimet për interesa) sidomos për vitet në vijim, në kushtet e realizimit të huamarrjes në kushte të shtrënguara të tregjeve financiare dhe me norma të rritura interesi si në tregjet ndërkombëtare ashtu edhe në tregun e brendshëm.

Përveç rritjes së kostos së borxhit, efekti i të cilës vlerësohet të shtrihet në afatgjatë, efektet e krizës u ndien gjithashtu edhe në procesin e huamarrjes së realizuar gjatë vitit 2022, ku ka pasur një kërkesë më të ulët për letrat me vlerë të borxhit të qeverisë në tregun e brendshëm, si rezultat i një niveli pasigurie të lartë në tregje dhe pritshmërive për rritje të normave të interesit, shkaktuar nga zhvillimet e konfliktit Rusi–Ukrainë. Financimi i ri, i siguruar gjatë vitit 2022, ishte më i ulët krahasuar me vitin e kaluar dhe me nivelin e pritshëm të huamarrjes për t'u realizuar gjatë 2022. Megjithatë, realizimi i një huamarrje më të ulët nga ajo e pritshme për periudhën në fjalë, nuk ka ndikuar në financat publike duke qenë se kjo periudhë është karakterizuar nga zhvillime pozitive në drejtim të të ardhurave buxhetore dhe një nivel i mjaftueshëm likuiditeti. Pra, efekti i mosrealizimit plotësisht të huamarrjes gjatë vitit, është kompensuar nga të ardhurat shtesë që kanë ardhur prej efektit të rritjes së përgjithshme të çmimeve, e cila ka bërë të mundur që të shmangen rregullime të forta fiskale (pra, ka shmangur shkurtime të forta që do duhej të ishin bërë dhe madje edhe një zgjerim të disa shpenzimeve si për paketë sociale apo për kompensimin e kostove të investimeve publike, nëse këto të ardhura shtesë nuk do të ishin).

Masat që do të ndërmerren në vijim për përballimin e krizës së çmimeve:

Në buxhetin 2023 është parashikuar mbështetja e sektorit energjetik me 12 miliardë lekë, duke ruajtur të pandryshuar çmimin për konsumatorët familjarë brenda një fashe të caktuar, në përputhje me kushtet dhe gjendjen financiare të kompanive prodhuese.

Kriza e energjisë dhe kriza në çmimet e mallrave

Kriza energjetike filloi të jepte efektet e saj në tremujorin e fundit të vitit 2021. Për këtë arsye ndërhyrjet në buxhet filluan në vitin 2021 dhe vijojnë ende në buxhetin 2022. Ndërkohë kriza e çmimeve të mallrave të tjera u ndikua nga efektet e agresionit rus në Ukrainë. Këto faktorë kanë ndikuar në ndryshimin disa herë të buxhetit të shtetit duke fokusuar masa specifike në sektorët e prekur.

Rishikimet e buxhetit për t'iu përgjigjur krizës energjetike dhe krizës nga çmimet e mallrave:

FONDET PER PERBALLIMIN E KRIZES SE ENERGJISE DHE ÇMIMEVE ne 000/l

VITET	EMERTIMI	SHTESAT E FONDEVE	FONDI TOTAL
Viti 2021	**Akti Normatin nr. 31 date 27.10.2021**	**10,000,000**	**10,000,000**
	Mbeshtetje per energjine nepermjet instrumentit te garancise sovrane		
Viti 2022	**Ligjin Fillestar me nr. nr.115/2021 "Për Buxhetin e vitit 2022"**	**8,000,000**	**41,770,000**
	Hua per sektorin energjitik		
	Akti Normativ nr. 3, datë 12.03.2022	**26,000,000**	
	Mbeshtetje buxhetore per sektorin energjitik	*20,000,000*	
	Kontigjence per paketen e Rezistences sociale ndaj pasojave te krizes	*6,000,000*	
	Akti Normativ nr. 12, datë 29.07.2022	**7,770,000**	
	Kontigjence per paketen e Rezistences sociale ndaj pasojave te krizes	*6,100,000*	
	Shtese per perballimin e kompesimit financiar te cmimeve te mat te ndertimit	*1670000*	

Paketa e mbështetjes për sektorin energjetik lidhet me Agjendën 2030 në kuadër të realizimit të Objektivit 7: "Sigurimi i furnizimit me energji me kosto të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë" dhe synimit 7.1 "Deri në vitin 2030, sigurimi i aksesit universal në shërbime energjie me kosto të përballueshme, të besueshme dhe moderne".

Paketa e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës

Paketa e rezistencës sociale kompenson rritjen e çmimeve të shportës për pensionistët sipas kategorive të përcaktuara, familjet në skemën e ndihmës ekonomike, si dhe personat me aftësi të kufizuar. Gjithashtu ofron mbështetje për fermerët dhe bizneset e vogla, si dhe financon mburojën e çmimit të energjisë për konsumatorët familjarë dhe bizneset e vogla.

Paketa e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës, prej 6 miliardë lekë u përdor si më poshtë:

- Fondi prej 5 miliardë lekë është përdorur me anë të **VKM-së nr. 159, datë 12.3.2022** "*Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë*", konkretisht:

- MSHMS-ja iu akordua fondi prej 1.116 miliardë lekë për mbështetjen e kategorive që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagesë të aftësisë së kufizuar dhe specifikisht:

- familjet dhe individët përfitues të ndihmës ekonomike, të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 57/2019, "Për ndihmën sociale në Republikën e Shqipërisë";

- individët përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c", të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, "Për ndihmën sociale në Republikën e Shqipërisë";

- individët që marrin statusin, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i ndryshuar;

- individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", i ndryshuar;

- MFE për ISSH-nw, u akordua fondi prej 3.883 miliardë lekë për mbështetjen e kategorive të personave që përfitojnë pensione dhe specifikisht:

- personat që përfitojnë pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

- personat që përfitojnë pension familjar, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

- personat që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe masa e pensionit mujor të tyre është më e ulët ose e barabartë me 50% të pagës minimale neto në shkallë vendi;

- kryefamiljarët, të cilët përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të përfitojnë dëmshpërblim për efekt të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.

- Me anë të VKM-së nr. 225, datë 13.4.2022, *"Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë",* u miratuakompesimi i shoqërive të transportit për linjat qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse në masën 100 lekë për litër, për një periudhë tre mujore, mars prill, maj 2022. Efekti financiar është në vlerën 430 000 000 lekë.

- Nëpërmjet VKM-së nr. 245, datë 20.4.2022 *"Për disa ndryshime në VKM-në nr. 101, datë 9.2.2022 "Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022",* u miratua akordimi i 500 milionë lekë shtesë për mbështetjen e sektorit të bujqësisë, për t'u përdorur në skemën mbështetëse të naftës.

- **Nëpërmjet aktit normativ nr. 12, datë 29.7.2022** "Për disa ndryshime në ligjin nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022, i ndryshuar", u miratua:

· Shtrirja e financimit të paketës së parë të ndihmës për konsumatorët, të akorduar përmes AN nr. 3/2022, me qëllim përballimin e mëtejshëm të pasojave të rritjes së çmimeve të konsumit, nëpërmjet alokimit sërish të një fondi kontigjencë për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj pasojave të krizës, me kosto 6.1 miliardë lekë;

- Reflektimi në kahun e të ardhurave të një rritje në masën 30 miliardë lekë, duke u bazuar në performancën pozitive të realizimit të të ardhurave tatimore dhe doganore për 7 mujorin 2022;

Gjithashtu, në reflektim të rritjes së ndjeshme të çmimeve të materialeve të ndërtimit dhe si përgjigje ndaj ngadalësimit të investimeve në fushën e investimeve publike, u miratua **akti normativ nr. 10, datë 18.5.2022, *"Për kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022",*** i cili siguron mbështetje për të gjithë

kontraktorët që kanë në zbatim kontrata për pune publike. Në aktin normativ nr. 12, datë 29.7.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022, i ndryshuar" në buxhetin e MFE është vendosur një fond prej 1,67 miliardë lekë për të përballuar kostot e mundshme që rrjedhin nga Akti i mësipërm që nuk janë të munduara të përballohen brenda buxheteve aktuale të ministrive.

Nëpërmjet paketës së dytë janë mbështetur disa kategori:

1. Është realizuar indeksimi i pagesës së paaftësisë duke filluar nga **1 shtatori 2022**, ndihmës ekonomike dhe disa përfitimeve të tyre me kosto vjetore 1,8 miliardë lekë;

2. Është realizuar indeksimi i pensioneve duke filluar nga **1 tetori 2022** në masën 6% me kosto vjetore rreth 8,4 miliardë lekë për një vit të plotë, (kosto për vitin 2022 rreth 2 miliardë lekë);

3. Është realizuar rritja e pagave për administratën publike duke filluar **nga 1 tetori 2022** me kosto që mbulohet nga racionalizimi i strukturave organike, duke u fokusuar kryesisht në vendet vakante;

4. Rritja e pagave duke filluar nga **1 tetori 2022** në disa sektorë mesatarisht 7% (polici, burgje, gardë) me kosto vjetore rreth 3,3 miliardë lekë, përfshirë edhe administratën publike;

Paketa e rezistencës sociale lidhet me shumë objektiva të Agjendës 2030 dhe më drejtpërdrejt në kuadër të realizimit të Objektivit 1: "Dhënia fund e varfërisë në të gjitha format e saj në të gjithë botë." dhe synimit 1.3 "Zbatimi i sistemeve të duhura të mbrojtjes sociale dhe masave për të gjithë, duke përfshirë dyshemetë dhe, deri në vitin 2030, arritja e mbulimit real të të varfërve dhe personave të cenueshëm".

Politika e pagave

Qeveria do të vazhdojë të ketë në vëmendje rritjen e pagave në sektorin publik. Paga minimale do të jetë 45,000 lekë në vitin 2025.

Qeveria do të marrë përsipër të zbusë efektet e rritjes së pagës minimale, të kostove që kanë punëdhënësit për të punësuarit e tyre. Kjo do të sjellë edhe reflektim në të gjithë piramidën e pagave sepse në vitet e fundit është konstatuar një ngjeshje e pagave duke e ulur motivimin e punonjësve për të avancuar në karrierë.

Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet pagave në ata sektorë që ku ka prirje më të mëdha për t'u larguar nga vendi, si dhe në ata sektorë me rëndësi jetike për zhvillimin e vendit dhe sigurinë kombëtare. Pagat e mjekëve specialistë do të rriten ndjeshëm.

Për të punësuarit në sektorë të caktuar me interes strategjik për zhvillimin e vendit do të mbështeten me ligj të veçantë. Qeveria do të mbështesë financiarisht edhe strehimin e të punësuarve në sektorë të caktuar për të plotësuar mbështetjen financiare të familjarëve të tyre.

Qeveria Shqiptare po përgatit paketën e plotë të akteve në mbështetje të strehimit të kategorisë "administrata shtetërore". Numri më i madh i kuotave për strehim për vitet 2024–2026, do të jetë për punonjësit e sistemit shëndetësor (mjekë), punonjësit e policisë së shtetit dhe ushtarakët.

Reforma e plotë e pagave që po ndërmerret, e shtrirë përgjatë dy viteve arrin një kosto prej rreth 39 miliardë lekë dhe përfitojnë 130 mijë punonjës.

Kjo kosto shtesë planifikohet që të akomodohet nga rritja e të ardhurave nëpërmjet politikave të reja fiskale, duke shfrytëzuar hapësirat e deficitit i cili detyrimisht përcaktohet mbi rregullat fiskale të Lob-it, si dhe duke rialokuar shpenzimet. Akomodimi i kostos së personelit do të jetë një prioritet i reformës.

Paga mesatare në administratën buxhetore qendrore, nga 71.630 lekë aktualisht, pas rritjes së parashikuar shkon rreth 107.257 lekë/muaj ose rreth 900 euro/muaj në fund të vitit 2024 (307 euro më shumë se viti 2022).

Pagat e mjekëve, infermierëve, mësuesve, oficerëve të policisë dhe ushtarakëve do të rriten 20–60 për qind.

Disa nga ndryshimet sipas profesioneve prekin:

- Mjek i përgjithshëm	131,672 lekë më 2024-n
- Mjek specialist	174,101 lekë më 2024-n
- Infermier	87,118 lekë më 2024-n
- Ushtar profesionist	77,000 lekë më 2024-n
-Mësues në arsim bazë	95,550 lekë më 2024-n
- Mësues në arsim të mesëm	106,800 lekë më 2024-n
- Drejtues shkolle	168,000 lekë më 2024-n
- Inspektor i parë në polici	97,500 lekë më 2024-n
- Zjarrfikës	80,000 lekë më 2024-n

Politika e pagave lidhet me shumë objektiva të Agjendës 2030 dhe më drejtpërdrejt në kuadër të realizimit të Objektivit 8: "Nxitja e rritjes ekonomike të pandërprerë, përfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë e produktiv dhe punës së denjë për të gjithë" dhe synimit 8.5 "Deri në vitin 2030, arritja e punësimit produktiv dhe punës së denjë për

të gjitha gratë dhe burrat, përfshi të rinjtë/të rejat dhe personat me aftësi të kufizuar, si dhe pagë e barabartë për punë me vlerë të barabartë".

Arsimi i lartë

Sot në Shqipëri funksionojnë 15 institucione publike dhe 27 jopublike të arsimit të lartë ose 14 institucione për 1 milion banorë që është në nivelin e disa vendeve të rajonit, por mbi nivelin e Bashkimit Evropian – 7 IAL për 1 milion banorë.

Shqipëria është e angazhuar të përmbushë të gjitha angazhimet e procesit të Bolonjës duke qenë shumë aktive në *Bologna Follow-Up Group (BFUG*), si dhe të kontribuojë në këtë proces nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe të ndryshme pune/ këshilluese të BFUG.

Struktura e të diplomuarve në Shqipëri ka shpërndarje të ngjashme me atë të të diplomuarve në vendet e BE-së. Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë vajzat në vitin 2019 janë "Arsim" me 81.4 për qind, ndjekur nga "Shëndet dhe mirëqenie" me 79.1 për qind dhe "Arte dhe shkenca humane" me 78.2 për qind. Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë djemtë janë "Shërbime" me 73.6 për qind, "Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim" me 62.6 për qind, dhe "Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari" me 55.1 për qind.

Përveç praktikës së ofruar nga institucionet e arsimit të lartë ku studentët kanë kryer studimet, studentëve dhe profesionistëve të rinj deri në moshën 26-vjeçare u mundësohet pjesëmarrja në Programin Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, dhe institucionet e tjera publike për profesionistë të rinj.

Do të vazhdojë mbështetja për **Paktin për Universitetin**, si një nga angazhimet prioritare të Qeverisë Shqiptare për të adresuar probleme të përgjithshme të institucioneve të arsimit të lartë, si edhe probleme specifike për çdo universitet- bazuar në informacionet, opinionet, idetë e sugjerimet e mbledhura përgjatë procesit të vazhdueshëm të dialogut.

Gjithashtu do të vijojë mbështetja për të gjitha institucionet e arsimit të lartë.

Kolegji i Evropës, një universitet me reputacion mjaft të lartë, do të hapë një kampus të ri në Tiranë. Pasi kampusit në Bruges në Belgjikë, Kolegji i Evropës hapi kampus në Varshavë në Poloni për të mbështetur ato vende që të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian, tani do të hapë një kampus në Shqipëri.

Universiteti është institucioni më i përfaqësuar në mesin e nëpunësve civilë të BE-së, dhe sipas një renditjeje të diplomuarit e tij përfshijnë shumë drejtues të BE-së. Universiteti financohet pjesërisht nga BE-ja dhe qeveritë e tjera kombëtare.

Kampusi i ri do të financohet nga Komisioni Evropian. dhe aplikimet për studentët parashikohet që të hapen në shtator 2023.

Politika e arsimit të lartë lidhet me Agjendën 2030 në kuadër të realizimit të Objektivit 4: "Sigurimi i arsimit përfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë" dhe synimit 4.3 "Deri në vitin 2030, sigurimi i aksesit të barabartë për të gjitha gratë dhe burrat në arsim cilësor teknik, profesional dhe të lartë, përfshirë edhe universitetin".

Lufta kundër korrupsionit

Lufta ndaj korrupsionit është një nga prioritetet kryesore të qeverisë dhe përbën njëkohësisht një shtysë të rëndësishme të reformës në drejtësi ndërkohë që arritjet e kësaj reforme kanë dhënë rezultate pozitive në këtë drejtim. Korrupsioni paraqet një sfidë në nivel kombëtar pasi prek shoqërinë në mënyra të ndryshme, duke sjellë pasoja negative si në jetën ekonomike, ashtu edhe në atë sociale të qytetarëve. Në raste të caktuara, korrupsioni ka ndikuar edhe në integritetin e besimin në raport me institucionet shtetërore. Qëllimet e politikës në strategjinë kundër korrupsionit kanë synuar rritjen e efektivitetit në parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin lidhur me korrupsionin.

Parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentet ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj.

Modernizimi i shërbimeve dhe konsolidimi i infrastrukturës digjitale, për të siguruar ofrimin digjital të të gjitha shërbimeve të mundshme për qytetarët, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimit, si një instrument i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm për parandalimin e korrupsionit ka dhënë rezultate pozitive. Në drejtim të vazhdimit të reformave dhe forcimit të kapaciteteve institucionale kundër korrupsionit, programi parashikon objektivin e

qeverisë për rritjen e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë nëpërmjet digjitalizimit të sistemit, si dhe zgjerimin dhe fuqizimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit përmes rishikimit të bazës ligjore, riorganizimit të kompetencave dhe ngritjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit pranë Ministrisë së Drejtësisë me një rrjet të gjerë koordinatorësh në 44 institucione publike në vend.

Lufta ndaj korrupsionit përbën një qasje horizontale e cila përfshin sektorë si transparenca, prokurimet publike, shërbimet elektronike, inspektimet dhe kontrollet financiare në administratën publike, integritetin e autoriteteve publike qendrore dhe vendore, bashkëpunimin e autoriteteve ligjzbatuese, si edhe ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut kundër korrupsionit.

Për të garantuar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e politikave për reduktimin progresiv të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e qeverisjes së mirë, qeveria shqiptare do të hartojë dhe miratojë një strategji të re kundër korrupsionit për periudhën 2023–2030. Vizioni i saj është pasja e institucioneve publike që funksionojnë në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike dhe ofrojnë shërbime eficiente ndaj qytetarëve. Duke njohur përhapjen dhe qëndrueshmërinë e korrupsionit, strategjia e re do të zgjerojë shtrirjen e saj nga një qasje ndërsektoriale në një qasjeje kombëtare, gjithëpërfshirëse dhe të integruar.

Raportet ndërkombëtare të publikuara gjatë viteve të zbatimit të SNKK kanë bërë vlerësime të luftës kundër korrupsionit në vend. Në raportin më të fundit të vlerësimit, nga GRECO, 2020, Shqipëria ka arritur 9 nga 10 rekomandime të dhëna. Referuar Progres Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2021, Shqipëria ka bërë progres në forcimin e luftës kundër korrupsionit. Janë arritur rezultate të prekshme në luftën kundër krimit të organizuar, duke përfshirë rritjen e bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së dhe Europolin – një kusht për IGC-në e parë, e cila vazhdon të përmbushet.

Struktura e Specializuar Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), e përbërë nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, është funksionale - kusht për IGC-në e parë, i cili vijon të plotësohet. Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit në përgjithësi është në rrugën e duhur. Vettingu i anëtarëve të drejtësisë ka sjellë rezultate në luftën kundër korrupsionit.

Lufta kundër korrupsionit lidhet me Agjendën 2030 në kuadër të realizimit të Objektivit 16: "Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet" dhe synimit 16.5 "Ulja në mënyrë të konsiderueshme e korrupsionit dhe mitëmarrjes në të gjitha format e tyre".

Digjitalizimi

Teknologjitë e informacionit dhe telekomunikimit kanë çelur mundësi dhe oportunitete të reja të paimagjinueshme deri disa dekada më parë. Këto teknologji të reja të zhvilluara shumë vrullshëm janë mundësi për më shumë zhvillim, mirëqenie dhe demokratizim, por njëherazi paraqesin rreziqe që mund të krijojnë hendeqe të reja midis vendeve e civilizimeve të ndryshme apo edhe midis vetë shtresave të ndryshme të shoqërisë së një vendi, duke mbarsur konflikte potenciale sociale apo midis shteteve.

Zhvillimi i infrastrukturës digjitale, rrjeteve të telekomunikacionit/komunikimeve elektronike të shpejta dhe shumë të shpejta është një domosdoshmëri për të mbështetur gjithë transformimin digjital të ekonomisë dhe zhvillimet inovatore në sektorë strategjikë si energji, transport, industri, edukim, arsim etj., si dhe përmirësimin rrënjësor të cilësisë së shërbimeve publike. Qeveria Shqiptare ka vazhduar promovimin e TIK në sektorë të ndryshëm, duke prezantuar dhe implementuar strategji dhe politika të ndryshme të cilat e kanë TIK në fokusin e tyre, zhvillimin e shoqërisë së informacionit, agjendën digjitale dhe zhvillimin e *Broadband*-it.

Nevoja jetike për ndërlidhjen digjitale, për rrjete të telekomunikacionit fikse dhe të lëvizshme që ofrojnë lidhje me internet të shpejtë dhe të sigurt doli më në pah në kushtet e pandemisë COVID-19 me rritjen e dukshme të kërkesës për mundësimin e ofrimit të mësimit online, vazhdueshmërinë e punës si në institucione dhe nga biznesi. Zhvillimi i infrastrukturës digjitale *broadband*, 5G, tarifat e *roaming-ut* dhe në tërësi komponentët e integrimit digjital janë pjesë e angazhimeve rajonale të Ballkanit Perëndimor (BP) në Planin e Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal 2021–2024 (CRM). Agjenda Digjitale për Ballkanin Perëndimor, si një përpjekje

e përbashkët e partnerëve të Ballkanit Perëndimor (BP) dhe Komisionit Evropian (KE) është prezantuar si një nga gjashtë iniciativat e Komunikatës mbi një perspektivë të besueshme të zgjerimit dhe angazhimin e BE-së me Ballkanin Perëndimor.

Qasja në informacion të paanë është sot më e lehtë se kurrë, por teprimi me informacion të pasigurt apo të rremë mbart rrezikun e deformimeve zhvillimore, sociale dhe kulturore. Shqipëria ka arritje të ndjeshme, të evidentuara edhe ndërkombëtarisht, në rritjen e mundësive digjitale që ka ofruar në vitet e fundit për sipërmarrjet dhe qytetarët e saj, por që ende është prapa në rezultatet digjitale, sidomos në sektorin privat.

Portali *e-Albania* u shërben mbi 2.6 milionë qytetarëve dhe 221,074 bizneseve (2.8 milionë të regjistruar) pa asnjë kosto shtesë, pa pritur në radhë dhe pa pasur asnjë kontakt fizik me punonjësit apo administratën. Janë bërë mbi 40 milionë aplikime për shërbime elektronike kryesisht në shërbime të gjendjes civile, turizëm, kulturë dhe art, financë dhe ekonomi, shërbime sociale, arsim, punë të jashtme etj. Për sa i përket qeverisjes elektronike dhe ofrimit të shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe bizneset, si treguesi kryesor i ofrimit të shërbimeve është arritur që 95 për qind e të gjitha shërbimeve publike të ofrohen vetëm online. Në e-Albania aktualisht ofrohen 1,227 shërbime elektronike vetëm on-line.

Nga data 1 maj 2022, të gjitha shërbimet publike ofrohen vetëm on-line duke përmirësuar cilësinë e shërbimit, shmangur korrupsionin dhe abuzimin dhe rritur kërkesën e llogarisë. Të vetmet zyra të hapura për qytetarët janë ato që ofrojnë shërbime që e kanë të domosdoshme për praninë fizike të qytetarit (martesa, regjistrimi i gjurmëve të gishtave gjatë aplikimit për pasaportë etj.) ose automjetit (kontroll teknik etj.).

Zhvillimi i sektorit digjital do të mbajë në konsideratë 4 çështje që konsiderohen kyçe:

- Rritjen e aksesit në teknologjitë digjitale qoftë nga pikëpamja e penetrimit gjeografik, po ashtu edhe nga pikëpamja e përballueshmërisë financiare;
- Aftësitë digjitale jo vetëm të nxënësve, të rinjve/të rejave, profesionistëve të sektorit por edhe të popullsisë në moshë madhore;
- Mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian;
- Sigurinë kibernetike në bashkërendim me partnerët tanë strategjikë euroatlantikë.

Situata e zhvillimit të infrastrukturës digjitale dhe ndarja e theksuar midis zonave urbane dhe rurale, tregon nevojën e lartë për investime të rëndësishme për zhvillimin e infrastrukturës digjitale *broadband* dhe se investimi nga sektori privat në zhvillimin e rrjeteve, në veçanti në zonat rurale dhe të largëta, është i pamjaftueshëm. Vizioni për zhvillimin e infrastrukturës digjitale "*Shqipëria me infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit*" mbështetet në objektivat strategjike që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës broadband, reduktimi i ndarjes digjitale dhe ofrimi i shërbimeve *broadband* gjithëpërfshirëse, dhe rritjen e kërkesës për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe një shoqëri Gigabit.

Digjitalizimi si një qasje horizontale ka efekte shumëdimensionale në thuajse të gjithë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 por më drejtpërdrejt efektet e tij lidhen në kuadër të realizimit të Objektivit 9: "Ndërtimi një infrastrukture të fortë, nxitja e industrializimit përfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit" dhe synimit 9.c "Rritja e ndjeshme e aksesin ndaj teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe përpjekje për ofrim aksesi universal dhe të përballueshëm në internet në vendet më pak të zhvilluara deri në vitin 2020".

Bujqësia

Zhvillimi ekonomik në zonat rurale karakterizohet nga një mbizotërim i aktivitetit ekonomik nga bujqësia, sektor i cili dominohet nga fermat e vogla dhe familjare. Këto njësi ekonomike luajnë rol të rëndësishëm për sigurimin e ushqimit të popullsisë shqiptare, si dhe për uljen e varfërisë në zonat rurale, por ato janë të integruar në mënyrë të pamjaftueshme në zinxhirët e shkurtër të furnizimit. Në periudhën 2020–2022, edhe falë integrimit të një pjese të rëndësishme të fermerëve në skemat kombëtare të mbështetjes ku mbështetja ndaj naftës ka pasur një rol thelbësor, numri i fermerëve që zotërojnë një NIPT fermeri është rritur ndjeshëm.

Madhësia e vogël e fermës tipike prej 1.2 ha, kombinuar me fragmentimin e tokës janë sfida kryesore për rritjen dhe konkurrencën e sektorit të bujqësisë ndonëse fermat familjare luajnë rol kritik për sigurinë ushqimore të popullsisë shqiptare, si dhe për rritjen e mirëqenies në zonat rurale. Bujqësia

kontribuon në 18.36% të prodhimit të brendshëm bruto dhe punëson 33.6% të fuqisë punëtore në vend. Agropërpunimi është rritur ndjeshëm gjatë 10 vjetëve të fundit duke arritur në 24.4% të xhiros totale të bujqësisë. Tendencat pozitive dëshmojnë se sektori ka potencial të lartë për zhvillim dhe krijimin e vendeve të punës. Zonat rurale kanë gjithashtu një potencial të lartë për turizmin e qëndrueshëm të bazuar në natyrë, por i cili po vlerësohet dhe lidhet me sektorët e tjerë të ekonomisë lokale. Sektori i turizmit rural, i cili ofron punësim tërheqës për të rinjtë/të rejat dhe gratë, është një forcë shtytëse e rimëkëmbjes ekonomike sidomos pas përfundimit të pandemisë COVID-19 bazuar në strategjinë "e rindërtimit" me fokus në rritjen e standardizimit dhe certifikimit për t'i shërbyer pritshmërive më të larta të turistëve. Zhvillimi i sektorit po nxjerr në pah nevojën për të punësuar të kualifikuar. Sektori shihet si një prej motorëve të zhvillimit të zonave rurale duke lidhur kështu në të njëjtën pikë prodhimin, përpunimin, dhe shërbimet ndaj produktit.

Vizioni për sektorin e bujqësisë synon të bëjë të mundur një sektor agroushqimor dhe të peshkimit të efektshëm, inovativ dhe të qëndrueshëm në Shqipëri, i cili të mund të përballojë më mirë presionet e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të reagojë ndaj sfidave të ndryshimeve klimatike dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, ndërkohë që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të zonave rurale.

Në funksion të këtij vizioni mbështetet adresimi i sfidave kryesore ekonomike, mjedisore dhe sociale për të përmirësuar mundësitë për zhvillimin e bujqësisë, peshkimit dhe biznesit në zonat rurale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë barazisë gjinore dhe tërheqjes së fermerëve dhe sipërmarrësve të rinj, për të përmbushur prioritetet e politikave të sektorit dhe ambiciet e procesit të akreditimit të BE-së.

Objektivat e përgjithshëm për sektorin e bujqësisë konsistojnë në:

- Promovimin e prodhimit të qëndrueshëm dhe të cilësisë së ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor;
- Forcimin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe veprimeve lidhur me klimën;
- Forcimin e strukturës sociale-ekonomike të zonave rurale;
- Nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të peshkimit detar dhe të ujërave të brendshme;
- Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative drejt përafrimit me *acquis communautaire* të BE-së në klasterin dhe kapitujt përkatës, 11, 12 dhe 13, si dhe transferimi i njohurive dhe inovacioni.

Eksportet shqiptare gjatë vitit 2022 arritën vlerën 487 miliardë lekë (4 miliardë euro), nga të cilat rreth 51.7 miliardë ishin eksporte të mallrave ushqimore, pijeve dhe duhanit. Eksportet bujqësore për vitin 2022 kapën vlerën e 55 miliardë lekë (482 milionë euro). Synimi sipas SKZHIE 2022–2030 është arritja e eksporteve bujqësore në vlerën 1 miliard USD.

Bujqësia ka ndikim thelbësor në shumë prej Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 por më drejtpërdrejt efektet e saj lidhen në kuadër të realizimit të Objektivit 2: "Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i ushqyerjes, si dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme" dhe synimit 2.4 "Deri në vitin 2030, sigurimi i sistemeve të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit dhe zbatimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore që rrisin produktivitetin dhe prodhimin, që ndihmojnë ruajtjen e ekosistemeve, që forcojnë kapacitetin për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, motit ekstrem, thatësirës, përmbytjeve dhe fatkeqësive të tjera dhe që përmirësojnë në mënyrë progresive cilësinë e tokës". Gjithashtu, Objektivin 12 "Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit".

Turizmi

Sektori i turizmit po konsolidohet si një nga sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik të vendit. Numri i vizitorëve të huaj që hynë në Shqipëri gjatë vitit 2022 ishte afro 7.5 milionë persona. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se shpenzimet e të huajve për turizëm në Shqipëri gjatë vitit 2022 arritën një rekord prej 2.84 miliardë euro. Gjithashtu, kjo industri, siguroi punësimin në gjithë zinxhirin e vlerës së turizmit të rreth 226 mijë punonjësve, duke zënë rreth 20 për qind të numrit të të punësuarve në Shqipëri. SKZHIE 2022-2030 mbështetet në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në vend duke synuar arritjen e objektivit për të mirëpritur 10 milionë turistë të huaj në vitin 2030.

Investimet në turizëm aktualisht përbëjnë rreth 7.5% të të gjitha investimeve në vend, ndërsa deri në vitin 2028 kjo shifër pritet të rritet në 8.2%. Me synim inkurajimin dhe tërheqjen e investimeve strategjike, kuadri ligjor ekzistues u ofron

investitorëve strategjikë mekanizma nxitjeje dhe mbështetjeje, duke i konsideruar këto investime si prioritet dhe duke garantuar një sërë masash, shërbimesh dhe lehtësirash administrative. Një zhvillim të vrullshëm kanë pasur vitet e fundit të tre kategoritë kryesore të turizmit në vend – turizmi bregdetar, ai tematik (agroturizmi, kulturor etj.), si dhe turizmi natyror për të cilat Shqipëria ka potenciale të paçmuara zhvillimi.

Sfidat kryesore me të cilat lidhet zhvillimi i turizmit në Shqipëri kanë të bëjnë me natyrën sezonale të turizmit të bregdetit, përqendrimit të turizmit dhe mbipopullimit në zonat bregdetare gjatë sezonit veror, mungesës së fuqisë së kualifikuar punëtore, mungesa e standardizimit dhe sistemit të klasifikimit, informalitetit, zgjidhja e problemit të pronësisë, lidhjet jo të mira të infrastrukturës së transportit, veçanërisht atij detar etj.

Vizioni për zhvillimin e turizmit: "Shqipëria si destinacion turizmi tërheqës, dinamik dhe produktiv përgjatë gjithë vitit" mbështetet në arritjen e qëllimeve të mëposhtme strategjike:

- Mbështetjen e sektorit privat dhe investimeve në turizëm të qëndrueshëm në të gjithë zinxhirin e vlerës që krijohet brenda vendit sipas standardeve më të mira ndërkombëtare;
- Ngritjen e një sistemi kombëtar të edukimit turistik me kurrikula profesionale bashkëkohore;
- Nxitjen dhe zhvillimin e rrjeteve digjitale dhe shërbimeve që burojnë prej tyre, duke bashkërenduar me sektorin privat të turizmit, ofruesit e teknologjive dhe inovatorët;
- Zbatimin e investimeve që i kthejnë zonat e mbrojtura në parqe natyrore, me infrastrukturë të përshtatshme për vizitueshmërinë e tyre ku krijohet ekonomi e qëndrueshme;
- Zhvillimin e shërbimeve që lidhen me aktivitetet e turizmit detar dhe nxitjen e zhvillimit të festave dhe eventeve në destinacione;

Turizmi lidhet me disa nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 por më drejtpërdrejt efektet e saj lidhen në kuadër të realizimit të Objektivit 8: "Nxitja e rritjes ekonomike të pandërprerë, përfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë e produktiv dhe punës së denjë për të gjithë" dhe synimit 8.9 "Deri në vitin 2030, hartimi dhe zbatimi i politikave për promovimin e turizmit të qëndrueshëm që krijon vende pune dhe promovon kulturën dhe produktet vendase".

Energjia

Energjia është një sektor prioritar për Shqipërinë jo vetëm për të mbështetur zhvillimin vrullshëm e të qëndrueshëm të sektorëve të ndryshëm të vendit mbi ofrimin e një jetë dinjitoze për familjet shqiptare, por edhe një sektor me kontribut të rëndësishëm të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të vendit.

Pesha e burimeve të energjisë së rinovueshme në konsumin e energjisë në Shqipëri arriti në 39,3 për qind në vitin 2021. Janë instaluar 2400 MW impiante me burime të rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike. Shqipëria do të vazhdojë të rrisë kapacitet e gjenerimit të energjisë elektrike bazuar në burime të rinovueshme, kryesisht diell dhe erë. Do të mbështeten dhe lehtësohen investimet private të prodhuesve. Do të forcohet infrastruktura e transmetimit të energjisë duke nxitur tregtimin e energjisë në bursën e vendit dhe ato rajonale. Do të zgjerohet mbështetja për eficiencën e energjisë në sektorin e banesave rezidenciale, në godinat me qëllim publik përdorimi, në përdorimin energjisë elektrike në furnizimin me ujë dhe trajtimin e ujërave të përdorura, në përdorimin e energjisë elektrike në vaditje dhe mbrojtje nga përmbytjet, si dhe në industrinë e lehtë të prodhimit dhe agropërpunimit.

Shqipëria ka realizuar me sukses dy ankande fotovoltaike me kapacitet total 240 mw, ndërsa në qershor 2021, u shpall një ankand i erës 100 . Ofertuesit mund të konkurrojnë me projekte ndërmjet 10 mw dhe 75 mw dhe fituesve do t'u jepet një marrëveshje 15-vjeçare e blerjes së energjisë. Ankandi pritet të finalizohet në gjysmën e dytë të vitit 2023.

Për zbatimin e plotë të politikave energjetike dhe klimatike, legjislacioni dytësor për EE, përfshirë performancën energjetike në ndërtesa, është miratuar plotësisht dhe legjislacioni dytësor për burimet e rinovueshme të energjisë është ende në proces ndryshimi për ta adoptuar me direktivat e reja të BE-së.

Duke qenë se thuajse e gjithë energjia elektrike e prodhuar në vend bazohet në burime të rinovueshme, me qëllim uljen e varësisë nga ndryshimet klimatike dhe diversikimin e gjeografisë së gjenerimit të energjisë do të kryhen disa investime që rrisin kapacitet gjeneruese të bazuara në lëndë djegëse fosile. Shqipëria nxit zhvillimin dhe konsolidimin e sistemeve energjetike të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe sidomos integrimin e

këtyre sistemeve në një treg rajonal energjetik me qëllim jo vetëm përmirësimin e cilësisë së qytetarëve të vendeve respektive dhe të rritjes së konkurrueshmërisë së sipërmarrjeve por edhe të krijimit të një klime besimi reciprok midis vendeve.

Me gjithë arritjet në përgjysmimin e humbjeve (nga 42 për qind në 21 për qind) në periudhën 2013–2022, fakti që një e pesta e energjisë së hedhur në treg ende humbet, dëshmon për nevojën e përmirësimeve të mëtejshme në këtë sektor të rëndësishëm. Sa më sipër do të garantojmë që deri më 2030 vendi të kthehet në një eksportues vjetor neto të energjisë si nga pikëpamja e energjisë së prodhuar/përdorur edhe nga pikëpamja financiare e sektorit, duke u përpjekur që energjia të jetë e përballueshme si për biznesin ashtu edhe për familjet shqiptare.

Gjatë vitit 2022 prodhimi neto vendas i energjisë elektrike arriti vlerën 7.003 GWH nga 8.963 GWH energji të prodhuar në vitin 2021, duke shënuar një rënie të prodhimit me 21,9 %. Shqipëria mbetet e ekspozuar ndaj risqeve të rëndësishme që lidhen me sektorin energjetik. Ndryshimi i konsumit të energjisë në periudha të caktuara të vitit apo gjatë ditës në mënyrë të pashmangshme e bën sistemin energjetik të varur ndaj importeve të energjisë (2,253 GWH gjatë vitit 2021). Nga ana tjetër, për shkak të peshës kryesore që hidrocentralet zënë në prodhimin e energjisë elektrike, Shqipëria është shumë e varur ndaj sasisë vjetore të reshjeve apo shpërndarjes së tyre gjatë vitit dhe zonave të vendit. Kështu, prodhimi i realizuar për vitin 2021 rezulton rreth 2,887 GWH ose 47.5 për qind më i lartë se mesatarja e prodhimit për periudhën 2009 – 2021. Për këto arsye, diversifikimi i prodhimit të energjisë, krahas zhvillimit të investimeve në sektor, paraqet një sfidë të rëndësishme për t'u adresuar në të ardhmen në drejtim të fuqizimit të pavarësisë energjetike. Për këtë arsye, SKZHIE 2022-2030 synon që Shqipëria të jetë një vend eksportues neto i energjisë në vitin 2030. Lidhur me produktet e tjera energjetike, kryesisht nënproduktet e naftës dhe gazin, varësia e vendit ndaj tregjeve globale, është shumë më e theksuar.

Kriza aktuale energjetike në tregjet globale e ka nxjerrë edhe më në pah nevojën e fuqizimit të pavarësisë energjetike dhe Shqipëria ka mjaft potencial energjetik për të zvogëluar apo shmangur pasojat që vijnë nga kriza të tilla për zhvillimin e vendit, buxhetin e shtetit, biznesin apo konsumatorin vendas.

Kuvendi i Shqipërisë me anë të ligjit nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", përafroi direktivën (BE) 2018/2001 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", e ndryshuar", duke synuar:

a) të nxitë e rritjen e përdorimit të energjisë prej burimeve të rinovueshme për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori në Republikën e Shqipërisë dhe të jetë në përputhje me detyrimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

b) të zvogëlojë importin e lëndëve djegëse fosile, emetimin e gazeve me efekt serrë dhe të mbrojë mjedisin në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare;

c) të nxitë zhvillimin e energjisë elektrike të rinovueshme dhe integrimin rajonal të saj, si dhe të lehtësojë pjesëmarrjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme;

ç) të rritë diversifikimin e burimeve të energjisë dhe sigurinë e furnizimit me energji në Republikën e Shqipërisë;

d) të nxitë zhvillimin e zonave rurale dhe të izoluara duke përmirësuar furnizimin e tyre me energji.

Me anë të ligjit nr. 98/2022 "Për krijimin e kontributit të solidaritetit gjatë kohëzgjatjes së periudhës së krizës energjetike", Kuvendi i Shqipërisë miratoi taksimin e veçantë për prodhuesit e energjisë që shesin energjinë me çmim më të lartë se çmimi 8.5 lekë/kWh. Ky ligj e shtrin efektin e tij deri më 31 dhjetor 2024.

Në prill 2023 filloi funksionimin dhe Bursa Shqiptare e Energjisë, duke i dhënë kështu edhe industrisë tonë, edhe tregut ndërkombëtar, mundësinë për të marrë energji elektrike me çmime sa më të konkurrueshme dhe sa më të ulëta.

Energjia lidhet me Agjendën 2030 në kuadër të realizimit të Objektivit 7: "Sigurimi i furnizimit me energji me kosto të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë" dhe synimit 7.1 "Deri në vitin 2030, sigurimi i aksesit universal në shërbime energjie me kosto të përballueshme, të besueshme dhe moderne".

2.2 PROGRAMET IPA 2022–2027 DHE FUSHAT PRIORITARE TË TYRE

IPA 2021

	Dokumenti i veprimit	(mln euro)	Institucioni përgjegjës
1	BE për drejtësinë	8	MD
2	BE për të drejtat e pronësisë	10	KM, ASHK
3	BE për Natyrën/SPIN	6	MTM
4	BE për ekonominë qarkulluese	30,9	MTM
5	BE për inovacionin	10	MFE
Totali		64,9	

IPA 2022

	Dokumenti i veprimit	(mln euro)	Institucioni përgjegjës
1	BE për sektorin e ujit	29	MIE, AMBU, MTM
2	EUIF (*instrumenti lehtësues për integrimin evropian*)	19	MIE, MBZHR, MEPJ
3	BE për demokracinë	5	Kuvendi, KQZ
4	BE për rininë	5	MSHRF, MFE
5	BE për agjencitë e zbatimit të ligjit	14.9	MB
6	OMN/ Vetingu – faza II	9.7	MD
Totali		82.6	

IPA 2023

Mbështetje buxhetore sektoriale prej 80 mln euro për Shqipërinë: "*Kontrata e Ndërtimit të Shtetit dhe Rezistencës për Shqipërinë*", pjesë e Planit Vjetor të Veprimit që kontribuon në Paketën e Mbështetjes Energjetike të Ballkanit Perëndimor në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2023.

IPA 2024[1]

	Dokumenti i veprimit	Indikative (mln euro)	Institucioni përgjegjës
1	Mbështetje për kuadrin institucional të antikorrupsionit	3.85	MD
2	Ngritja e rrjetit të komunikimit bazuar në teknologjinë TETRA	5	MB
3	BE për qeverisjen lokale	10	MB
4	Mbështetje për menaxhimin e pyjeve – ForestAl	13	MTM
5	Ngritja e Institucionit Mjekësor të Posaçëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, në nivel kombëtar	0.19	MSHMS
6	Mbështetje për sigurinë ushqimore, veterinarinë dhe politikat fitosanitare	12.5	MBZHR
7	BE për përfshirjen sociale, faza II (mbështetje buxhetore).	28 (24 SBS + 4 TA)	MFE
8	EUIF (instrumenti lehtësues për integrimin evropian)	12	Kryenegociator
Totali (indikative)		99,35	

	Programet operacionale 2024–2027[2]	Kosto indikative (mln euro)	Përfituesit
1	Garancia rinore	69.4 (50 EU – 19.4 Kombëtare)	MFE, MAS, MSHMS, MSHRF
2	Ekonomia dhe shoqëria digjitale	44 (30 EU – 14 Kombëtare)	AKSHI
3	BE për eficiencën energjetike	79 (50 EU – 29 Kombëtare)	MIE, AEE
Totali (indikative)		192.4 (130 EU + 62.4 kombëtare)	

[1] Aktualisht për këtë program janë dorëzuar Dokumentet e Veprimit dhe mendohet të miratohet në fund të këtij viti nga Komisioni Evropian.

[2] Të dhënat i referohen draftit të parë të hartimit të programeve operacionale për Shqipërinë.

IPARD III

Vendimi i KE datë 9.3.2022 për IPA III Rural Development programme (IPARD III) për Republikën e Shqipërisë në vitet 2021–2027. Kontributi maksimal indikativ i Bashkimit Evropian për zbatimin e programit IPARD III është vendosur në 112,000,000 euro, i ndarë në vite si më poshtë:

Viti	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Totali	8	10	12	16	19	23	24

2.3 PROGRAMET E BASHKËPUNIMIT ME BANKËN BOTËRORE

Për vitin 2023 janë në proces për tu nënshkruar 6 programe me Bankën Botërore:

i) Projekti i ndërtimit të Urave të Qëndrueshme, 100 milionë $;

ii) Projekti Qëndrueshmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë", 70 milionë $;

iii) Projekti i Qasjes Universale në Shërbime Publike me Standard të Lartë (GovTECH), 60 milionë €;

iv) Financimi i Politikave të Zhvillimit, 120 milionë $;

v) Mjedis i Pastër dhe i Sigurt për Detin Blu, 80 milionë $;

vi) Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, 132 milionë euro.

KREU III

3.1 KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL

Zhvillimet më të fundit makroekonomike

Ritmi i rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit, deri përpara goditjes nga pandemia e COVID-19, ka treguar një trend pozitiv zhvillimi që është pasqyruar në një sërë parametrash makroekonomikë në vend. Performanca e vitit 2020 ka qenë, në aspektin ekonomik dhe të financave publike, një ndër vitet më të vështirë në tre dekada. Ekonomia e vendit përjetoi dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër që përfshin tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe vitin 2020, veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë të tij.

Sidoqoftë, me gjithë ndikimin e rëndë që të dy goditjet kanë pasur për ekonominë e vendit, në sajë të përgjigjeve relativisht të mira të politikave ekonomike dhe masave të duhura rregullatore të ndërmarra, të dhënat statistikore dëshmojnë se situata e përgjithshme në mbyllje të vitit 2020 ishte konsiderueshëm më pak e rëndë nga sa pritej në fillim të pandemisë, si dhe përgjatë vitit 2021 rimarrja e ritmit të ekonomisë ishte konsiderueshëm më e shpejtë sesa pritshmëritë fillestare.



Gjithashtu, edhe nën ndikimin e goditjes më të fundit negative, e reflektuar në një pakësim të ofertës globale të disa mallrave bazë e cila ka çuar në një rritje të fortë të nivelit të përgjithshëm të çmimeve (inflacionit), si dhe në një shtrëngim të fortë të kushteve financiare, sërish deri më tani, fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit ka rezistuar relativisht mjaft mirë ndaj të gjitha këtyre goditjeve.

Produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë u rrit me 4.7 për qind nga viti në vit në tremujorin e katërt të 2022, me një rënie të lehtë krahasuar me rritjen prej 4.9 për qind në periudhën e mëparshme. Konsumi i familjeve u rrit me 4.5 për qind, ndërsa shpenzimet e qeverisë ranë me 3 për qind. Gjithashtu, formimi i kapitalit fiks bruto u rrit me 9.8 për qind. Nga ana tjetër, kërkesa e huaj kontribuoi negativisht në rritje, pasi eksportet u rritën me 0.6 për qind ndërsa importet u rritën me 3.2 për qind. Në bazë tremujore, ekonomia u zgjerua me 0.2 për qind. Në terma vjetore për vitin 2022, PBB-ja u rrit me 4.84 për qind.

Deficiti i llogarisë korrente për 2022 shënon një deficit prej 1,080 milionë euro, i ngushtuar krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë me rreth 86 milionë euro ose 7 për qind. Ecuria e deficitit korrent reflektoi kryesisht thellimin e deficitit tregtar në mallra dhe zgjerimin e balancës negative të të ardhurave parësore, faktorë të cilët janë kompensuar në masë të madhe nga zgjerimi i suficitit tregtar në shërbime, si dhe rritja e remitancave. Eksporti i shërbimeve të lidhura përgjithësisht me turizmin arriti vlerën 4.8 miliardë euro për 2022, ose rreth 38% më shumë krahasuar me një vit më parë.

Nga ana tjetër, deficiti tregtar rezultoi me një zgjerim prej rreth 439 milion euro ose 11 për qind krahasuar me vitin 2021. Eksporti i mallrave më 2022 u rrit me 53 për qind krahasuar me vitin 2021, por në të njëjtën kohë edhe importi i mallrave u zgjerua ndjeshëm me rreth 22 për qind, në reflektim të rritjes së kërkesës së brendshme stimuluar edhe nga sezoni turistik. Pesha ndjeshëm më e lartë e importeve të mallrave në raport me eksportet çoi për rrjedhojë në zgjerimin e deficitit tregtar. Remitancat për vitin 2022 shënuan vlerën 833 milionë euro, me një rritje prej rreth 9.5 për qind krahasuar me 761 milionë euro të një viti më parë. Më 2022-n, teprica pozitive e llogarisë financiare dhe kapitale rezultoi në 864 milionë euro krahasuar me 1.9 miliardë euro që ishte më 2021. Brenda kësaj llogarie, investimet e huaja direkte neto shënuan nivelin prej 1,207 milionë euro për vitin 2022, ose një rritje prej 22 për qind në krahasim me nivelin prej 990 milionë euro më 2021.

Inflacioni mesatar përgjatë vitit 2022 ishte 6.7 për qind krahasuar me 2 për qind një vit më parë, duke reflektuar rritjen e çmimeve prej goditjes së fundit të ofertës globale të disa të mirave bazë, për shkak të luftës në Ukrainë, duke e kthyer inflacionin në një nga çështjet kryesore makroekonomike për ekonominë tonë, ashtu si në shumë vende të tjera të botës. Gjithsesi, inflacioni në Shqipëri deri më tani ka rezultuar sa pothuajse vetëm gjysma e inflacionit mesatar të vendeve të rajonit tonë (Ballkanit Perëndimor), si dhe ndjeshëm më ulët se sa mesatarja e Bashkimit Evropian. Kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave kryesore ka qëndruar përgjithësisht stabël. Kursi mesatar lek/euro në vitin 2022 ishte 119 nga 122.5 që ishte mesatarisht gjatë vitit 2021. Ndërsa kursi mesatar lek/USD për 2022 ishte 113.1 nga 103.5 që ishte mesatarisht gjatë vitit 2021.

Politikat fiskale

Pas një stimuli të lartë, për të kryer një politikë fiskale ekspansioniste të domosdoshme dhe njëkohësisht të paevitueshme gjatë viteve 2020 dhe 2021 me qëllim amortizimin e goditjeve negative (nga tërmeti dhe sidomos pandemia), politika fiskale për periudhën afatmesme 2024–2026 do të riorientohet sërish drejt konsolidimit fiskal, ndërkohë që do sigurojë një nivel investimesh publike relativisht të lartë prej mesatarisht rreth 5 për qind të PBB-së në vit (vetëm nga qeveria qendrore). Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik është thelbësor për uljen e risqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike.

Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej 2.2 për qind të PBB-së për 2024, nga 2.6 për qind i programuar për vitin 2023; nivelin prej 2.2 për qind të PBB-së në vitin 2025 dhe 1.7 për qind më 2026-n. Njëkohësisht, balanca primare pritet të rikthehet në norma pozitive prej rreth 0.3 për qind që prej vitit 2023, në përmirësim të qartë nga niveli negativ për vitin 2022. Ndërkohë që targetohet në vijimësi në vlera pozitive për vitin 2024 me 0.9 për qind, në vitin 2025 me 1.2 për qind dhe 1.8 për qind në vitin 2026.



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Balanca primare është një parametër shumë i rëndësishëm i qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, për të cilën, në korrik të 2020-s u ndërmor një tjetër iniciativë ligjore duke përfshirë një rregull të ri fiskal në LOB, në linjë edhe me rekomandimet e KE-së dhe me parimet kryesore të "aquis" të BE-së, i cili bën të detyrueshëm ligjërisht tashmë që duke filluar që prej vitit buxhetor 2024 e në vijim balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar).

Ky target i parametrit të balancës primare buxhetore do të përbëjë tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajektore vijimisht rënëse të borxhit publik, pra duke synuar konsolidim të vijueshëm fiskal me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike si një fondament kyç i stabilitetit makroekonomik dhe mbarë-vajtjes së ekonomisë së vendit. Më konkretisht, duke marrë të mirëqena supozimet dhe projeksionet e tjera të KMF-së aktuale, respektimi në mënyrë të përvitshme i këtij objektivi, (rregulli fiskal), të parametrit të balancës primare, pritet të çojë në një reduktim të nivelit të borxhit publik rreth nivelit prej 62.8 për qind të PBB-së deri në vitin 2026 nga rreth 64.6 për qind që rezultoi në fund të 2022.

Realizimi i pagesës së faturës të taksës së pasurisë përmes Sistemit të përmirësuar të Kadastrës Fiskale është bërë në fillim të muajit prill. Sistemi IT i Kadastrës Fiskale është tashmë gati të trajtojë procedurat e plota të taksës së pasurisë që nga regjistrimi i pronës deri te menaxhimi i detyrimeve të taksapaguesve.

Reforma e Taksës së Pasurisë kryhet pjesërisht përmes bashkëpunimit midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Suedeze të Taksave. Bashkëpunimi zhvillohet përmes projektit të quajtur ProTax Albania.

Qëllimi i projektit është fuqizimi i bashkive duke rritur të ardhurat e tyre vetjake. Projekti synon

administrim modern dhe uniform të taksës së ndërtesës, ku taksimi do të bazohet në vlerën e tregut.

Në dhjetor 2023 do të miratohet ligji i ri për taksën e pasurisë, si pjesë e reformës së Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (MTRS).

Një sistem i qendërzuar IT, cilësi e përmirësuar e regjistrave dhe taksapagues të mirë informuar, së bashku me një kuadër ligjor modern pritet ta bëjnë taksimin më të drejtë dhe efikas.

Draft-ligji i ri për lojërat e fatit ndodhet për konsultim publik dhe mirëpret komentet e qytetarëve dhe grupeve të interesit. Drafti ka parashikuar zhvillimin e tyre vetëm online, kontrollin e rreptë mbi sasinë e parave që mund të luajë secili lojtar, si dhe parashikon që shumica e këtyre të ardhurave të shkojë për sportin.

Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Pas recesionit të fortë prej -3.5 për qind në vitin 2020, ekonomia u rimëkëmb fuqishëm në vitin 2021, duke shënuar rritje reale prej 8.5 për qind. Për vitin 2022 kjo rritje vlerësohet të jetë rreth 3.7 për qind dhe pritet të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në normën 2.6 për qind për vitin 2023 dhe parashikohet mesatarisht rreth 3.9 për qind në vit përgjatë periudhës afatmesme në vijim 2024–2026. Më specifikisht, rritja ekonomike parashikohet në 3.8, 3.9 dhe 4.0 për qind respektivisht për vitet 2024, 2025 dhe 2026.

Presionet inflacioniste parashikohen të zbuten në periudhën afatmesme. Me shuarjen e efektit të bazës në normën e inflacionit, duke supozuar se nuk do të ketë një goditje tjetër të qenësishme në ofertën globale të mallrave bazë, si dhe në reflektim të tkurrjes së të ardhurave reale të disponueshme dhe shtrëngimit domethënës të kushteve financiare, të cilat do të ushtrojnë një presion frenues të kërkesës agregate, në skenarin bazë parashikohet (supozohet) se inflacioni do rikthehet gradualisht drejt targetit të tij prej 3% në fund të vitit 2023 dhe do qëndrojë rreth këtij niveli për periudhën afatmesme 2024–2026.

Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomikë, reformave dhe ndryshimeve fiskale të ndërmarra dhe veçanërisht ato të pritshme për t'u ndërmarrë në vijim, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tre vitet në vijim (2024 -2026) parashikohen të rriten mesatarisht me rreth 3.7 për qind në çdo vit. Më specifikisht 0.7 për qind për vitin 2024, 4.9 për qind për 2025 dhe 5.5 për qind për 2026. Të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej rreth 4.9 për qind.

Grafik 3.4: Të ardhurat (majtas në miliardë lekë, djathtas në për qind të PBB)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomikë dhe të të ardhurave për tre vitet në vijim, si dhe duke synuar respektimin e objektivave të sipërpërmendur të deficitit fiskal për këtë periudhë, burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2024–2026 pritet të jenë mesatarisht në rreth 729.2 miliardë lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 30.3 për qind e PBB-së. Investimet publike janë programuar të mbahen në një nivel mesatarisht prej rreth 5.1 për qind të PBB në çdo vit (vetëm nga qeveria qendrore, pa përfshirë ato nga qeveria lokale), i cili konsiderohet një nivel i përshtatshëm për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

Grafik 3.5: Shpenzimet (majtas në miliardë lekë, djathtas në për qind të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar në marsin e këtij viti ligjin e ri "Për tatimin mbi të ardhurat" për të rritur efikasitetin shtetëror për sa i përket mbledhjes së tatimeve por edhe për të thjeshtëzuar procedurat për qytetarët. Ky ligj synon neutralitetin e tatimit, rritjen e transparencës dhe aplikimin e një sistemi sa më të drejtë tatimor.

Përmes këtij ligji synohet një reformim i plotë i sistemit tatimor shqiptar dhe i hapet rruga një kapitulli të ri në legjislacionin fiskal, duke i dhënë fund ndryshimeve të shpeshta që i ishin bërë ligjit të mëparshëm, të cilat ndër vite kishin krijuar hapësira për evazion apo keqinterpretime.

Ligji ka tre objektiva kryesorë, të cilët janë:

- krijimi i një sistemi tatimor vetëdeklarativ bashkëkohor ku individi dhe entiteti paguan pjesën e ndershme të tatimit mbi të ardhurat që realizon, dhe kërkon kthimin e këtij kontributi në formën e përfitimeve dhe shërbimeve të përmirësuara publike;
- rritja e kontributit në buxhetin e individëve dhe entiteteve nëpërmjet tatimit të të ardhurave, duke balancuar peshën e tatimeve indirekte;
- ofrimi i një sistemi tatimi më të ndershëm dhe më të gjithëpranuar.

Përshkrimi i risqeve financiare

Duke pasur parasysh pasiguritë globale, konsumi/investimi privat mbetet i brishtë. Rritja më e dobët e ekonomisë globale - veçanërisht e Bashkimit Evropian, destinacionet kryesore të eksportit dhe burimet e remitancave mund të përhapen në Shqipëri.

Inflacioni është rikthyer në nivele të paprecedenta që nga vitet 1980. Kjo do të vërë nën presion si përpjekjet për uljen e varfërisë ashtu edhe çmimet e inputeve. Politika e normalizimit të Fed/BQE-së më shpejt se sa pritej, mund të çojë në rritje të normave të interesit në Shqipëri dhe të ushtrojë presion mbi shërbimin (kostot) e borxhit publik.

Situata energjetike/kushtet e thatësirës mund të ndikojnë në prodhimin e energjisë elektrike në vitin 2023. Mungesa e energjisë mund të dëmtojë rritjen ekonomike. Importet e energjisë elektrike mund të paraqesin rreziqe kuazi-fiskale për buxhetin.

Ndryshimet klimatike dhe degradimi i mjedisit janë rreziqe kyçe për qëndrueshmërinë e zhvillimit të Shqipërisë.

Propozimi i Dokumentit të Politikave Prioritare:

Bazuar në të dhënat e kuadrit makroekonomik, sektorët prioritarë të dokumentit DPP 2024–2026, do të vijojnë të financohen, por politikat e reja duhet të akomodohen brenda tavaneve ekzistuese. Gjithashtu, projektet e reja strategjike do të akomodohen brenda tavaneve të vitit 2025, bazuar në kushtin që investimet të fillojnë në vitin 2025.

Shënim sqarues. Duke filluar nga viti 2025, disponohet hapësirë fiskale për fillimin e projekteve të reja strategjike. Tavanet e vitit 2024 janë ezauruar me projektet në vazhdim. Politikat e tjera, të cilat kërkojnë financim sipas këtij draft-dokumenti janë tashmë të akomoduara në tavane buxhetore.

KREU IV
4.1 PROGRAME PRIORITARE TË REJA
PËR PERIUDHËN 2024–2026

1. Programi i garancisë rinore

Qeveria shqiptare do të nisë pilotimin e një programi të ri për përfshirjen e të rinjve/të rejave në tregun e punës. Skema e Garancisë Rinore synon të reduktojë largimin e të rinjve/të rejave nga Shqipëria, si dhe papunësinë për të rinjtë/të rejat, që është në nivelet mbi mesataren e papunësisë. Pas pilotimit në disa zona në vitin 2022, programi do të zgjerohet më 2023.

Fondi për programet e nxitjes së punësimit për vitin që vjen është 3.4 miliardë lekë për vitin 2023. Ky program do të zbatohet në bashkëpunim me Bashkimin Evropian.

2. Programi i kodimit për fëmijët e klasave të para (i)

Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) po zbaton projektin e kodimit që në klasën I. Projekti përfshin ngritjen e 100 laboratorëve "smart" në shkollat pilot, ofron një platformë *online (CodeMonkey)* për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimin e kodimit dhe mendimit kritik dhe logjik për nxënësit e klasave të para në 100 shkolla për vitin shkollor 2022–2023, si dhe trajnimin e mësuesve për kurrikulën e re të TIK-ut. Synimi afatgjatë i këtij projekti është riformatimi i të gjithë kurrikulës së lëndës së teknologjisë së informacionit, duke përfshirë këtu dhe kurrikulën aktuale që ndiqet nga klasa e katërt deri në të nëntën, por edhe në gjimnaz, si dhe pajisja me laboratorë "smart" e të gjitha shkollave të arsimit parauniversitar.

Kurrikula e klasës së parë siguron që fëmijët të kenë mundësi të përftojnë aftësitë e nevojshme për të përdorur kompjuterin e për t'u orientuar me pjesët e ndryshme të tij, të mësojnë bazat e programimit nëpërmjet një platforme që i mundëson që bashkë me mësuesit të ndjekin aventura të ndryshme të kodimit e të zhvillojnë aftësi të mendimit kritik, algoritmik dhe logjik.

Në vijim disa të dhëna statistikore:

- Janë ngritur **100 laboratorët e parë SMART** nëpër shkolla, në **34 qytete**;
- Në projekt janë përfshirë **270 klasa të para** me **7076 nxënës**;
- Është hartuar dhe miratuar zyrtarisht kurrikula e klasës së parë në bashkëpunim me ekspertin e huaj dhe ekspertët shqiptarë të ASCAP dhe AKSHI;
- Janë trajnuar **118 mësues**, gjatë **4 fazash trajnimi** përgjatë periudhës shtator 2022–shkurt 2023;
- Është hartuar, prodhuar dhe shpërndarë *Manuali i mësuesit* dhe *Libri i punës për nxënësit* në të 100 shkollat pjesë të projektit;

3. Programi i nxitjes së kodimit për të rinjtë/të rejat

Në kuadër të rritjes së shpejtë së nevojës për talente njerëzore në arritjen e potencialit të plotë dhe të shpejtë të digjitalizimit të Shqipërisë, qeveria shqiptare ka vlerësuar që krahas mënyrave tradicionale të edukimit, duhet nxitur dhe modeli i formimit për punë përmes qendrave të formimit profesional në fushën e programimit kompjuterik dhe kodimit, që i **mundëson individëve pa përvojë në shkencat kompjuterike, brenda një periudhe relativisht të shkurtër të aftësohen dhe të kalojnë në një karrierë në industrinë teknologjike**.

Për këtë arsye Qeveria ka përgatitur një skemë mbështetje për ndjekjen e këtyre programeve nga të rinjtë/të rejat, punëkërkuesit dhe punëmarrësit që duan të zhvillojnë aftësitë e tyre digjitale.

Kjo skemë mbështetje do të fillojë zbatimin nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive në janar 2023.

Financimi ofrohet sipas kritereve të mëposhtme:

- Pjesëmarrësit punëkërkues të papunë të regjistruar, financohen në masën 100%, por, në asnjë rast, më të lartë se 300,000 (treqind mijë) lekë të kostos së kursit të formimit profesional;
- Çdo pjesëmarrës punëkërkues apo punë-kërkues i punësuar i regjistruar, financohet në vlerën 50% të kostos së kursit të formimit profesional, por, në asnjë rast, më të lartë se 150,000 (njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë;
- Për personat me aftësi të kufizuara, institucionit të formimit profesional, publik apo privat, i financohen elementet e përshtatjes së arsyeshme, për sa u përket programeve të veçanta të trajnimit, kurrikulës së përshtatur, në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar, përgatitjen e instruktorëve për të ofruar trajnim të posaçëm për këtë kategori, deri në shumën 200,000 (dyqind mijë) lekë.

Informacione të mëtejshme:

- Aplikimi do të kryhet **nëpërmjet portalit *e-Albania*** nën përshkrimin: "Aplikim për kursin e Formimit Profesional me mbështetje financiare";

- Aplikuesit përzgjedhin kompaninë ku dëshirojnë të marrin formimin profesional dhe pas validimit të aplikimit të tyre kontaktohen nga kompania për të kryer testin e pranimit;

- Kursantët, të cilët përfitojnë nga kjo mbështetje **kan**ë **detyrimin të q**ë**ndrojn**ë dhe të kërkojnë punë brenda Republikës së Shqipërisë, për një periudhë **jo m**ë **pak se 2-vjeçare**, menjëherë pas mbarimit të kursit, në të kundërt janë të detyruar të kthejnë 100% të vlerës së mbështetjes financiare të përfituar, sipas skemës së përcaktuar në këtë vendim.

4. 2024 – Viti i pyjeve

Në kuadër të reformave, Agjencia Kombëtare e Pyjeve u riorganizua në mënyrë thelbësore duke filluar nga 1 janari 2023 duke krijuar Drejtorinë e Natyrës dhe Pyjeve. Drejtoria e re e Natyrës dhe Pyjeve do të mbulojë specifikisht zonat e mbrojtura dhe sektorin e pyjeve dhe kullotave.

Detyra e re e kësaj agjencie është hartimi i një kalendari pune me një plan veprimi konkret, me një hartë pune që do të shoqërohet me planin e vet financiar në emër të pyjeve. Krahas moratoriumit për ndalimin e prerjeve të pyjeve, ngritja e sistemit të informacionit në pyje është një tjetër risi e viteve të fundit

Zonat e mbrojtura nga 17.5% që i kishim dy vite më parë janë rritur në territor në masën 21.3%, dhe futja e luginës së Vjosës si Park Kombëtar do rrisin nga viti në vit sipërfaqen e zonave të mbrojtura.

Krahas këtyre masave do të fillojë një plan i ri ripyllëzimi shoqëruar me kalendar konkret dhe kosto financiare me fokus viti 2024 – Viti i Pyjeve.

KREU V
LISTA UNIKE E PROJEKTEVE ME RËNDËSI KOMBËTARE

Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare (ose siç njihet në gjuhën angleze, NSPP) është një instrument prioritizimi strategjik afatmesëm dhe afatgjatë i Qeverisë Shqiptare, i cili shërben për të materializuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), strategjitë sektoriale dhe prioritet e qeverisë në projekte konkrete në nivel kombëtar dhe rajonal. Kjo listë shërben si referencë për ministrinë përgjegjëse për financat dhe njësitë e qeverisjes qendrore, në kuadër të përfshirjes së projekteve të investimeve publike në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) apo buxhetin vjetor.

Projektet e reja të investimeve publike mbi vlerën kufi të vendosur me udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 20.2.2023 *"Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit, mbi bazën e të cilit mënyra dhe procedurat e vlerësimit të projektit të investimit publik"* klasifikohen si projekte investimi me rëndësi kombëtare dhe i nënshtrohen procesit të vlerësimit për përfshirjen e tyre në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare. Këto projekte investimi përfshihen në PBA-në apo buxhetin vjetor në përputhje me hapësirën fiskale, vetëm pasi të jenë bërë pjesë e listës unike të projekteve me rëndësi kombëtare, të rankuar dhe të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Parimet kryesore, ku bazohen njësitë e qeverisjes qendrore dhe institucioni përgjegjës për programimin strategjik, për propozimin e projekteve të investimeve, vlerësimin e propozimeve të projekteve të investimit për përfshirjen e tyre në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare dhe prioritizimin e tyre janë:

- parimi i vlerësimit të rëndësisë strategjike;
- parimi i vlerësimit mjedisor dhe impaktit klimaterik;
- parimi i vlerësimit të qëndrueshmërisë;
- parimi i vlerësimit gjinor;
- parimi i vlerësimit të menaxhimit të projektit.

Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare përmban projektet e investimeve publike, që kanë rëndësi strategjike, për sa i përket zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, pavarësisht nga burimi i tyre i financimit. Kjo listë është ndarë sipas statusit të projektit (i maturuar, pjesërisht i maturuar dhe i pamaturuar) duke i renditur projektet sipas rëndësisë brenda çdo institucioni. Theksojmë se institucionet janë renditur në mënyrë alfabetike.

Lista përbëhet nga 9 kolona ku secila kolonë e tabelës paraqet:

a) Në kolonën nr. 1 jepet numri rendor, i cili tregon numrin total të projekteve.

b) Në kolonën nr. 2 jepet emërtimi i projekteve ku tregohet titulli i projektit.

c) Në kolonën nr. 3 jepet institucioni propozues / përgjegjës për zhvillimin e projektit.

d) Në kolonën nr. 4 jepet sektori përkatës, sipas kritereve të përcaktuara në tabelën nr. 1 'Klasifikimi

projekteve strategjike' në VKM nr. 887 datë 27.12.2022 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike".

e) Në kolonën nr. 5 jepet nënsektori përkatës, sipas kritereve të përcaktuara në tabelën nr. 1 'Klasifikimi projekteve strategjike' në VKM nr. 887 datë 27.12.2022 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike".

f) Në kolonën nr. 6 jepet vlera indikative e projektit.

g) Në kolonën nr. 7 jepet statusi i projektit (i maturuar, pjesërisht i maturuar dhe i pamaturuar).

I maturuar

- Konsiderohet projekti për të cilën është kryer studimi i fisibilitetit (me përjashtim të rasteve kur lloji i projektit nuk ka nevojë për studim fisibilitetit) dhe janë konsideruar fisibël, si dhe kur projekti është në fazë të avancuar të përpilimit të dokumenteve teknike.

Pjesërisht i maturuar

- Konsiderohet projekti për të cilin është iniciuar studimi i fisibilitetit, kur projekti ka iniciuar një pjesë të dokumenteve teknik.

I pamaturuar

- Konsiderohet projekti i cili është në fazën e një koncept ideje dhe ka ende paqartësi në inicimin e dokumenteve teknik.

h) Në kolonën nr. 8 jepet kodi i klasifikimit sipas Objektivit i Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

- Secilit projekt i është identifikuar objektivi në të cilin kontribuon në arritjen e outputeve të agjendës globale, të cilat do ti gjeni të detajuara në seksionin e legjendës.

i) Në kolonën nr. 9 jepet kodi sipas klasifikimit funksional të shpenzimeve të qeverisë (COFOG)

- Ky kod klasifikon të dhënat e shpenzimeve të qeverisë nga Sistemi i Llogarive Kombëtare sipas funksionit të përdorimit. Secili prej projekteve të Listës Unike është klasifikuar sipas qëllimit funksional të identifikuar.

COFOG detajohet sipas nivelit primar dhe sekondar

- Sipas nivelit të parë në 10 grupe primare me kodin dyshifror përkatës në rend numerologjik sipas rendit të poshtëreferuar:

Shërbime të përgjithshme publike; mbrojtja; rendi dhe siguria publike; çështjet ekonomike; mbrojtja e mjedisit; banesat dhe komoditet e komunitetit; shëndeti; zbavitje, kultura dhe feja; arsimi; mbrojtja sociale.

- Sipas nivelit sekondar me kodin treshifror më të detajuar, të cilat do ti gjeni të detajuara në seksionin e legjendës.

Projekte investimi me rëndësi kombëtare, do të konsiderohen sipas aneksit 1 të VKM-së nr. 887, datë 27.12.2022 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", si dhe udhëzimit nr. 4, datë 20.2.2023 "Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë në përputhje me specifikat e sektorit, mbi bazën e të cilit përcaktohet mënyra dhe procedura e vlerësimit të projektit të investimit publik" ato projekte të cilat klasifikohen në një nga gjashtë sektorët dhe kufirin financiar të vlerës së plotë të projekteve:

- **Sektori digjital** (mbi 500,000,000 lekë)

Infrastruktura digjitale, i referohet teknologjive digjitale, të cilat ofrojnë bazën për teknologjinë dhe operacionet e informacionit të një njësie organizative. Do të konsiderohen si pjesë e sektorit të infrastrukturës digjitale të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parëson në të paktën një prej nënsektorëve; Ndërlidhja me bazë të gjerë, infrastruktura e-GOV, Sisteme Informacioni dhe platformat e inovacionit.

- **Zhvillimi ekonomik** (mbi 500,000,000 lekë)

Zhvillimi ekonomik, i referohet programeve dhe politikave, apo aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim të përmirësojnë mirëqenien ekonomike, dhe cilësinë e jetës së burrave dhe grave të komitetit në vend. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synojnë të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve; agrikultura, zhvillimi i biznesit, infrastruktura bregdetare dhe detare, sipërmarrja, industria, zhvillimi rajonal dhe turizmi.

- **Energjia** (mbi 1,000,000,000 lekë)

Energjia, i referohet aktiviteteve ekonomike me impakt në prodhim dhe shitjen e energjisë, përfshirë nxjerrjen e karburanteve, përpunimin dhe shpërndarjen e tyre. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Energjisë të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve, eficienca e energjisë, prodhimi i energjisë, transmetimi i energjisë, gazi, nafta dhe energjia e rinovueshme.

- **Mjedisi** (mbi 500,000,000 lekë)

Mjedisi u referohet aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Do të

konsiderohen si pjesë e sektorit të mjedisit të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve; menaxhimi i fatkeqësive, mbrojtja nga përmbytjet, zhvillimi i qëndrueshëm, menaxhimin i mbetjeve, landfillet, furnizimi me ujë.

- **Social** (mbi 500,000,000 lekë)

Sektori Social, i referohet programeve dhe politikave, apo aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim reduktimin e shtrirjes së varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së burrave dhe grave në vend, si dhe adresimin e pabarazive gjinore në përgjithësi. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit Social të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve; kultura, edukimi dhe sportet, shëndetësia, strehimi, siguria e brendshme, drejtësia, mbrojtja sociale.

- **Transporti** (mbi 2,000,000,000 lekë)

Transporti, i referohet aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim zhvillimin apo përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese të transportit të mallrave dhe/ ose qyteteve nëpërmjet tokës, ujërave dhe ajrit. Do të konsiderohen si pjesë e këtij sektori të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim të paktën në një prej nënsektorëve; transporti ajror, transporti në ujërat e brendshme, portet, transporti hekurudhor, transporti rrugor.

Në aneksin 1 jepet Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare.

ANEKSI 1
LISTA UNIKE E PROJEKTEVE ME RËNDËSI KOMBËTARE

1. Projektet me statusin: të maturuar
Në total 60 projekte me vlerë indikative 7,846,271,864 €
1. Sektori Digjital
- 7 Projekte me vlerë indikative 207,783,332 €
2. Sektori i Zhvillimit Ekonomik
- 14 Projekte me vlerë indikative 773,600,000 €
3. Sektori i Energjisë
- 8 Projekte me vlerë indikative 1,267,550,000 €
4. Sektori i Mjedisit
-5 Projekte me vlerë indikative 274,935,496 €
5. Sektori Social
- 8 Projekte me vlerë indikative 231,200,000 €
6. Sektori i Transportit
-18 Projekte me vlerë indikative 5,091,203,036 €
- Sipas funksionit të përdorimit të fondeve **COFOG**

SEKTORI	NR. I PROJEKTEVE	KODI COFOG
Digjital	7	
	2	01.3
	1	03.4
	2	04.6
	1	08.6
	1	09.7
Zhvillimi ekonomik	14	
	8	04.1
	1	04.2
	2	04.8
	1	04.9
	1	05.1
	1	05.4
Energjia	8	
	8	04.3
Mjedisi	5	
	1	04.2

	1	05.1
	3	06.3
Social	8	
	1	02.1
	1	02.2
	1	03.1
	1	03.4
	1	06.6
	1	07.5
	1	08.1
	1	08.2
Transportit	18	
	18	04.5

- Në kuadër të klasifikimit të projekteve sipas **OZHQ-ve**.

SEKTORI	NR. I PROJEKTEVE	KODI OZHQ
Digjital	**7**	
	1	4.2
	2	9.1
	1	9.5
	1	16.6
	1	17.6
	1	17.7
Zhvillimi ekonomik	**14**	
	1	2.3
	2	8.2
	6	8.9
	1	9.5
	1	12.2
	1	14.1
	1	15.4
	1	17.7
Energjia	**8**	
	3	7.1
		7.2
	1	7.3
	1	12.2
	1	17.9
Mjedisi	**5**	
	2	6.1
	2	6.4
	1	12.4
SOCIAL	**8**	
	1	3.8
	1	4.4
	1	11.4
	1	16.10
	1	16.2
	2	16.6
	1	17.9
Transporti	**18**	
	12	9.1
	3	9.2
	1	11.3
	1	11.6
	1	17.6

Nr.	Emërtimi i Projektit	Institucioni Propozues / Përgjegjës	Sektori	Nënsektori	Vlera indikative e Projektit	Statusi i projektit	OZHQ	COFOG
1	E-Qeverisja 2.0	AKSHI	Digjital	Infrastruktura e-GOV	€ 58,000,000	I maturuar	9.1	01.3
2	Krijimi i Smart Labs – rrjeti i laboratorëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për sistemin arsimor parauniversitar	AKSHI	Digjital	Infrastruktura e-GOV	€ 33,559,368	I maturuar	4.2	09.7
3	Ngritja e Qendrës BCC dhe DRC për sistemet elektronike qeveritare	AKSHI	Digjital	Infrastruktura e-GOV	€ 45,000,000	I maturuar	9.1	01.3
4	Përmirësimi i infrastrukturës së IT në burgje	AKSHI	Digjital	Infrastruktura e-GOV	€ 20,123,964	I maturuar	16.6	03.4
5	Krijimi dhe përmirësimi i sistemeve digjitale në sektorin e kulturës	AKSHI	Digjital	Infrastruktura e-GOV	€ 41,000,000	I maturuar	17.7	08.6
6	Përditësimi dhe përmirësimi i të dhënave të pronës së paluajtshme	ASHK	Social	Drejtësia	€ 31,700,000	I maturuar	16.6	06.6
7	Zona Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Kashar	BASHKIA TIRANË	Zhvillimi ekonomik	Zhvillimi i biznesit	€ 64,000,000	I maturuar	8.9	04.1
8	*Ndërtimi i urës ndërshtetërore mbi Lumin Buna/Bojana [3]	FSHZH	Transporti	Transporti rrugor	€ 14,000,000	I maturuar	9.1	04.5
9	Turizmi i integruar rajonal dhe studimi i përmirësimit urban për projektin e portës së Alpeve	FSHZH	Zhvillimi ekonomik	Turizmi	€ 70,000,000	I maturuar	15.4	04.9
10	Qendra multifunksionale e startupeve	FSHZH	Zhvillimi ekonomik	Sipërmarrja	€ 30,000,000	I maturuar	9.5	04.8
11	Mbështetja për zhvillimin e "Economic Clusters" në nivel rajonal dhe lokal	FSHZH	Zhvillimi ekonomik	Zhvillimi i biznesit	€ 55,000,000	I maturuar	17.7	04.1

[3] *Vlera indikative e projektit në fjalë, identifikon vetëm një pjesë të kostos totale, pasi ky projekt ka një shtrirje më të gjerë sesa Republika e Shqipërisë.

12	Përmirësimi i rrjetit rrugor dytësor dhe lokal	FSHZH	Transporti	Transporti rrugor	€ 810,000,000	I maturuar	11.3	04.5
13	Përmirësimi i infrastrukturës fizike për qendrat e dijes dhe rekreacionit komunitar	FSHZH	Social	Arsimi dhe sportet	€ 28,500,000	I maturuar	4.4	08.1
14	Programi i Ndërhyrjeve të Turizmit të Integruar, Programi Shqiptar i mundësimit të Infrastrukturës së Turizmit	FSHZH	Zhvillimi ekonomik	Turizmi	€ 105,000,000	I maturuar	8.9	04.1
15	Programi për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin	FSHZH	Zhvillimi ekonomik	Turizmi	€ 93,000,000	I maturuar	8.9	04.8
16	Mbështetje për Zhvillimin e Qëndrueshëm Rajonal në zonat me potencial ekonomik në Shqipëri	FSHZH	Zhvillimi ekonomik	Turizmi	€ 60,000,000	I maturuar	8.9	04.1
17	Programi i Furnizimit me Ujë IV	FSHZH	Mjedisi	Furnizimi me ujë	€ 46,000,000	I maturuar	6.1	06.3
18	Përmirësimi i infrastrukturës së turizmit dhe biznesit të lidhur me të në zonën ndërkufitare në Alpet Shqiptare/Malet e Prokletijes	FSHZH	Zhvillimi ekonomik	Turizmi	€ 30,000,000	I maturuar	8.9	04.1
19	Masa efektive ndërkufitare për konkurrencën, rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm lokal në zonën ndërkufitare Shqipëri-Kosovë	FSHZH	Zhvillimi ekonomik	Turizmi	€ 54,000,000	I maturuar	8.2	04.1
20	Zhvillimi i sipërmarrjes lokale dhe turizmit ndërkufitar përgjatë liqenit të Shkodrës/Skadar it përmes përmirësimeve në infrastrukturën e biznesit	FSHZH	Zhvillimi ekonomik	Turizmi	€ 25,000,000	I maturuar	8.9	04.1
21	Ndërtimi i qendrës së Biostimulimit të	MAS	Social	Shëndetësia	€ 8,000,000	I maturuar	3.8	07.5

	Universitetit Mjekësisë Tiranë							
22	Ndërtimi i Korpusit të Policisë së Shtetit	MB/ BASHKIA TIRANË	Social	Arsimi dhe sportet	€ 50,000,000	I maturuar	16.6	03.1
23	Përmirësimi i infrastrukturës për mbrojtjen nga përmbytjet në lumin Mat, Shqipëri	MBZHR	Mjedisi	Mbrojtja nga përmbytjet	€ 11,672,000	I maturuar	6.1	04.2
24	Ekonomia Blu	MBZHR	Zhvillimi ekonomik	Bujqësia	€ 25,000,000	I maturuar	14.1	05.1
25	Qëndrueshmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë	MBZHR	Zhvillimi ekonomik	Bujqësia	€ 64,600,000	I maturuar	2.3	04.2
26	Instituti i Rehabilitimit dhe Riintegrimit Për të Miturit në Konflikt me Ligjin	MD	Social	Drejtësia	€ 20,000,000	I maturuar	16.2	03.4
27	Zona Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Koplik	MFE	Zhvillimi ekonomik	Zhvillimi i biznesit	€ 18,000,000	I maturuar	8.2	04.1
28	Projekti i Portit të Integruar të Durrësit në Porto-Romano	MIE	Transporti	Transporti detar	€ 390,000,000	I maturuar	9.1	04.5
29	Projekti i Marinës Turistike të Durrësit	MIE	Transporti	Transporti detar	€ 2,100,000,000	I maturuar	9.2	04.5
30	HEC Skavica	MIE/ KESH	Energjia	Transmetimi i energjisë	€ 800,050,000	I maturuar	7.1	04.3
31	Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës-Rrogozhinë	MIE/ HSH	Transporti	Transporti hekurudhor	€ 77,500,000	I maturuar	9.1	04.5
32	Rehabilitimi i hekurudhës "Rrogozhinë-Pogradec/Përrenjas-Rrajcë-kufi me Maqedoninë e Veriut	MIE/ HSH	Transporti	Transporti hekurudhor	€ 400,000,000	I maturuar	9.1	04.5
33	Ndërtimi i linjës hekurudhore nga Terminali i Transportit Publik të Tiranës (TTP) në një stacion të ri hekurudhor në Tiranë (Loti 1) dhe lidhja me Linjën Kufitare (BRL) me Unazën e Mesme të Tiranës (Loti 2)	MIE/ HSH	Transporti	Transporti hekurudhor	€ 20,000,000	I maturuar	9.1	04.5

34	Elektrifikimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe lidhja me Aeroportin e Rinasit	MIE/ HSH	Transporti	Transporti hekurudhor	€ 20,550,000	I maturuar	9.2	04.5
35	Gazsjellësi Fier-Vlorë që do të lidhë gazsjellësin TAP me TEC-in e Vlorës	MIE	Energjia	Gazi	€ 50,500,000	I maturuar	7.1	04.3
36	Ndërtimi i *bypass*-it Tiranë	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 133,410,276	I maturuar	9.1	04.5
37	Zhvillimi i projektit ITS	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 100,000,000	I maturuar	9.2	04.5
38	Zhvillimi i projektit të impiantit fotovoltaik 12.9 Mwp, panele lundruese Vau i Dejës	MIE/ KESH	Energjia	Energjia e rinovueshme	€ 13,000,000	I maturuar	7.2	04.3
39	Magazinimi nëntokësor i gazit natyror në zonën e Dumresë (UGS Dumrea);	MIE	Energjia	Gazi	€ 89,500,000	I maturuar	12.2	04.3
40	Gazsjellësi Adriatiko Jonian – Seksionet e Malit të Zi dhe Shqipërisë	MIE	Energjia	Gazi	€ 172,500,000	I maturuar	17.9	04.3
41	Digjitalizimi i sistemit të transmetimit të Shqipërisë	MIE/OST	Energjia	Eficienca e energjisë	€ 46,000,000	I maturuar	7.1	04.3
42	Ndërtimi i Impiantit fotovoltaik 50 Mwp në Belsh	MIE/ KESH	Energjia	Energjia e rinovueshme	€ 46,000,000	I maturuar	7.2	04.3
43	Zgjerimi i autostradës Tiranë-Durrës	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 205,000,000	I maturuar	9.1	04.5
44	Ndërtimi i rrugës Tiranë-Ndroq-Plepa	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 39,827,760	I maturuar	9.1	04.5
45	Transporti i Gjelbër në qytetin e Tiranës	MIE/ BASHKIA TIRANË	Transporti	Transporti rrugor	€ 110,370,000	I maturuar	11.6	04.5
46	Projekti për ndërtimin e urave rezistente	MIE/ ARRSH	Transporti	Transporti rrugor	€ 100,000,000	I maturuar	9.1	04.5
47	Programi i Eficiencës së Energjisë në Sektorin e Transmetimit	MIE/ OST	Energjia	Eficienca e energjisë	€ 50,000,000	I maturuar	7.1	04.3
48	Elektrifikimi i linjës hekurudhore Vorë – Hani i Hotit	MIE/ HSH	Transporti	Transporti hekurudhor	€ 74,400,000	I maturuar	9.1	04.5

49	Programi infrastrukturor – përmirësimi i lidhjes rajonale	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 195,145,000	I maturuar	17.6	04.5
50	Programi kombëtar për rrjetet 5G: lirimi i spektrit DD2	MIE	Digjital	Ndërlidhja me brez të gjerë	€ 5,100,000	I maturuar	9.5	04.6
51	Autostrada Digjitale Ballkanike	MIE	Digjital	Ndërlidhja me brez të gjerë	€ 5,000,000	I maturuar	17.6	04.6
52	Projekti i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta për qarkun e Beratit	MIE/ AKUM	Mjedisi	Menaxhimi i mbetjeve, landfillet	€ 12,000,000	I maturuar	12.4	05.1
53	Infrastruktura Bashkiake V - Ujësjellës, kanalizime për qytetet Shkodër, Lezhë, Kamzë, Elbasan, Fier, Vlorë, Berat	MIE	Mjedisi	Furnizimi me ujë	€ 178,600,000	I maturuar	6.4	06.3
54	Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të KUZ të qytetit të Durrësit, Lagjja 14 dhe 13 sipër shinave të trenit	MIE	Mjedisi	Furnizimi me Ujë	€ 26,663,496	I maturuar	6.4	06.3
55	Rehabilitimi i hekurudhës Vorë-Hani Hotit	MIE/ HSH	Transporti	Transporti hekurudhor	€ 267,000,000	I maturuar	9.1	04.5
56	Aeroporti i Sarandës	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 34,000,000	I maturuar	9.1	04.5
57	Restaurimi, Rindërtimi dhe Muzealizimi i Projektimit të Muzeut Historik Kombëtar	MK	Social	Kultura	€ 25,000,000	I maturuar	11.4	08.2
58	Kompletimi i Forcave të Armatosura Shqiptare me mjete fluturuese pa pilot (UAV)	MM	Social	Mbrojtja sociale	€ 38,000,000	I maturuar	17.9	02.1
59	Krijimi i sistemit të mbrojtjes civile	MM/AKMC	Social	Mbrojtja sociale	€ 30,000,000	I maturuar	16.1	02.2
60	Mjedis i pastër dhe Rezistent për projektin e detit blu - CARE4BLUESEA	MTM / AKUM	Zhvillimi ekonomik	Turizmi	€ 80,000,000	I maturuar	12.2	05.4

2. Projektet me statusin: pjesërisht të maturuar
Në total 36 projekte me vlerë indikative 5,508,129,618 €
1. Sektori Digjital
- 5 Projekte me vlerë indikative 694,379,618 €
2. Sektori i Zhvillimit Ekonomik
- 2 Projekte me vlerë indikative 96,520,000 €
3. Sektori i Energjisë
- 7 Projekte me vlerë indikative 816,500,000 €
4. Sektori i Mjedisit
- 7 Projekte me vlerë indikative 638,300,000€
5. Sektori Social
- 6 Projekte me vlerë indikative 152,850,000 €
6. Sektori i Transportit
- 9 Projekte me vlerë indikative 3,109,580,000 €
- Sipas funksionit të përdorimit të fondeve(**COFOG**)

SEKTORI	NR. I PROJEKTEVE	KODI COFOG
Digjital	**5**	
	1	01.3
	1	01.5
	2	04.6
	1	09.7
Zhvillimi ekonomik	**2**	
	1	04.1
	1	04.8
Energjia	**7**	
	7	04.3
Mjedisit	**7**	
	4	04.2
	3	06.3
Social	**6**	
	1	03.3
	2	03.4
	1	07.4
	2	09.4
Transport	**9**	
	9	04.5

- Në kuadër të klasifikimit të projekteve sipas **OZHQ-ve**.

SEKTORI	NR. I PROJEKTEVE	KODI OZHQ
Digjital	**5**	
	1	4.3
	1	9.1
	1	16.6
	2	17.6
Zhvillimi ekonomik	**2**	
	2	8.9
Energjia	**7**	
	1	7.1

	2	7.2
	2	7.3
	1	17.6
	1	17.9
Mjedisit	**7**	
	1	3.1
	3	6.4
	1	13.2
	2	15.3
Social	**6**	
	2	4.3
	1	16.3
	3	16.6
Transport	**9**	
	1	9.1
	1	9.4
	7	11.2

Nr.	Emërtimi i projektit	Institucioni propozues/ përgjegjës	Sektori	Nënsektori	Vlera indikative e projektit	Statusi i projektit	OZHQ	COFOG
61	Business Intelligence për Administratën Publike	AKSHI	Digjital	Platformat e inovacionit	€ 24,379,618	Pjesërisht i maturuar	9.1	01.5
62	Zgjerimi i rrjetit GovNET (në të gjithë Shqipërinë)	AKSHI	Digjital	Infrastruktura e-GOV	€ 32,000,000	Pjesërisht i maturuar	16.6	01.3
63	Qendra Rajonale e Ndërveprueshmërisë në Vendet e Ballkanit Perëndimor	AKSHI	Digjital	Ndërlidhja me brez të gjerë	€ 10,000,000	Pjesërisht i maturuar	17.6	04.6
64	Kampusi i Universitetit të Tiranës (përfshirë mjediset e Kolegjit të Evropës – 5 mln euro)	BASHKIA TIRANË	Social	Arsimi dhe sportet	€ 75,000,000	Pjesërisht i maturuar	4.3	09.4
65	Programi "100 Fshatrat"	FSHZH	Zhvillimi ekonomik	Zhvillimi rajonal	€ 70,000,000	Pjesërisht i maturuar	8.9	04.8
66	**Eficienca e Energjisë në Shkolla[4]	MAS	Energjia	Eficienca e energjisë	€ 9,000,000	Pjesërisht i maturuar	7.3	04.3
67	Ndërtimi/Përmirësimi i Infrastrukturës së Kampusit të Universitetit të Sporteve	MAS	Social	Arsimi dhe sportet	€ 15,000,000	Pjesërisht i maturuar	4.3	09.4
68	Infrastruktura rajonale HPC, ndërlidhja e kampuseve të universiteteve rajonale me këtë infrastrukturë dhe përmirësimi i qendrës së të dhënave pritëse të HPC	MAS	Digjital	Platformat e inovacionit	€ 25,000,000	Pjesërisht i maturuar	4.3	09.7
69	Rehabilitimi i 431 digave në drejtim të rritjes së sigurisë së digave dhe disponueshmërisë së ujit për ujitje	MBZHR	Mjedisi	Mbrojtja nga përmbytjet	€ 171,500,000	Pjesërisht i maturuar	15.3	04.2

[4] ** Vlera indikative e projektit në fjalë, identifikon vetëm një pjesë të vlerës së investimit me të cilin është aplikuar në WBIF, vlera totale do të përcaktohet në momentin që projekti do të mbulojë territorin e Republikës së Shqipërisë.

70	Përmirësimi i infrastrukturës mbrojtëse nga përmbytjet në lumenjtë Erzen-Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjosë	MBZHR	Mjedisi	Mbrojtja nga përmbytjet	€ 105,000,000	Pjesërisht i maturuar	3.1	04.2
71	Rindërtimi (i plotë / i pjesshëm) i 27 stacioneve të pompimit të kullimit për të përmirësuar mbrojtjen nga kullimi / përmbytjet në 70 000 ha	MBZHR	Mjedisi	Mbrojtja nga përmbytjet	€ 15,000,000	Pjesërisht i maturuar	15.3	04.2
72	Përmirësimi i infrastrukturës mbrojtëse nga përmbytjet për pellgun e Drinit të Poshtëm dhe Bunës në zonën e Shkodrës në lidhje me zhvillimin e ardhshëm të lundrimit turistik në lumin Buna	MBZHR	Mjedisi	Mbrojtja nga përmbytjet	€ 64,000,000	Pjesërisht i maturuar	13.2	04.2
73	Ndërtimi i godinës së re të Gjykatës së Lartë	MD/KLGJ	Social	Drejtësia	€ 10,000,000	Pjesërisht i maturuar	16.3	03.3
74	Ndërtimi i I.E.V.P 325 (Burgu i Grave), Tiranë	MD	Social	Drejtësia	€ 11,000,000	Pjesërisht i maturuar	16.6	03.4
75	Përmirësimi i infrastrukturës së turizmit dhe biznesit në zonën ndërkufitare në Korçë, Shqipëri	MFE	Zhvillimi ekonomik	Turizmi	€ 26,520,000	Pjesërisht i maturuar	8.9	04.1
76	Programi kombëtar i modernizimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri	MIE/ AKUM	Mjedisi	Furnizimi me ujë	€ 131,800,000	Pjesërisht i maturuar	6.4	06.3
77	Furnizimi me ujë i qytetit të Durrësit	MIE/ AKUM	Mjedisi	Furnizimi me ujë	€ 61,000,000	Pjesërisht i maturuar	6.4	06.3
78	Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe (Faza II Kashar)	MIE	Mjedisi	Furnizimi me ujë	€ 90,000,000	Pjesërisht i maturuar	6.4	06.3
79	Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Murriqan - Lezhë (Balldren)	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 364,000,000	Pjesërisht i maturuar	11.2	04.5
80	Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Milot - Balldren	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 213,600,000	Pjesërisht i maturuar	11.2	04.5
81	Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Fier By pass (Levan)-Pocem	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 205,000,000	Pjesërisht i maturuar	11.2	04.5
82	Korridori Adriatiko Jonian- Segmenti Pocem – Memaliaj	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 753,000,000	Pjesërisht i maturuar	11.2	04.5
83	Korridori Adriatiko Jonian- Segmenti Memaliaj – Ura e Subashit	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 326,000,000	Pjesërisht i maturuar	11.2	04.5
84	Korridori Adriatiko Jonian - Bypass-i Gjirokastrës	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 81,480,000	Pjesërisht i maturuar	11.2	04.5
85	Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Gjirokastër-Kakavijë	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 176,000,000	Pjesërisht i maturuar	11.2	04.5
86	Gazsjellësi i Shqipërisë dhe Kosovës (ALKOGAP)	MIE	Energjia	Gazi	€ 195,500,000	Pjesërisht i maturuar	17.9	04.3

87	Përmirësimi digjital i sistemeve të integruara të energjisë brenda Ballkanit Perëndimor si shtytës kryesor për një epokë të re	MIE	Energjia	Transmetimi i energjisë	€ 50,000,000	Pjesërisht i maturuar	17.6	04.3
88	Masterplani për impiantin e ciklit të kombinuar (CHP) dhe ngrohjen qendrore (NQ) në Korçë (CHP&NQ Korçë);	MIE	Energjia	Energjia e rinovueshme	€ 89,500,000	Pjesërisht i maturuar	7.2	04.3
89	Ndërtimi i një pompe depozituese "Pump Storage", Koman - Fierzë	MIE/ KESH	Energjia	Eficienca e energjisë	€ 202,500,000	Pjesërisht i maturuar	7.3	04.3
90	Instalimi i paneleve diellore për prodhim të ujit të ngrohtë	MIE	Energjia	Prodhimi i energjisë	€ 20,000,000	Pjesërisht i maturuar	7.2	04.3
91	Ndërtimi i linjës hekurudhore Durrës – Prishtinë	MIE/ HSH	Transporti	Transporti hekurudhor	€ 750,000,000	Pjesërisht i maturuar	9.1	04.5
92	Ndërtimi i lidhjes së re hekurudhore Pogradec - Korçë - Kufiri me Greqinë	MIE/ HSH	Transporti	Transporti hekurudhor	€ 240,500,000	Pjesërisht i maturuar	9.4	04.5
93	Projekti për zhvillimin e infrastrukturës rajonale me brez të gjerë	MIE	Digjital	Ndërlidhja me brez të gjerë	€ 603,000,000	Pjesërisht i maturuar	17.6	04.6
94	TEC Vlora	MIE	Energjia	Prodhimi i energjisë	€ 250,000,000	Pjesërisht i maturuar	7.1	04.3
95	"Institucioni Mjekësor i Posaçëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, Lezhë	MSHMS	Social	Shëndetësia	€ 20,000,000	Pjesërisht i maturuar	16.6	03.4
96	Ndërtimi i 8 qendrave të rehabilitimit	MSHMS	Social	Shëndetësia	€ 21,850,000	Pjesërisht i maturuar	16.6	07.4

3. Projektet me statusin: të pamaturuar
Në total 49 projekte me vlerë indikative 2,752,287,166 €
1. Sektori Digjital
- 7 Projekte me vlerë indikative 88,287,166 €
2. Sektori i Zhvillimit Ekonomik
- 5 Projekte, me vlerë indikative 158,000,000 €
3. Sektori i Energjisë
- 16 Projekte, me vlerë indikative 1,625,100,000 €
4. Sektori i Mjedisit
- 6 Projekte, me vlerë indikative 371,500,000 €
5. Sektori Social
- 12 Projekte, me vlerë indikative 174,100,000 €
6. Sektori i Transportit
- 3 Projekte, me vlerë indikative 335,300,000 €
- Sipas funksionit të përdorimit të fondeve(**COFOG**)

SEKTORI	NR. I PROJEKTEVE	KODI COFOG
Digjital	**7**	
	1	01.6
	1	04.6
	2	04.8
	1	07.5
	1	08.2
	1	08.5
Zhvillimi ekonomik	**5**	
	1	04.3
	1	04.4
	1	04.8
	1	04.9
	1	05.4
Energjia	**16**	
	16	04.3
Mjedisi	6	
	2	04.2
	2	05.2
	1	0.56
	1	0.63
Social	**12**	
	4	03.3
	1	03.4
	1	03.5
	1	07.4
	1	08.2
	1	08.5
	1	10.1
	1	10.6
	1	10.9
Tranporti	**3**	
	3	04.5

- Në kuadër të klasifikimit të projekteve sipas **OZHQ-ve**.

SEKTORI	NR. I PROJEKTEVE	KODI OZHQ
Digjital	**7**	
	1	4.4
	2	16.1
	3	16.6
	1	17.6
Zhvillimi ekonomik	5	
	1	8.2
	2	8.9
	2	9.4
Energjia	**16**	
	3	7.1
	1	7.2
	8	7.3

	1	8.4
	1	13.2
	2	17.6
Mjedisi	**6**	
	2	6.1
	3	14.1
	1	15.3
Social	12	
	1	3.4
	1	3.7
	1	3.8
	2	11.4
	1	16.1
	4	16.3
	2	16.6
Transportit	**3**	
	2	9.1
	1	9.4

Nr.	Emërtimi i projektit	Institucioni propozues / përgjegjës	Sektori	Nënsektori	Vlera indikative e projektit	Statusi i projektit	OZ HQ	COFOG
97	Ngritja e Sistemit Zyrtar të Komunikimit me Qytetarët dhe Subjektet (email: NID@e-albania.al, Nipt@e-Albania.al)	AKSHI	Digjital	Infrastruktura e-GOV	€ 8,049,585	I pamaturuar	16.1	04.6
98	Tirana Tech Hub, në rrugën "5 Maji"	BASHKIA TIRANË	Digjital	Platformat e inovacionit	€ 6,300,000	I pamaturuar	4.4	04.8
99	Rivitalizimi dhe rikualifikimi i zonës urbane në mes të ishullit të lumit Osum.	FSHZH	Zhvillimi ekonomik	Zhvillimi rajonal	€ 12,000,000	I pamaturuar	9.4	04.9
100	Ndërtimi I Qendrës Multifunksionale të Stërvitjes për Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë dhe struktura të tjera të Policisë së Shtetit	MB	Social	Siguria e brendshme	€ 15,000,000	I pamaturuar	16.6	03.5
101	Përmirësimi i infrastrukturës së kullimit për të përmirësuar kullimin në fushën e Torrovicës (2250 ha) dhe Maliqit (5300)*.	MBZHR	Mjedisi	Mbrojtja nga përmbytjet	€ 14,500,000	I pamaturuar	15.3	04.2
102	Rehabilitimi i infrastrukturës së ujitjes që shërben një sipërfaqe prej 75 000 ha me ngritje mekanike të ujit kryesisht në zonën bregdetare perëndimore	MBZHR	Mjedisi	Mbrojtja nga përmbytjet	€ 225,000,000	I pamaturuar	14.1	04.2

103	Ndërtimi i godinës për Gjykatën e Apelit Tiranë	MD/KLGJ	Social	Drejtësia	€ 5,000,000	I pamaturuar	16.3	03.3
104	Ndërtimi i godinës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë	MD/KLGJ	Social	Drejtësia	€ 10,000,000	I pamaturuar	16.3	03.3
105	Ndërtimi i Prokurorive të Tiranës, Durrësit dhe Vlorës	MD/ PP	Social	Drejtësia	€ 15,000,000	I pamaturuar	16.3	03.3
106	Ndërtimi i godinës së re të Shkollës së Magjistraturës	MD/Shkolla e Magjistraturës	Social	Drejtësia	€ 7,700,000	I pamaturuar	16.3	03.3
107	Ndërtimi i një qendre të re paraburgimi në pjesën jugore të Shqipërisë, Gjirokastër	MD	Social	Drejtësia	€ 14,500,000	I pamaturuar	16.6	03.4
108	Përmirësimi dhe vendosja e sistemeve të integruara të menaxhimit të informacionit në Dogana	MFE	Digjital	Infrastruktura e-GOV	€ 30,000,000	I pamaturuar	16.6	01.6
109	Sigurimi i strehimit të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme	MFE	Social	Strehimi	€ 15,500,000	I pamaturuar	16.1	10.6
110	Zona Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Spitalla, Parku fotovoltaik i Spitallës me fuqi maksimale 100 megavat (120 ha)	MFE	Zhvillimi ekonomik	Zhvillimi i biznesit	€ 110,000,000	I Pamaturuar	8.2	04.3
111	Park shkencor dhe teknologjik "Technopark Tirana"	MFE	Zhvillimi ekonomik	Zhvillimi i biznesit	€ 21,000,000	I pamaturuar	8.9	04.8
112	Vlerësimi i potencialit të energjisë eolike në Shqipëri për ndërtimin e fermave të erës dhe Ndërtimi i një Centrali Eolik në det (off Shore)	MIE/ KESH	Energjia	Energjia e rinovueshme	€ 100,000,000	I pamaturuar	7.2	04.3
113	Park Fotovoltaik Belsh 250 Mëp	MIE/ KESH	Energjia	Energjia e rinovueshme	€ 150,000,000	I pamaturuar	7.3	04.3
114	Ndërtimi i bypass-it të Elbasanit	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 97,300,000	I pamaturuar	9.4	04.5
115	Ndërtimi i bypass-it të Librazhdit	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 120,000,000	I pamaturuar	9.1	04.5
116	Ndërtimi i rrugës së karvanit - rruga e lashtë e karvanit, Vlorë-Berat-Voskopojë-Korçë	MIE	Transporti	Transporti rrugor	€ 118,000,000	I pamaturuar	9.1	04.5

117	Rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të përdorura në zonën historike të qytetit të Durrësit	MIE	Mjedisi	Furnizimi me ujë	€ 50,000,000	I pamaturuar	14.1	05.2
118	Rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të përdorura në zonën rezidenciale të qytetit të Durrësit (Porto Romano, Spitallë, Shkozet)	MIE	Mjedisi	Furnizimi me ujë	€ 69,000,000	I pamaturuar	14.1	05.2
119	Rindërtimi i linjës 220 kV Vau i Dejës (Shqipëri) - Podgoricë (Mali i Zi) dhe zgjerimi në 400/220 kV i nënstacionit të Vaut të Dejës	MIE/ OST	Energjia	Transmetimi i energjisë	€ 66,000,000	I pamaturuar	7.3	04.3
120	Terminali LNG në Vlorë	MIE/ Albgaz	Energjia	Gazi	€ 120,000,000	I pamaturuar	8.4	04.3
121	Projektimi dhe investimi për përmirësimin e linjës së interkonjeksionit 220 kV,V. Dejë-Koplik-Podgoricë, 45 km	MIE/ OST	Energjia	Transmetimi i energjisë	€ 16,000,000	I pamaturuar	7.3	04.3
122	Rikonstruksioni i rrjetit 110 kV në zonën Veri-Lindore	MIE/ OST	Energjia	Transmetimi i energjisë	€ 13,000,000	I pamaturuar	7.3	04.3
123	Ndërtimi i një linje të re OHL 400 kV midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë dhe mbyllja e unazës së brendshme 400 kV	MIE/ OST	Energjia	Transmetimi i energjisë	€ 92,500,000	I Pamaturuar	17.6	04.3
124	Zhvillimi i Terminalit të Naftës në Porto Romano (Infrastruktura dhe menaxhimi i Portit të Naftës), refuar standardeve moderne të infrastrukturës detare	MIE	Energjia	Nafta	€ 8,200,000	I pamaturuar	13.2	04.3
125	Rindërtimi dhe zhvillimi i rrjetit naftësjellës shqiptar (nën administrimin e Albpetrol sh.a	MIE	Energjia	Nafta	€ 155,000,000	I pamaturuar	7.3	04.3
126	Rrjeti i Transmetimit të Gazit në qarkun e Fierit dhe Ballshit	MIE	Energjia	Gazi	€ 12,400,000	I pamaturuar	7.3	04.3

127	Rregullimi i parkut industrial dhe rehabilitimi i territoreve në ish Kombinatin Metalurgjik Elbasan, ish Uzinën e Plehrave Azotike Fier, impiantet e përpunimit dhe rafinimit të uzinës së bakrit Rubik dhe telat dhe kabllot e bakrit në Shkodër	MIE	Zhvillimi ekonomik	Industria	€ 5,000,000	I pamaturuar	9.4	04.4
128	Instalimi i matësve të zgjuar dhe balancimi në pikat e transformimit	MIE/ OSSH	Energjia	Eficienca e energjisë	€ 330,000,000	I pamaturuar	7.3	04.3
129	Zgjerimi i Nënstacionit të Fierzës me një transformator phase shift 400/220kV me fuqi 345MVA	MIE/ KESH	Energjia	Transmetimi i energjisë	€ 35,000,000	I pamaturuar	7.1	04.3
130	Zgjerimi dhe spostimi i Nënstacionit ekzistues Tirana 1 me nivel tensioni 400 kV	MIE/ KESH	Energjia	Transmetimi i energjisë	€ 17,000,000	I pamaturuar	7.1	04.3
131	Linja e re e interkonjeksionit nënujor HVDC Vlorë (Shqipëri)-Brindisi (Itali)	MIE	Energjia	Transmetimi i energjisë	€ 310,000,000	I pamaturuar	17.6	04.3
132	Digjitalizimi i Kaskadës së Drinit së bashku me rrjedhën e poshtme	MIE	Energjia	Eficienca e energjisë	€ 80,000,000	I pamaturuar	7.1	04.3
133	Ndërtimi i një centrali të ruajtjes së energjisë elektrike	MIE	Energjia	Eficienca e energjisë	€ 120,000,000	I pamaturuar	7.3	04.3
134	***Strategjia e Integruar Kombëtare e Sanitetit të ujit të pijshëm dhe Planifikimi i Investimeve[5]	MIE	Mjedisi	Furnizimi me ujë	€ 3,000,000	I pamaturuar	6.1	06.3
135	Digjitalizimi i Industrisë dhe krijimi i Akademisë Rajonale të Transformimit Digjital	MIE	Digjital	Ndërlidhja me brez të gjerë	€ 5,000,000	I pamaturuar	17.6	04.8
136	Krijimi dhe përmirësimi i sistemeve digjitale	MK	Digjital	Platformat e inovacionit	€ 10,000,000	I pamaturuar	16.6	08.5

[5] *** Vlera indikative e projektit në fjalë është vlera e aplikuar për grant në WBIF, me qëllim përfitimin e Asistencës Teknike për kryerjen e studimit të fisibilitetit. Pas përfundimit të studimit në gjithë territorin e Shqipërisë do të përcaktohet dhe vlera totale e projektit.

	në sektorin e kulturës							
137	Ndërtimi i Arkivit Digjital Kombëtar Kulturor	MK	Digjital	Platformat e inovacionit	€ 18,800,000	I pamaturuar	16.1	08.2
138	Amfiteatri i Durrësit	MK	Social	Kultura	€ 50,000,000	I pamaturuar	11.4	08.2
139	Ngritja e Shkollës Kombëtare për Restaurimin dhe Konservimin e Trashëgimisë Kulturore në Shqipëri	MK	Social	Arsimi dhe sportet	€ 4,500,000	I pamaturuar	11.4	08.5
140	Krijimi dhe përmirësimi i sistemeve digjitale në sektorin e shëndetësisë	MSHMS	Digjital	Infrastruktura e-GOV	€ 10,137,581	I pamaturuar	16.6	07.5
141	Shërbime të integruara shëndetësore dhe sociale të bazuara në komunitet për të gjitha kategoritë	MSHMS	Social	Shëndetësia	€ 12,000,000	I pamaturuar	3.8	07.4
142	Rrjeti kombëtar i shërbimeve për mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve që vuajnë nga abuzimi seksual dhe abuzimi i rëndë	MSHMS	Social	Shëndetësia	€ 8,400,000	I pamaturuar	3.7	10.9
143	Qendrat e rehabilitimit shëndetësor dhe social, të quajtura "Shtëpi mbështetje" për personat me çrregullime të rënda mendore	MSHMS	Social	Shëndetësia	€ 16,500,000	I pamaturuar	3.4	10.1
144	Fuqizimi, përmirësimi dhe modernizimi i rrjetit kombëtar të monitorimit të ajrit në Shqipëri	MTM/AKM	Mjedisi	Menaxhimi i mbetjeve, landfillet	€ 10,000,000	I pamaturuar	6.1	05.4
145	Projekti për zhvillimin e potencialit turistik të Luginës së Vjosës dhe krijimi i parkut kombëtar të Vjosës si destinacion turistik	MTM	Zhvillimi ekonomik	Zhvillimi rajonal	€ 10,000,000	I pamaturuar	8.9	05.4

Akronime dhe shkurtime

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKUM	Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
DSHQ	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
KM	Kryeministria
HSH	Hekurudha Shqiptare
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit

LEGJENDA

Në linkun https://albania.un.org/sq/sdgs do të gjeni të detajuara Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm OZHQ.

Në tabelën e mëposhtme do të gjeni përshkrimin e detajuar të COFOG-ut;

COFOG	COFOG_3G	COFOG Përshkrimi
01	**010**	Shërbime të përgjithshme publike
01.1	**011**	Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare dhe fiskale, punët e jashtme
01.2	**012**	Ndihma e huaj ekonomike
01.3	**013**	Shërbime të përgjithshme
01.4	**014**	Kërkime themelore
01.5	**015**	R&D Shërbime të përgjithshme publike
01.6	**016**	Shërbime të përgjithshme publike n.e.c.
01.7	**017**	Transaksionet të borxhit publik
01.8	**018**	Transfertat me karakter të përgjithshëm ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes
02	**020**	Mbrojtja
02.1	**021**	Mbrojtja ushtarake
02.2	**022**	Mbrojtja civile
02.3	**023**	Ndihma ushtarake e huaj
02.4	**024**	R&D Mbrojtja
02.5	**025**	Mbrojtja n.e.c.
03	**030**	Rendi dhe siguria publike
03.1	**031**	Shërbimet e policisë
03.2	**032**	Shërbime për mbrojtjen nga zjarri
03.3	**033**	Gjykatat ligjore
03.4	**034**	Burgjet
03.5	**035**	R&D Rendi dhe siguria publike
03.6	**036**	Rendi dhe siguria publike n.e.c.
04	**040**	Çështjet ekonomike
04.1	**041**	Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës

04.2	**042**	Bujqësia, pylltaria, peshkimi dhe gjuetia
04.3	**043**	Karburant dhe energji
04.4	**044**	Miniera, prodhim dhe ndërtim
04.5	**045**	Transporti
04.6	**046**	Komunikimi
04.7	**047**	Industri të tjera
04.8	**048**	R&D çështjet ekonomike
04.9	**049**	Çështjet ekonomike n.e.c.
05	**050**	Mbrojtja e mjedisit
05.1	**051**	Menaxhimi i mbeturinave
05.2	**052**	Menaxhimi i ujërave të ndotura
05.3	**053**	Pakësimi i ndotjeve
05.4	**054**	Mbrojtja e biodiversitetit dhe peizazhit
05.5	**055**	R&D Mbrojtje e mjedisit
05.6	**056**	Mbrojtja e mjedisit n.e.c.
06	**060**	Banesat dhe komoditet e komunitetit
06.1	**061**	Zhvillimi i banesave
06.2	**062**	Zhvillimi i komunitetit
06.3	**063**	Furnizimi me ujë
06.4	**064**	Ndriçimi në rrugë
06.5	**065**	R&D Strehimi dhe komoditet e komunitetit
06.6	**066**	Banesat dhe komoditet e komunitetit n.e.c.
07	**070**	Shëndeti
07.1	**071**	Produkte, pajisje dhe pajisje mjekësore
07.2	**072**	Shërbime ambulatore
07.3	**073**	Shërbime spitalore
07.4	**074**	Shërbime të shëndetit publik
07.5	**075**	R&D Shëndetësia
07.6	**076**	Shëndeti n.e.c.
08	**080**	Zbavitje, kultura dhe feja
08.1	**081**	Shërbime rekreative dhe sportive
08.2	**082**	Shërbime kulturore
08.3	**083**	Shërbime të transmetimit dhe botimit
08.4	**084**	Shërbime fetare dhe shërbime të tjera të komunitetit
08.5	**085**	R&D Rekreacioni kultura dhe feja
08.6	**086**	Rekreacioni, kultura dhe feja n.e.c.
09	**090**	Arsimi
09.1	**091**	Arsimi parashkollor dhe fillor
09.2	**092**	Arsimi i mesëm
09.3	**093**	Arsimi pas-sekondar jo-terciar
09.4	**094**	Arsim terciar
09.5	**095**	Arsimi jo i përcaktueshëm sipas nivelit
09.6	**096**	Shërbime ndihmëse për arsimin
09.7	**097**	R&D Edukimi
09.8	**098**	Arsimi n.e.c.
10	**100**	Mbrojtja sociale
10.1	**101**	Sëmundja dhe paaftësia
10.2	**102**	Mosha e vjetër
10.3	**103**	Të mbijetuarit
10.4	**104**	Familja dhe fëmijët
10.5	**105**	Papunësia
10.6	**106**	Strehimi
10.7	**107**	Përjashtimi social n.e.c.
10.8	**108**	R&D Mbrojtje sociale
10.9	**109**	Mbrojtja sociale n.e.c.

VENDIM
Nr. 448, datë 26.7.2023

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE 2023–2030

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 643, datë 14.9.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve", shfuqizohet.
3. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie, në bashkëpunim me institucionet e përcaktuara në planet e veprimit të saj.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

STRATEGJIA KOMBËTARE
E SEKTORIT PËR FURNIZIMIN ME UJË TË PIJSHËM, LARGIMIN, GRUMBULLIMIN E TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA URBANE 2023–2030

FALËNDERIME

Strategjia Kombëtare e Sektorit për Furnizimin me Ujë të Pijshëm, Largimin, Grumbullimin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane 2023–2030 është hartuar nga grupi ndërinstitucional i punës, i ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr. 165, datë 8.9.2022, me anëtarë:

Hantin Bonati	kryetar – MIE
Erjola Muka	anëtar – MIE
Kledia Ngjela	anëtar – MIE
Anisa Gjodedaj	anëtar – MIE
Gerta Ismailaja	anëtar – MIE
Laureta Sinani	anëtar – MIE
Gea Baduni	anëtar – MIE
Eliana Gjinali	anëtar – SASPAC
Enea Hoti	anëtar – MB
Arben Xhaferi	anëtar – MB
Valion Cenaliaj	anëtar – MFE
Almira Ferraj	anëtar – MFE
Zhaneta Miska	anëtar – MSHMS
Bukurie Çika	anëtar – MBZHR
Ylli Hoxha	anëtar – MTM
Kujtim Bebja	anëtar – AKM
Arduen Karagjozi	anëtar – AMBU
Rovena Metoja	anëtar – AMBU
Ndriçim Shani	anëtar – ERRU
Flauers Shoshi	anëtar – AKUM
Albana Jani	anëtar – AKUM
Adela Kila	anëtar – AKUM
L indita Molla	anëtar – ISHP
Elisabeta Poçi	anëtar – SHUKALB
Jovan Gjika	anëtar – AKUM
Arben Musaj	anëtar – AKUM

PËRMBAJTJA

1. PARASHTRIM
2. KONTEKSTI AKTUAL
2.1. FAKTORË TË PËRGJITHSHËM NË KONSIDERATË
2.1.1. Faktori demografik
2.1.2. Faktori hidrografik
2.1.3. Faktori zhvillimit ekonomik
2.2. KUADRI KRYESOR LIGJOR
2.3. KUADRI INSTITUCIONAL
2.4. PERFORMANCA AKTUALE E OFRIMIT TË SHËRBIMIT
2.4.1. Shkalla mbulimit/aksesi në shërbim
2.4.2. Cilësia e shërbimit
2.4.3. Eficienca e shërbimeve
2.4.4. Kuadri financiar
2.4.5. Infrastruktura dhe investimet
2.4.6. Sfidat dhe objektivat
3. QASJA POLITIKE
3.1. VIZIONI
3.2. MISIONI
3.3. PARIMET
3.4. QËLLIMET E POLITIKËS DHE REZULTATET/MASAT PRIORITARE
4. INVESTIMET MBËSHTETËSE TË POLITIKAVE STRATEGJIKE; PBA 2023–2025
4.1. INVESTIMET PËRBËRËSE TË PLANEVE STRATEGJIKE PËR ZBATIMIN E

DIREKTIVAVE PËR UJIN E PIJSHËM DHE UJËRAT E NDOTURA
4.1.1. Investimet përbërëse të planit strategjik për zbatimin e direktivës për ujin e pijshëm
4.1.2. Investimet përbërëse të planit strategjik për zbatimin e direktivës për trajtimin e ujërave të ndotura urbane
ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI
5. HYRJE
5.1. PLANET E DETAJUARA TË ZBATIMIT
5.2. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I STRATEGJISË
5.3. PËRDITËSIMI I STRATEGJISË
PLANI I VEPRIMIT DHE BURIMET FINANCIARE PËR ZBATIM
6. PLANET E VEPRIMIT NË MBËSHTETJE TË MASAVE PRIORITARE
6.1. NEVOJAT DHE BURIMET E FINANCIMIT
6.2. NEVOJAT KAPITALE PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE TË POLITIKËS DHE MASAVE PRIORITARE
6.3. NEVOJAT KORRENTE DHE KAPITALE TOTALE TË INVESTIMEVE PËR PERIUDHËN E PLANIFIKIMIT
6.4. STRUKTURA E TARIFAVE DHE PËRBALLUESHMËRIA
ANEKSI 1. FORMATI I PLANIT TË VEPRIMIT TË KOSTUAR DHE TË DETAJUAR
ANEKSI 2. FORMATET E MASAVE PRIORITARE

Lista e shkurtimeve dhe e termave

AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
ALL	Lek shqiptar (monedhë)
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
CAPEX	Shpenzimet kapitale
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FU&K	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime
INSTAT	Instituti i Statistikave
KBU	Këshilli i Baseneve Ujore
KKU	Këshilli Kombëtar i Ujit
MFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
OPEX	Shpenzimet e Operimit dhe Mirëmbajtjes
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
SHUKALB	Shoqata e Ujësjellës-Kanalizimeve të Shqipërisë
UPA	Uji pa të ardhura
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZABU	Zyra e Administrimit të Basenit Ujor

KAPITULLI 1
KONTEKSTI

1. PARASHTRIM

Shqipëria është një vend që e sheh veten si një komponent integral të projektit të zgjerimit evropian. Procesi i pranimit mori një zhvillim të dukshëm pas rekomandimit pozitiv të Komisionit Evropian për hapjen e negociatave, që është një inkurajim për të rritur më tej ritmin e reformave. Në këtë kontekst integrimi në BE, si një objektiv politik dhe gjeostrategjik, udhëheq hartimin e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shqipëria, si nënshkruese e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara për "Aksesin me ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime, si e drejtë e njeriut", është e angazhuar të demonstrojë, përmes veprimeve, që dhe pse në një stad zhvillimi, ka vullnetin dhe forcën për t'iu përgjigjur sfidave, duke bërë atë çka i takon për të garantuar barazi për të gjithë qytetarët, për sa u përket të drejtave të njeriut në lidhje me ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

Sa më lart, një ndër prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare është sigurimi i furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe grumbullimi, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura urbane, me qëllim përmbushjen e një detyrimi themelor në rritjen e standardeve të jetesës dhe të mirëqenies së popullsisë.

Reforma e qeverisë synon përmirësimin e ofrimit të të këtyre shërbimeve, të cilat direkt dhe indirekt kanë një ndikim thelbësor në rritjen dhe qëndrueshmërinë ekonomike të vendit.

Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë të Pijshëm, Grumbullimit, Largimit e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane 2023–2030 paraqet në mënyrë të qartë, specifike, sasiore dhe kohore vizionin, misionin, qëllimin e politikave dhe planet e veprimit, në përputhje me angazhimet e vendit tonë drejt arritjes së objektivave për zhvillimin e qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Qeveria shqiptare është e angazhuar për të përmbushur detyrimin e aksesit në furnizimin me ujë dhe të kanalizimeve për të gjithë popullatën, duke qenë e vetëdijshme se sigurimi i ofrimit të këtij shërbimi kërkon një qasje dhe një vizion të ri, për mënyrën e administrimit të sektorit, sikurse dhe vëmendje të shtuar për të siguruar financimet e nevojshme për të kryer investimet madhore infrastrukturore që nevojiten në sektor.

Qëllimi i Strategjisë është të orientojë nismat dhe hapat që do të ndërmerren për të përmbushur këtë objektiv.

Strategjia mbështetet në gjetjet dhe analizat e kryera nga konsultimet e grupit ndërinstitucional të punës dhe aktorët e tjerë të sektorit, një parashtrim të përgjithshëm të të cilave për të vizualizuar kontekstin aktual të ofrimit të shërbimit, kuadrin institucional e organizativ, ligjor dhe rregullator, financiar, do ta gjeni në këtë kapitull të parë.

2. KONTEKSTI AKTUAL

2.1. Faktorë të përgjithshëm në konsideratë

Në analizën e përgjithshme të faktorëve, të cilët kanë një ndikim domethënës në qasjen strategjike që do të synohet të implementohet në sektorin e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, grupi i punës është ndalur në mënyrë të veçantë të analizojë tre prej tyre:

- faktori demografik;
- faktori hidrologjik;
- faktori zhvillimor.

2.1.1. Faktori demografik

Faktori i parë, i cili është marrë në shqyrtim për të analizuar skenarët e zhvillimit të sektorit, si dhe për të dakordësuar mbi qasjen për përmbushjen e vizionit dhe misionit të Strategjisë, është ai demografik. Arsyeja e analizimit të këtij faktori ka të bëjë drejtpërdrejtë me thelbin e kësaj Strategjie, e cila ka si qëllim përmbushjen e nevojave të të gjithë popullatës me ujë të pijshëm dhe kanalizime. Gjithashtu, një element tjetër i drejtpërdrejt që lidhet me këtë faktor është edhe llogaritja e kostove të investimit, si dhe e kostove të investimit për njësi, si dhe e projeksioneve e tyre për harkun kohor të shtrirjes së Strategjisë.

Pra, pikësëpari, për të analizuar situatën aktuale dhe perspektivën e numrit të konsumatorëve që do të duhet të shërbehen.

Referuar të dhënave të INSTAT-it të vitit 2023, popullsia në Shqipëri: 2.761.785 banorë, ndërkohë projeksioni i popullsisë nga INSTAT-i për vitin 2031 llogaritet të jetë 2.745.996 banorë. Pra vihet re se numri i popullsisë pothuajse do të mbesë i njëjtë. Është e rëndësishme të analizohet në mënyrë krahasuese shifrat e popullsisë banuese në territorin e Shqipërisë, me atë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, si dhe të popullsisë së

identifikuar në zonën e shërbimit të operatorëve që ofrojnë shërbim në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të kuptohet sa është popullsia që shërbehet ose/dhe ka nevojë të shërbehet me shërbimin UK, si dhe sa prej kësaj popullsie përtej shërbimit të ofruar, konsumon ujë dhe prodhon ujë të ndotur. Pra është e qartë që ky faktor është përcaktues edhe për kapacitetin e veprave UK apo të impianteve përkatëse që do të nevojiten të ndërtohen.

Një tjetër aspekt që vlen të mbahet në konsideratë në hartimin e Strategjisë është dhe numri i shtuar i shtetasve të huaj që vijnë në Shqipëri, për afate të ndryshme qëndrimi, të cilët, gjithashtu, do të jenë përfitues të këtyre shërbimeve.

Referuar shtetasve të huaj që kanë hyrë në Shqipëri sipas të dhënave të INSTAT-it, numri i tyre përgjatë gjithë vitit 2022 ka qenë 7.543.817 shtetas. Ky numër me zhvillimin e sektorit të turizmit në vitet në vijim pritet që të ketë një trend rritës domethënës dhe kjo përbën një statistikë me vlerë shumë e rëndësishme në analizën e sektorit. Një analizë e thelluar e këtij dimensioni do të duhet të zhvillohet në mënyrë periodike dhe të përditësohet edhe në Strategji, për të kuptuar se ku dhe kur është piku i dendësisë së popullsisë në një bashki apo/dhe territor të operatorëve UK, si dhe për të ndërlidhur këtë dimension/të dhënë edhe me politikat tarifore dhe/apo të mbulimit të kostove.

Aspekt tjetër i mbajtur në konsideratë është lëvizja demografike migratore, e cila gjatë dekadës së fundit ka qenë e shtuar, duke pasur një shpërngulje nga zonat rurale, drejt atyre urbane. Ky trend gjykohet se do të vijojë i tillë dhe në vitet pasardhëse dhe do të duhet të kihet parasysh në planet zhvillimore infrastrukturore.

Rreth 54% e popullsisë së vendit jeton në qytete. Tri bashkitë më të mëdha (Tiranë, Durrës dhe Fier) përbëjnë gjysmën e popullsisë totale, ku 30% e popullsisë totale banon në Bashkinë e Tiranës, pasuar nga Bashkia Durrës me 11% dhe Bashkia Fier me 10%.

Mbi 1 milion njerëz janë të përqendruar në aksin Tiranë–Durrës, duke e bërë atë zonën më të madhe të banuar në Shqipëri.

2.1.2. Faktori hidrografik

Faktori i dytë i analizuar është ai hidrografik. Arsyeja e analizës së këtij faktori është e rëndësishme për të bërë një pasqyrim të qartë të potencialeve të burimeve ujore që janë në dispozicion për të furnizuar me ujë popullatën, sikurse dhe sfidat mjedisore për mbrojtjen e mjedisit dhe të cilësisë së burimeve ujore nga ujërat e ndotura urbane.

Burimet ujore

Burimet ujore në Shqipëri gjenden në formën e lumenjve, liqeneve, ujërave detare, akuifereve, burimeve gjeotermale dhe rezervuarëve artificialë.

I gjithë territori përshkohet nga shtatë lumenj kryesorë nga lindja në perëndim: Drini, Mati, Ishmi, Erzeni, Shkumbini, Semani dhe Vjosa. Në ultësirën perëndimore dhe gjatë luginave të lumenjve ka akuiferë të cilët kontribuojnë me rreth 23% në rrjedhjen totale vjetore. Përgjatë lumenjve janë ndërtuar 630 rezervuar artificialë, të cilët përdoren për ujitje, hidroenergji dhe ujë të pijshëm. Pellgu hidrografik i baseneve ujëmbledhëse të Shqipërisë shtrihet edhe jashtë kufijve territorialë të vendit.

Liqenet zënë 4% të territorit, nga ku mund të përmendim tri liqene të mëdha: liqeni i Shkodrës, liqeni i Ohrit dhe liqeni i Prespës, si dhe 247 liqene të vogla.

Shqipëria ka rreth 476 km vijë bregdetare, nga të cilat 326 km në detin Adriatik dhe 150 km në detin Jon.

Volumi mesatar shumëvjeçar i ujit që shkarkohet brenda një viti është 39.22 miliardë m^3/vit, nga të cilat 95% shkarkohen në detin Adriatik dhe vetëm 5% në detin Jon.

Furnizimi i këtyre burimeve bëhet nga reshjet atmosferike dhe regjimi i tyre është mesdhetar dhe faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në reshjet atmosferike janë vendndodhja gjeografike dhe topografia. Sasia më e madhe e reshjeve bie gjatë muajve të ftohtë (tetor–mars), me rreth 75% të shumës vjetore. Muaji më i pasur me reshje në gjithë territorin është nëntori, ndërsa muajt më të thatë janë korriku dhe gushti.

Burimet ujore për ujë të pijshëm

Aktualisht, Shqipëria siguron plotësimin e rreth 90% të nevojave të furnizimit nëpërmjet ujërave nëntokësore, të cilat kanë origjinën nga burimet natyrore dhe akuiferët nëntokësore dhe vetëm në dy raste nga trajtimi i ujërave sipërfaqësore të liqeneve artificiale të Bovillës dhe të Manskurisë.

Shqipëria karakterizohet nga burime të shumta ujore nëntokësore, të cilat dalin në formë natyrale në sipërfaqe. Këto burime kanë karakteristika shumë të mira fiziko-kimike dhe plotësojnë kushtet për t'u klasifikuar në burime potenciale për të siguruar nevojën për ujë të pijshëm. Megjithatë, shpërndarja

e tyre në hapësirën gjeografike të Shqipërisë nuk është e njëtrajtshme me përqendrimin e popullsisë.

Një faktor tjetër është sezonaliteti i këtyre burimeve, të cilat në zonat që kanë origjinë karstike, kanë luhatje të mëdha të prurjeve të tyre gjatë viti, kryesisht në periudhat e thata. Kjo është në disproporcion me kërkesën për ujë, e cila në sezonet e thata, edhe për shkak të rritjes së kërkesës për ujë të pijshëm, si rezultat i turizmit, mund të kthehet në një problematikë shqetësuese.

Zona e ultësirës perëndimore të Shqipërisë, ku është përqendruar edhe numri më i madh popullsisë (rreth 70 %), si dhe ku shtrihet zona bregdetare e siguron ujin për furnizimin e popullatës nga ujërat nëntokësore me ngritje mekanike, nëpërmjet puseve nga akuiferet që shtrihen kryesisht në tarracat e zonave të ulëta të lumenjve tanë kryesorë.

Megjithëse, në bilancin vjetor të ciklit natyror të burimeve ujore, Shqipëria rezulton të ketë burime të mjaftueshme për të siguruar volumin vjetor të nevojshëm për furnizimin me ujë të popullatës, shpërndarja jouniforme e kapacitetit të burimeve dhe e nevojës për furnizim gjatë vitit bën të nevojshëm dhe domosdoshëm miradministrimin e tyre.

Faktor tjetër që kërkon vëmendje për sigurimin e nevojës për ujë në periudhën e pikut të kërkesës janë faktori i ndryshimeve klimatike, i cili ka zgjatur periudhat e thatësirave, duke vështirësuar mbajtjen e një balance ujore të qëndrueshme të ujërave nëntokësore, që ndikon në uljen e kapaciteteve të tyre nën mesataren shumëvjeçare.

Në vitet e fundit, zhvillimi i infrastrukturës dhe i turizmit ka sjellë një proporcion të zhdrejtë të kapacitetit të burimeve në periudhën e thatë të vitit: korrik, gusht, shtator kundrejt kërkesës për ujë që rritet shpesh herë përtej kapaciteteve të planifikuara nga fluksi i turistëve.

Për të gjitha sa më sipër, është e nevojshme identifikimi i të gjitha trupat ujorë të destinuar për konsum njerëzor, që japin mesatarisht mbi 10 m^3 në ditë, ose që furnizojnë më shumë se 50 njerëz, kërkesë kjo edhe e direktivës kuadër të ujit të BE-së. Këto burime duhet të vlerësohen potencialisht nëse në të ardhmen mund të integrohen në skema të ndryshme të furnizimit me ujë të popullatës.

Referuar raportit vjetor të bilancit vjetor të ERRU-së për vitin 2022, vëllimi i përgjithshëm i ujit të prodhuar ishte 304,3 milionë metra kub, ndërsa kërkesa totale e vëllimit të ujit në të gjitha zonat e juridiksionit të shoqërive ujësjellës-kanalizime, për popullsinë totale, vlerësohet të jetë 100 milionë metra kub.

Bazuar në sa me sipër, uji total i disponueshëm për të gjitha shoqëritë UK tejkalon shumë ndjeshëm kërkesën kombëtare nga konsumatorët. Megjithëse kjo na tregon se kapaciteti ujor është i mjaftueshëm, bazuar në raportet vjetore të bilancit të ujit të hartuara nga ERRU-ja, ka dallime të dukshme ndërmjet shoqërive ujësjellës-kanalizime dhe në raste të veçanta ka disa shoqëri UK për të cilat kërkohen burime të reja shtesë të furnizimit me ujë.

Një faktor tjetër që do të duhet të ketë vëmendje të shtuar edhe në vitet në vijim është ruajtja, jo vetëm e sasisë së ujërave, por dhe e cilësisë së tyre, nëpërmjet identifikimit të zonave të mbrojtura sanitare dhe përcaktimin dhe zbatimin e kushteve për mbrojtjen e tyre.

2.1.3. Faktori zhvillimit ekonomik

Faktori i tretë i rëndësishëm për t'u mbajtur në konsideratë është dhe ai i zhvillimit social-ekonomik të vendit, ku kryesisht për efekt të këtij dokumenti strategjik, rëndësi të veçantë marrin:

- analiza e zhvillimit të sektorit të turizmit, duke u fokusuar më specifikisht në numrin e turistëve të huaj, të cilët do të duhet të merren në konsideratë si nevoja shtesë për volume të shtuara të sasisë së ujit të pijshëm në rrjet, sikurse dhe për të marrë masa për largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane me sasi të shtuara;

- zhvillimi i vrullshëm infrastrukturor ndërtimor kryesisht dhe në zonat turistike dhe bregdetare, që është drejtpërdrejtë i lidhur dhe me sa më sipër, zhvillimin e turizmit.

Kriza globale financiare evidentoi dobësitë e modelit të rritjes dhe theksoi nevojën për t'u zhvendosur nga nxitja e konsumit, drejt rritjes së investimeve dhe eksportit.

Gjithsesi, sipas vlerësimit të Bankës Botërore, Shqipëria po zbaton reforma të rëndësishme strukturore që do të mbështesin rritjen e barabartë, do të rrisin produktivitetin dhe konkurrencën në ekonomi, do të krijojnë më shumë vende pune dhe do të përmirësojnë qeverisjen dhe ofrimin e shërbimeve publike. Lidhja dhe aksesi i përmirësuar rajonal në tregjet rajonale dhe globale, së bashku me eksportin dhe diversifikimin e tregut, mund të ndihmojnë, gjithashtu, në nxitjen e rritjes më të shpejtë.

Pasi i kaloi mirë pasojat e tërmetit, pandemisë dhe krizës së çmimeve, fokusi i Qeverisë është tani në rimëkëmbjen e plotë me vëmendje të veçantë në turizmin, bujqësinë dhe digjitalizimin. Është inkurajuese të shihet se ka një vëmendje të shtuar ndaj ndryshimeve klimatike dhe ndërhyrjeve miqësore ndaj mjedisit në sektorët ekonomikë.

Gjatë viteve 2021–2022, ekonomia përjetoi një rikthim të fortë me rritjen e rikuperimit të plotë në nivelet para pandemisë dhe rigjallërimin e udhëtimeve, ndërtimit dhe industrisë nxjerrëse.

Qeveria e Shqipërisë në vitet e fundit po ndjek një program të gjerë të fokusuar në qëndrueshmërinë makroekonomike dhe fiskale, stabilizimin e sektorit financiar, përmirësimin e sektorit energjetik, pensionet, administratën vendore, si dhe një fokus të veçantë ka marrë dhe sektori i turizmit dhe zhvillimi i industrisë së ndërtimit.

Turizmi, në vizionin e qeverisës, shihet si sektori që do të garantojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, duke siguruar punësim, nxitje të ndërmarrjeve të vogla e të mëdha, më shumë të ardhura e më shumë mirëqenie për qytetarët.

Pikërisht, duke mbajtur në konsideratë këtë synim zhvillimor, një vëmendje të shtuar merr dhe përmirësimi me hapa të shpejtë të shërbimeve bazë të furnizimit me ujë me cilësi maksimale dhe të pandërprerë, sikurse dhe ato të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura urbane, me qëllim mbrojtjen e mjedisit.

Duke qenë se zhvillimi turistik i së ardhmes së afërt nuk është i fokusuar vetëm në sezonin veror dhe në frekuentimin e vijës bregdetare, por synohet të jetë gjithëvjetor dhe i shtrirë në mënyrë kapilare në të gjithë territorin e vendit, ky është një faktor tjetër që do të mbahet në konsideratë në mënyrën e shpërndarjes së investimeve në sektorin e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, të cilat do të maksimalizojnë efektin që do të kenë.

Nga studime të ndryshme të fokusuara në impaktin që ka përmbushja e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 6, "uji i pastër dhe saniteti", në objektivat e tjerë të zhvillimit të qëndrueshëm del e qartë se realizimi i sigurimit të aksesit kontribuon edhe në reduktimin e varfërisë dhe në rritjen e qëndrueshme të ekonomisë (Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 8, "Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike").[6]

2.2. Kuadri kryesor ligjor

Disa nga aktet kryesore ligjore mbi të cilat mbështet gjithë veprimtaria e sektorit janë:

- Ligji nr. 8102, datë 3.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

Ky ligj, i cili është një nga aktet më të rëndësishme të sektorit, aktualisht është në proces rishikimi dhe synohet që ligji i ri i rishikuar të propozohet dhe të miratohet së shpejti. Ky ligj synon të ndërtojë kornizën kryesore të funksionalitetit të sektorit.

- Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe ato të organeve të tyre përkatëse.

Në të përcaktohen dhe detyrimet që kanë organet e qeverisjes vendore në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë (prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm), si dhe për ujërat e ndotura urbane (grumbullimi, transportimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura).

Në këtë ligj parashikohet dhe përcaktohet dhe forma e bashkëpunimit midis dy ose më shumë njësive të vetëqeverisjes vendore (në formën e një "Subjekti të kompetencave të përbashkëta") për të kryer funksione specifike dhe për të ofruar shërbime në funksion dhe në dobi të banorëve të tyre (aplikuar aktualisht në sektor). Pikërisht mbi këtë përcaktim po ndërtohet dhe qasja aktuale e riorganizimit të sektorit.

- Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"[7]

Ky ligj synon të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar, gjithashtu, rregullat e trajtimit mjedisor dhe detyrimet për shkarkuesit e ndotësve. Objektivat kryesorë të zbatimit të këtij ligji janë dhe ujërat e ndotura urbane.

- Ligji nr. 111, datë 15.11.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"[8]

[6] Cross sectoral benefits of actions in sanitation https://washmatters.wateraid.org/publications/cross-sectoral-benefits-of-action-in-sanitation

[7] Ndryshuar sipas ligjit nr. 34/2013.

[8] Ndryshuar sipas ligjit nr. 6, datë 8.2.2018.

Ky ligj ka për objektiv kryesor mbrojtjen dhe përmirësimin e burimeve ujore (ujërat sipërfaqësore, ujërat territoriale, ujërat ndërkufitare dhe ujërat nëntokësore) për përdorimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve, si dhe për ndarjen e duhur të këtyre burimeve ujore bazuar në përdorimin dhe qëllimin e synuar.

- Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për shoqëritë tregtare"

Ky është ligji kuadër për organizimin dhe për funksionimin e shoqërive tregtare, i cili është i aplikueshëm dhe për operatorët e këtij shërbimi.

Kuadri Kombëtar i Ujit në përputhje me direktivat e BE-së për ujin e pijshëm dhe për ujërat e ndotura[9]

Në përputhje me detyrimet e saj në fushën e ujit dhe si pjesë e objektivit strategjik të Shqipërisë për të hyrë në BE, qeveria e Shqipërisë ka punuar për të harmonizuar legjislacionin e saj me kuadrin ligjor të BE-së dhe synon të krijojë përgjegjësi të qarta për zbatimin e *acquis* të BE-së. Prandaj, në fushën e cilësisë së ujit ka pasur përparim në drejtim të transpozimit të Direktivës Kuadër të Ujit me miratimin e ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore". Transpozimi i Direktivës së Ujit të Pijshëm konsiderohet i realizuar 100% me miratimin e VKM-së nr. 379, datë 25.5.2016, "Për miratimin e rregullores për cilësinë e ujit të pijshëm".

Ligji nr. 111/2012 i ndryshuar me ligjin nr. 6/2018, datë 8.2.2018 dhe VKM-në nr. 177, datë 31.3.2005, "Për normat e shkarkimeve të lejuara të ujit dhe kriteret e tyre të zonimit në mjedisin ujor të pranuar", ka transpozuar disa nga dispozitat e Direktivës së Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane.

Si pjesë e progresit në fushën e administrimit të ujit konsiderohet edhe miratimi i VKM-së nr. 1014, datë 16.12.2020, "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative për kërkesat për përdorimin, shkarkimin e ujit dhe ndërtimin e objekteve e veprave ujore," si dhe miratimi i VKM-së nr. 993, datë 9.12.2020, "Për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkufitare, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre".

2.3. Kuadri institucional

Përgjegjësia për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane shtrihet në të dyja dimensionet e qeverisjes, asaj qendrore dhe asaj vendore.

Qeverisja qendrore është përgjegjëse për përcaktimin e vizionit strategjik të sektorit dhe hartimin dhe monitorimin e kuadrit rregullator mbi të cilin mbështetet gjithë sektori, ndërsa qeverisja vendore është përgjegjëse për ofrimin e këtij shërbimi.

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e shkurtër e kuadrit kryesor institucional, përgjegjës për të organizuar dhe për të rregulluar shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision të saj:

- hartimin, zbatimin dhe ndjekjen e politikave të zhvillimit infrastrukturor;
- drejtimin, menaxhimin, mbikëqyrjen dhe vendosjen e standardeve teknike të infrastrukturës;
- monitorimin e realizimit të standardeve të përcaktuara në funksion të zhvillimit të infrastrukturës, si dhe të punimeve të ndërtimit për zbatimin e rregullave për kontrollin e disiplinimin e tyre në aspektin financiar e teknik.

MIE, në bashkëpunim dhe me ministritë e tjera të linjës, ka rolin parësor të kanalizimit të fondeve të donatorëve dhe të buxhetit qendror për investime kapitale, bazuar në vlerësimin e nevojave sipas masterplanit kombëtar dhe nevojave që vijnë nga qeverisja vendore.

- Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM)

AKUM-ja, si strukturë në varësi të MIE-s, përfaqëson institucionin teknik të specializuar të qeverisjes qendrore në sektorin e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të agjencisë përfshijnë analizën, hartimin dhe ndjekjen e planeve të veprimit në zbatim të politikave dhe strategjive të miratuara.

Në kuadër të nismës së qeverisë shqiptare për reformimin e sektorit, AKUM-ja është aktori përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e reformës sektoriale. Procesi i rajonalizmit të shoqërive UK kërkon angazhim të konsiderueshëm të të gjithë

[9] Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2019–2021.

strukturave aktuale të AKUM-së, por edhe të strukturave të reja qeveritare.

Referuar zhvillimeve të fundit në sektor, AKUM-ja është pjesë integrale aktive e subjektit të kompetencave të përbashkëta dhe ka rolin kryesor për të planifikuar dhe për të zbatuar siç duhet procesin e agregimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët e tjerë kryesorë pjesëmarrës në këtë proces.

- Njësitë e qeverisjes vendore

Qeveria shqiptare ka zhvilluar dhe ka zbatuar me sukses reformën administrative territoriale, duke riorganizuar njësitë e qeverisjes vendore në 61 bashki.

Në kontekstin e kësaj Strategjie, në fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike, bashkitë për territorin nën juridiksionin e tyre janë përgjegjëse, për:

- prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm;
- mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", përveç saktësimit të përgjegjësisë së mësipërme, parashikohet dhe mënyra se si dy apo më shumë njësi bashkëpunojnë, duke krijuar dhe një subjekt të përbashkët.

Në maj të vitit 2022, Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, ka miratuar vendimin nr. 302, i cili përcakton politika të reja për ristrukturimin e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, mbështetur pikërisht mbi përcaktimin e mësipërm.

- Operatorët e shërbimit

Nisur nga vendimi i Këshillit të Ministrave, "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane", shumica e shoqërive aksionare (operatorëve) ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve po riorganizohen (disa tashmë të finalizuara) si subjekte me kompetenca të përbashkëta (në vijim "SKP"), sipas sistemit të administrimit me dy nivele. Procesi i rajonalizimit të shoqërive ekzistuese dhe krijimi i SKP-së, sipas hartës dhe miratuar me VKM-në nr. 302, datë 11.5.2022, kërkoi dhe po merr miratimin nga organet e vetëqeverisjes vendore. Qasja e re konsiston në krijimin e shoqërive të reja të agreguara aksionare, sipas sistemit me dy nivele administrimi, në përputhje me përcaktimet në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Njësitë e qeverisjes vendore që kanë dakordësuar, apo do të bien dakord për themelimin e SKP-UK-së, kanë nënshkruar, apo do të nënshkruajnë, marrëveshjen dhe statutin tip, të cilat shërbejnë si akte themelore për krijimin e SKP-UK-së, e cila do të kryejë veprimtarinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura në tërë territorin administrativ që më parë mbulohej nga shoqëritë e veçanta.

SKP-UK sh.a. të krijuara deri më sot iu transferuan të gjitha të drejtat, detyrimet, si dhe veprimtaria ekonomike e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për transferimin e aktivitetit të shoqërive ekzistuese te sh.a.

- Enti Rregullator i Ujit (ERRU)

ERRU-ja është një institucion publik i pavarur, i cili ka rol kryesisht rregullator në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për të siguruar mbrojtjen e interesit publik dhe për të krijuar një kuadër transparent veprimtarie të aktorëve të përfshirë.

Disa nga funksionet kryesore të ERRU-së janë:

- të licencojë të gjithë personat fizikë dhe juridikë që u japin shërbime të furnizimit me ujë dhe/ose ujërave të ndotura për publikun;
- të sigurojë që ofruesit e shërbimeve ofrojnë shërbime cilësore dhe efikase me një çmim të arsyeshëm;
- të rregullojë tarifat e shërbimeve, në një mënyrë që siguron qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve, si dhe përballueshmërinë për konsumatorët;
- të monitorojë performancën e operatorëve të shërbimit në përgjithësi, si dhe të hartojë dhe të paraqesë raporte vjetore përkatëse pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), bazuar në prioritetet e qeverisë, është përgjegjëse për alokimin e burimeve financiare për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për plotësimin e nevojave të shoqërisë.

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) ka përgjegjësinë për të siguruar që të gjitha aspektet mjedisore kryesorë të ujit, si dhe direktivat e BE-së

të transpozohen dhe të zbatohen në Shqipëri. Institucioni në varësi i kësaj ministrie që luan rol të rëndësishëm në çështjet e ujit është dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në të cilën përfshihet struktura e inspektoratit përgjegjës për ujin, si dhe ajo e monitorimit të cilësisë së ujërave.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në sektorin e kujdesit shëndetësor. Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ministria është përgjegjëse për inspektimin dhe monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm përmes institucioneve të saj si njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe Institutit të Shëndetit Publik.

- Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU)

KKU-ja është një autoritet qendror vendimmarrës në fushën e administrimit të burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë. Ai është organi kryesor ndërinstitucional i kryesuar nga zëvendëskryeministri dhe ministritë e linjës përgjegjëse për hartimin e politikave dhe të planeve për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore

Është autoriteti ekzekutiv i KKU-së dhe është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive që lidhen me burimet e integruara të ujit në Shqipëri, duke siguruar funksionimin dhe monitorimin efektiv të sistemit plotësisht të integruar të ujit në vend. Agjencia luan, gjithashtu, rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit.

- Këshillat e Baseneve Ujore

Janë ngritur sipas VKM-së nr. 696, datë 30.10.2019, "Për miratimin e kufijve territorialë dhe hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe përbërjen e këshillit të tyre", ndërsa zyrat e administrimit të baseneve ujore (4) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në varësi të Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

2.4. Performanca aktuale e ofrimit të shërbimit

2.4.1. Shkalla mbulimit/aksesi në shërbim

Gjatë dekadës së fundit mbulimi i furnizimit me ujë është rritur ndjeshëm në zonat urbane, ndërkohë mbulimi me sistemin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura ka pësuar rritje të lehtë, kryesisht në zonat urbane. Ndërkohë, pavarësisht investimeve për ndërtimin e impianteve për trajtim të ujërave të ndotura vijon të ketë nevoja të mëdha për investime në të ardhmen.

Të dhëna të detajuara lidhur me shtrirjen e rrjeteve dhe aksesit me ujë të pijshëm dhe me kanalizime për çdo zonë shërbim, ashtu sikurse dhe në rang kombëtar, janë të aksesueshme duke iu referuar raporteve vjetore të publikuara nga të ERRU-ja[10]. Sidoqoftë, leximi dhe kryerja një analize krahasimore ndër vite të këtyre raporteve, nisur nga fakti i ndryshimeve të zonave të administrimit dhe të mbulimit nga ana e operatorëve të licencuar, paraqitet i vështirë.

Më poshtë do të gjeni një përshkrim të përgjithshëm të situatës për të dhënë një kontekst të përgjithshëm të situatës aktuale.

- Shërbimet për furnizimin me ujë

Mbulimi i përgjithshëm i furnizimit me ujë në nivel kombëtar, në vitin 2022, paraqitet në nivelin 78,12%. Referuar historikut, gjatë dekadës së fundit ka pasur një përmirësim të ndjeshëm lidhur me shërbimin e furnizimit me ujë, si rezultat i rritjes së investimeve dhe i uljes së informalitetit. Numri i kontratave me furnizim me ujë gjatë viteve të fundit ka ardhur gjithnjë e në rritje.

- Shërbimet për kanalizimet

Gjatë dekadës së fundit mbulimi i përgjithshëm me kanalizime është përmirësuar gradualisht, ndonëse me hapa më të ngadaltë. Ky përmirësim ka ardhur për shkak të rritjes së mbulimit me kanalizime në zonat urbane, ndërkohë që mbulimi me kanalizime në zonat rurale nuk ka pasur përmirësime të ndjeshme. Bazuar në të dhënat e vitit 2022, shërbimi i kanalizimeve iu ofrohet rreth 74,17% të konsumatorëve që janë të lidhur në rrjetin e furnizimit me ujë. Kjo statistikë luhatet nga rreth 92% në zonat urbane, në rreth 28% në zonat rurale.

- Trajtimi i ujërave të ndotura

Qeveria shqiptare, në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit të turizmit dhe procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, ka në prioritetet e saj dhe ndërtimin e infrastrukturës të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, ku fokus të veçantë janë zonat turistike. Referuar të dhënave nga AKUM-ja, aktualisht janë ndërtuar dhe janë në funksionim 12 impiante në zonat urbane dhe turistike, si dhe janë në proces ndërtimi 3 impiante të reja. Gjithashtu,

[10] https://erru.al/an/raportet/

janë planifikuar për t'u ndërtuar 2 impiante në zona urbane me potencial të lartë zhvillimi turistik.

Gjatë vitit 2022, në impiantet e trajtimit, trajtohen ujërat e ndotura që gjenerohen nga rreth 20,7% e numrit total të kontratave të abonentëve.

Në këtë drejtim, gjithashtu, ofrohet shërbimi i pastrimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura për një numër i konsiderueshëm të konsumatorëve që kanë gropa septike.

2.4.2. Cilësia e shërbimit

Si rezultat i rritjes së investimeve kapitale, është rritur ndjeshëm cilësia e ofrimit të këtyre shërbimeve. Pavarësisht këtij fakti, ka ende nevojë mjaft të madhe për përmirësime cilësore për të përmbushur standardet më të mira për konsumatorët.

Të dhëna të detajuara lidhur me indikatorët ndër vite mund të gjenden në raportet periodike të ERRU-së, të cilat janë të publikuara.

Më poshtë, në mënyrë shumë të përmbledhur, po listojnë dy indikatorë kryesorë të lidhur drejtpërdrejt me aktualitetin e cilësisë së ofrimit të shërbimit:

- *Vazhdimësia e shërbimit*

Në nivel kombëtar, vazhdimësia e shërbimit është vlerësuar mesatarisht rreth 15,6 orë/ditë për vitin 2022. Si rrjedhojë e investimeve të shumta për optimizimin e sistemeve të furnizimit me ujë, vitet e fundit rezulton përmirësim në orët e furnizimit me ujë, sidomos për zonat urbane, ku sipas të dhënave në vitin 2022 janë 33 zona urbane dhe 20 zona rurale me furnizim rreth 20 orë/ditë. Gjithsesi, këto shifra theksojnë se vazhdimësia e shërbimit mbetet një sfidë e vërtetë që duhet të adresohet nga operatorët e shërbimit. Me shtimin e investimeve kapitale për vitet 2023–2025, synohet të sigurohet furnizimi i vazhdueshëm 24 orë/ditë për të gjitha zonat urbane.

- *Cilësia e ujit të pijshëm*

Në vitin 2022, norma mesatare e sigurisë për klorin mbetës ishte 95% dhe për koliformën 98%. Si rrjedhojë e fokusit për optimizimin e sistemeve të furnizimit me ujë, vitet e fundit rezulton se nëpërmjet investimeve të kryera në automatizimin e dezinfektimit është rritur siguria e cilësisë së ujit. Sigurimi dhe monitorimi i cilësisë, krahas automatizimit, është shoqëruar, gjithashtu, edhe me investime në pajisje laboratorike për këtë shërbim, duke rritur monitorimi i cilësisë së ujit. Në të ardhmen, në kuadër të reformës së ristrukturimit të sektorit synohet plotësimi i infrastrukturës së laboratorëve rajonalë në të gjitha shoqëritë e reja të krijuara.

Pavarësisht sa më sipër, ka ende shoqëri që hasin vështirësi në ofrimin e shërbimit me ujë të pijshëm me cilësinë e duhur për konsumatorët e tyre.

2.4.3. Eficienca e shërbimeve

Shoqëritë UK përballen me nivele të larta të humbjeve të ujit, si pasojë e amortizimit të rrjeteve dhe të nevojës për përmirësim në menaxhim. Efikasiteti i shërbimit mbetet përgjithësisht i ulët, për shkak të nivelit të lartë të ujit pa të ardhura dhe performancës së dobët në drejtim të matjes, faturimit dhe mbledhjes së faturave, eficiencës së stafit dhe eficiencës së energjisë.

Duke pasur parasysh këtë fakt, nëpërmjet rajonalizimit të shoqërive UK synohet nxitja e një qasjeje të re për menaxhimin dhe për monitorimin e ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Qeveria shqiptare vlerëson se sfida për të reformuar këtë sektor kërkon instrumente efektive që do të mundësojnë maksimalizimin e të gjitha përpjekjeve për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve.

Të dhëna të detajuara ndër vite, lidhur me vlerësimin e parametrave të vlerësimit të eficiencës së shërbimeve, mund të gjeni në raportet periodike të ERRU-së.

Më poshtë, në mënyrë shumë të përmbledhur, po listojnë disa nga faktorët që gjykohet se japin një pasqyrë më të qartë mbi situatën aktuale.

- *Uji pa të ardhura (UPA) dhe mbulimi me matje*

Në vitin 2022, niveli mesatar i ujit pa të ardhura (UPA) për sektorin në tërësi ishte i rreth 63.4%, shifër ende shumë e lartë, por me një nivel përmirësimi krahasuar me të dhënat e viteve paraardhëse. Vlen të theksohet se kjo problematikë ndryshon shumë nga një shoqëri tek tjetra, duke variuar në vlerat 25%, deri 87%. UPA-ja mbetet shumë larg standardeve dhe praktikave më të mira dhe si e tillë, kjo problematikë është një nga sfidat kryesore që duhet të adresohet për të përmirësuar efikasitetin operacional dhe ekonomik të shoqërive UK.

Të dhënat për llogaritjen e UPA-së janë kryesisht vlerësime të përafruara, duke qenë se mungon matja në puse, në stacionet e pompimit, në rezervuarë, në rrjetin e shpërndarjes, si dhe në nivelin fundor, atë të matjes te konsumatorët.

Mbulimi me matje për të gjithë konsumatorët familjarë me gjithë përmirësimet e viteve të fundit,

mbetet në nivelin rreth 82% më 2022-shin. Si i tillë, instalimi i ujëmatëseve në të gjithë sistemin e furnizimit me ujë duhet të mbetet një nga objektivat kryesorë të shoqërive UK për të shmangur abuzimet dhe keqpërdorimin e ujit, reduktimin e nivelit të ujit pa të ardhura, përmirësimin e situatës ekonomike të shoqërive.

- Eficienca e arkëtimit

Niveli mesatar i arkëtimit korrent për sektorin, në vitin 2022, ishte rreth 78.6%, ndërsa ai i përgjithshëm 94.7%. Këta indikatorë kanë pësuar përmirësime gjatë viteve të fundit, pavarësisht luhatjeve vjetore, sidomos të lidhura me COVID-19, por edhe me pasojat e tërmetit të shtatorit dhe të nëntorit 2019. Duke u bazuar në reformën e ndërmarrë pritet që ky tregues të përmirësohet ndjeshëm në të ardhmen e afërt.

- Eficienca e stafit

Në vitin 2022, eficienca e stafit për të gjithë sektorin raportohet në 4.66 staf për 1000 lidhje, duke pasur përmirësim me vitet paraardhëse. Numri aktual i stafit të shoqërive UK është mbi standardet rajonale dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Lëvizja e stafit menaxherial pengon zhvillimin dhe profesionalizimin e punonjësve, ndaj mbështetja me politikat për zhvillimin e mëtejshme të kapaciteteve është e nevojshme për të siguruar dhe për të forcuar ekzistencën e një fuqie punëtore profesionale. Monitorimi dhe përmirësimi i këtij treguesi të performancës është i rëndësishëm, pasi kostoja e punës përfaqëson zërin kryesor të buxhetit të operimit dhe të mirëmbajtjes në shoqëritë UK, duke variuar nga 22% në 81% të OPEX-it dhe mesatarisht 34% në nivel kombëtar.

- Eficienca e energjisë

Energjia është një tjetër çështje e rëndësishme e buxhetit të operimit dhe të mirëmbajtjes në shoqëritë UK, e cila shkon deri në 80% të OPEX-it total, dhe mesatarisht 31,8% në nivel kombëtar në vitin 2022.

Niveli i lartë i kostos së energjisë ka sjellë që vit pas viti shoqëritë të kenë vështirësi financiare dhe të akumulojnë detyrime të konsiderueshme ndaj operatorit të furnizimit me energji. Gjatë vitit 2022 situata u përkeqësua me liberalizimin e tregut të furnizimit me energji dhe rritjes së çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët në tension të mesëm. Në këtë kuadër, adresimi i problematikës si pjesë e reformës së sektorit zgjidhi problematikën e çmimit të lartë të energjisë, duke aplikuar çmim të rregulluar për shoqëritë ujësjellës-kanalizime. Nëpërmjet vendosjes së çmimit të rregulluar gjatë vitit 2023 synohet mbulimi i faturës së energjisë elektrike në masën 95% në nivel sektorial nga 31% që ishte për vitin 2022. Në terma afatmesëm kjo masë e kombinuar me përmirësimin e menaxhimit dhe uljen e konsumit të energjisë synon mbulimin e faturës së energjisë elektrike në masën 100% në nivel sektorial.

2.4.4. Kuadri financiar

Situatë e përgjithshme financiare e sektorit paraqitet jopozitive.

Kjo vështirësi financiare me të cilën ndeshen aktualisht operatorët e bën të vështirë menaxhimin e duhur dhe të qëndrueshëm të veprimtarisë, e cila si një formë spirale në drejtimin negativ vijon më pas e përkeqëson më tej situatën financiare.

Për sa u përket të ardhurave nga tarifat ato përfaqësojnë afërsisht 46% të burimeve të financimit të përgjithshëm të sektorit. Subvencionet/taksat përfaqësojnë 32%, që kryesisht vijnë nga buxheti i shtetit, ndërsa transfertat nga donatorët e huaj përfaqësojnë deri në 22%.

Përballueshmëria e tarifave në Shqipëri ende nuk përbën problem, për shkak të nivelit të tyre të ulët. Fatura e ujit përfaqëson rreth 2.2% të të ardhurave për një familje me nivel mesatar të ardhurash. Ky nivel mbetet nën pragun prej 5%, i cili monitorohet nga ERRU-ja.

Tarifa mesatare për konsumatorët familjarë është në nivelin 41,66 lekë/m^3, e konsideruar e ulët për të mbuluar kostot e shërbimit, duke diktuar dhe analizën mbi nevojën për rishikim të tarifave.

Gjatë periudhës 2015–2022 burimi kryesor i financimit të sektorit të ujit kanë qenë financimet nga buxheti i shtetit dhe financimi i huaj. Megjithëse ka pasur rritje të tarifave të ujit gjatë dekadës së fundit, kjo rritje për mjaft shoqëri UK nuk ka qenë në nivelin për të bërë të mundur mbulimin deri 100% të kostove direkte të operimit dhe të mirëmbajtjes.

Shumica e shoqërive UK nuk janë në gjendje të mbulojnë kostot totale të operimit, për shkak të kombinimit të disa faktorëve, ku ndër më kryesorët mund të listojmë tri prej tyre: tarifa të ulëta shërbimi, nivel i ulët të arkëtimeve dhe niveleve të larta të ujit pa të ardhura. Mbulimi mesatar i kostos totale (U+K+ITUN) me arkëtimet është mesatarisht në masën 59%. Përveç kësaj, shoqëritë e vogla UK e kanë të vështirë të punësojnë staf të kualifikuar dhe

të gjenerojnë burime të mjaftueshme të ardhurash për të siguruar teknologji moderne për operimin dhe mirëmbajtjen e aseteve të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Procesi i rajonalizimit të shoqërive UK synon të përmirësojë situatën financiare të shoqërive nëpërmjet krijimit të ekonomisë së shkallës dhe një mirëmenaxhimi më kualitativ administrativ dhe financiar, i cili do të jetë dhe theksi në hartimin e planeve të biznesit për shoqëritë e reja.

2.4.5. Infrastruktura dhe Investimet

Sektori i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri është duke u përballur me problematikën e infrastrukturës së amortizuar, si pasojë e pamundësisë financiare për të kryer të gjitha investimet madhore të nevojshme.

Për shërbimet e ujësjellësit, asetet fikse nga pikëpamja financiare variojnë nga 0 në 157,000 lekë/banorë me një mesatare prej 16,000 lekësh/banorë, ndërsa mesatarja për ujërat e ndotura është shumë më e ulët, me 13,000 lekë/banorë dhe shkon nga 0 deri në 359,000 lekë/banor. Kjo do të thotë që kostot e amortizimit dhe kostot e mirëmbajtjes (llogaritur si pjesë e vlerës së aseteve) do të rriten me kalimin e kohës, kur infrastruktura e vjetër ekzistuese do të zëvendësohet dhe do të zgjerohet, duke përkeqësuar mbulimin e kostove operacionale për shërbimet UK.

Niveli i investimeve për periudhën 2017–2022 ka qenë në një mesatare vjetore prej 10.38 miliardë lekësh, të ndara pothuajse në mënyrë relativisht të barabartë midis furnizimit me ujë dhe infrastrukturës së ujërave të ndotura.

Edhe pse niveli i investimeve të realizuara në vite është i lartë, përsëri mbulimi i nevojave për investime kapitale mbetet i konsiderueshëm për të arritur mbulimin e plotë me ujësjellës dhe kanalizime në rang kombëtar.

Më poshtë, në formë tabelore, mund të gjeni nivelin e financimit të ndarë në dy zëra, financim i huaj dhe financim nga buxheti i shtetit, për periudhën 2017–2022.

Tabela 1: *Financimi i sektorit UK (në 000 lek)*

FINANCIMI	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Totali
Financimi i huaj	6 435 508	3 734 721	5 133 868	2 261 270	2 578 312	1 193 186	**21 336 865**
Buxheti i shtetit	4 187 758	3 380 970	4 139 814	7 904 355	12 910 076	8 428 226	**40 951 199**
TOTALI	**10 623 266**	**7 115 691**	**9 273 682**	**10 165 625**	**15 488 388**	**9 621 412**	**62 288 064**

Nga analiza e burimeve të financimit dhe destinacionit të investimeve, vlen të theksohet se financimi i huaj grant ka qenë i fokusuar kryesisht në drejtim të ujërave të ndotura, ndërsa financimi në kredi ka qenë i fokusuar kryesisht për furnizimin me ujë.

Gjithashtu, peshë e madhe në investimet për furnizim me ujë kanë qenë financimet nga buxheti i shtetit. Vëmendja e qeverisë vitet e fundit (2019–2022) është përqendruar kryesisht në investime për të mundësuar furnizimin pa ndërprerje me ujë kryesisht për zonat urbane, por pa lënë jashtë vëmendjes zonat rurale dhe bregdetare. Gjithashtu, projekte të tjera për furnizim me ujë në zonat rurale janë financuar edhe nga donatorë të huaj dhe kryesisht nga qeveria gjermane, të zbatuara përmes Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

2.4.6. Sfidat dhe objektivat

Në mënyrë të përmbledhur sfidat kryesore me të cilat po haset sektori i furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane janë nevoja, për:

- ndërhyrje të thella infrastrukturore në funksion të rritjes së shkallës së mbulimit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit, sipas standardeve më të mira ndërkombëtare;
- riorganizimin sa më eficient institucional;
- rritjen e profesionalizimit të burimeve njerëzore;
- reduktimin e diferencës ndërmjet nevojës për financim të sektorit, përkundrejt mundësive aktuale, duke riinxhinieruar të gjithë mënyrën e financimit;
- miradministrimin e aseteve;
- përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, duke pasur në vëmendje dhe përmbushjen e direktivave të BE-së.

KAPITULLI 2

VIZIONI, MISIONI DHE QËLLIMET E POLITIKËS

Një ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare është ofrimi i shërbimeve sa më cilësore të furnizimit me ujë, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urban.

3 QASJA POLITIKE

3.1 Vizioni

Deklarata e vizionit është një mesazh i thjeshtë, por i fuqishëm që përshkruan angazhimin për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime, si shërbime thelbësore dhe kritike për një jetë dinjitoze dhe cilësore.

VIZIONI
Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura për të gjithë popullatën në cilësinë dhe standardet optimale

3.2 Misioni

Bazuar në aspiratat e qeverisë shqiptare për zbatimin e direktivave të BE-së, deklarata e misionit pasqyron qëllimin themelor të kësaj strategjie.

MISIONI
Garantimi i ofrimit të një shërbimi gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe cilësor në furnizimin me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, me tarifa të përballueshme, në respektim të shëndetit publik, mirëqenies, mjedisit dhe në përmbushje të angazhimeve të marra për përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm

3.3 Parimet

Parimet kryesore mbi të cilat do të mbështetet qasja e re e ofrimit të shërbimeve të këtij sektori do të mbahen në konsideratë në hartimin e të gjithë planit të masave që do të ndërmerren.

PARIMET KRYESORE	
QËNDRUESHMËRI	*Ekologjikisht, teknikisht dhe financiarisht të qëndrueshëm përmes mbulimit të plotë të kostos.*
PËRPUTHSHMËRI	*Qasje universale që i plotëson të gjitha kërkesat rregullatore / europiane sipas parimit ndotësi paguan.*
EFICIENCË	*Performancë në organizimin dhe ofrimin e shërbimit sipas praktikave më të mira evropiane dhe sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.*

PËRBALLUESHMËRI	*Sigurimi i shërbimeve për konsumatorët me një çmim të përballueshëm.*
TRANSPARENCË	*Sigurimi i pjesëmarrjes së publikut dhe transparenca në politikat e ujit.*

3.4 Qëllimet e Politikës dhe Rezultatet / Masat Prioritare

Objektivat kryeseror të synuara janë bazuar në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit Qëndrueshëm, Qëllimi 6 (SDG6), që është:

6.1 (si referencë) Deri në vitin 2030, të arrihet akses universal dhe i barabartë në ujë të pijshëm dhe të sigurtë sipas rezultateve prioritare të parashikuara.

6.2 (si referencë) Deri në vitin 2030, të arrihet akses në kanalizime dhe higjienë të përshtatshme dhe të barabartë sipas rezultateve prioritare të parashikuara, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe ata që janë në situata të cënueshme.

Për përmbushjen e këtyre dy objektivave, në këtë dokument strategjik janë përcaktuar gjashtë (6) Qëllime të Politikës të cilat janë më specifike, të matshme dhe me afate kohore të përcaktuara.

Më tej, këto gjashtë Qëllime te Politikës janë përkthyer në Rezultate / Masa Prioritare të cilat do të detajohen nëpërmjet Planeve të Veprimit.

Secila Masë Prioritare është shoqëruar me një objektiv të caktuar të performancës që do të arrihen në afatet kohore të parashikuara dhe do të monitorohen gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kësaj Strategjie.

Tabela 3 paraqet Qëllime të Politikës dhe rezultatet e parashikuar të performancës për secilën masë prioritare, së bashku me vlerat e indikatorëve të performancës për secilin vit të periudhës së planifikimit të Strategjisë.

Pashaportat e detajuara të indikatorëve jepen në aneksin 3 të strategjisë.

Për të vendosur një referencë, si vit bazë është marrë 2022. Duke përdorur vlerat vjetore të vitit bazë për Treguesit e Performancës, u përcaktua një vlerë e arritshme për Treguesin e Performancës për vitin e fundit të periudhës së planifikimit, 2023-2030, si dhe vlerat e ndërmjetme për periudhën e planifikimit.

Këto tregues të parashikuara për secilën masë prioritare janë elementë kryesorë për të monitoruar, vlerësuar dhe raportuar progresin në zbatimin Strategjisë në termat kohore (2023-2025), dhe (2026-2030). Ato gjithashtu do të përdoren për të identifikuar çdo devijim në mes të performancës së parashikuar dhe arritjeve aktuale vjetore në terren dhe si rrjedhim të përcaktojnë veprimet korrigjuese dhe të përditësojnë Strategjinë kur është e nevojshme.

Procesi i monitorimit, raportimit dhe përditësimit të Strategjisë është detajuar më tej në pjeswn e katwrt.

Tabela 2: VIZIONI – MISIONI – QËLLIMET E POLITIKËS – REZULTATET / MASAT PRIORITARE

VIZIONI					
Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura për të gjithë popullatën në cilësinë dhe standardet optimale					
MISIONI					
Garantimi i ofrimit të një shërbimi gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe cilësor në furnizimin me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, me tarifa të përballueshme, në respektim të shëndetit publik, mirëqenies, mjedisit dhe në përmbushje të angazhimeve të marra për përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm					
Qëllimi i Politikës 1	**Qëllimi i Politikës 2**	**Qëllimi i Politikës 3**	**Qëllimi i Politikës 4**	**Qëllimi i Politikës 5**	**Qëllimi i Politikës 6**
Zgjerimi i numrit të konsumatorëve që kanë akses në sistemet e furnizimit me ujë dhe përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit	**Zgjerimi i numrit të konsumatorëve që kanë akses në sistemet e grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urban dhepërmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit**	**Zbatimi i programit për riorganizimin e shërbimeve në baza rajonale (agregimi)**	**Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare, përballueshmërisë së shërbimeve dhe administrimit të aseteve**	**Rritja e kapaciteteve dhe mirëadministrimi i shërbimeve**	**Përmirësimi dhe përditësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator**
REZULTATET / MASAT PRIORITARE	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**
Krijimi i një baze të dhënash reale dhe të besueshme *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2024* *Matja e saktë e sasisë së ujit në prodhim për zonat urbane;* *Matja e saktë e sasisë së ujit në prodhim për zonat rurale;* *Vlerësimi i humbjeve teknike dhe administrative;* *Vlerësimi i saktë i zonës së mbulimit me ujë dhe kanalizime të ndarë në zona urbane / rurale;* *Plani deri në 2027* *Ndërtimi i një baze të saktë, reale, transparente, në kohë reale dhe të detajuar të të gjithë të dhënave të furnizimit me ujë (asete/bnj/shërbim/financa/etj)*	***Krijimi i një baze të dhënash reale dhe të besueshme*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2027* *Ndërtimi i një baze të saktë, reale, transparente, në kohë reale dhe të detajuar të të gjithë të dhënave lidhur me shërbimin e grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urban (asete/bnj/shërbim/financa/etj)*	***Zhvillimi dhe nxitja e një programi të bashkërenduar me NJQV për riorganizimin shoqërive egzistuese në shoqëri rajonale, si Subjekte të Kompetencave të Perbashkëta*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2025:* *Të jenë krijuar 15 shoqëri rajonale të cilat do të cilat do të kenë përgjegjësi për të mbyuluar të gjithë territorin dhe kanë filluar të performojnë në mënyrë efektive dhe eficiente*	***Mbulimi i kostove të mirëmbajtjes dhe shpenzimeve për investime kapitale*** *Rezultatet e parashikuara:* *Të dhëna të sakta të panoramës financiare të sektorit* *Plani deri në 2025:* *Mbulimi i Kostos Totale në masën 72%* *Plani deri në 2030:* *Mbulimi i Kostos Totale në masën 95%*	***Hartimi i një platforme dhe mekanizimave për zhvillimin e njohurive dhe trajnimeve për të gjithë aktorët sektorialë në nivel qëndror dhe lokal.*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2024:* *Implementimi i një plani kombëtar për zhvillimin e kapaciteteve në nivel qëndror rajonal dhe lokal.* *Plani deri në 2027:* *Krijimi i një mekanizmi për nxitjen dhe afrimin e profesionistëve të rinj në sektor*	***Hartimi i ligjit te ri sektorial për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri 2024:* *Miratim në parlament i projektligjit për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.* *Plani në vazhdimësi:* *Miratimi dhe zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjorë në zbatim të ligjit për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.*
REZULTATET / MASAT PRIORITARE	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**
Zgjerimi i aksesit të popullatës në rrjetet e furnizimit me ujë të sigurt e cilësor *Rezultatet e parashikuara:* *Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë:* *Plani deri në 2025:* *82 %* *Plani deri në 2030:* *90 %*	***Rritja e aksesit të popullsisë të lidhur me sistemin e grumbullimit dhe largimit të ujrave të ndotura*** *Rezultatet e parashikuara:* *Mbulimi me sistemin e grumbullimit dhe largimit të ujrave të ndotura urban:* *Plani deri në 2025:* *55.5 %* *Plani deri ne 2030:* *65.5 %*	***Ristrukturimi dhe reformimi institucional në funksion të zbatimit të programit për riorganizimin e shërbimeve në baza rajonale*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2024:* *Reformimi i Agjencisë në varësi të MIE për tiu përgjigjur sfidave të riorganizimit rajonal* *Plani deri ne 2025:* *AKUM akreditohet për të të*	***Rikonceptimi dhe unifikimi i tarifave të shërbimit për sektorin, duke synuar mbulimin e kostove dhe mbrojtjen e konsumatorëve*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2024:* *Aplikimi i tarifave të rikonceptuara të furnizimit me ujë dhe kanalizime i minimalisht 5 Shoqërive Rajonale sipas metodologjisë së përcaktuar nga ERRU.* *Plani deri në 2027:* *Aplikimi i tarifave të rikonceptuara të furnizimit me ujë dhe kanalizime për të gjithë Shoqëritë Rajonale sipas*	***Garantimi i fondeve të nevojshme për rritjen e kapaciteteve profesionale, forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani afatshkurtër deri në 2024:* *1 % e fondit të pagave do të alokohet për trajnimin e vazhdueshem të personelit në nivel qëndror, rajonal dhe lokal.* *Bashkëpunim me institucionet akademike*	***Harmonizimi i plotë i kuadrit ligjor kombëtar për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në përputhje me direktivat europiane*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2024:* *VKM për përafrimin e legjislacionit me direktivën për trajtimin e ujrave të ndotura urbane dhe për Direktivën e Ujit të Pijshëm* *Plani deri në 2027:* *Përputhje e plotë e legjislacionit Shqiptar për ujin me direktivat e BE*

		administruar fonde të BE për infrastrukturën e furnizimit me ujë dhe kanalizimet. *Plani deri në 2030:* *Agjencia, qëndër ekselence dhe inovacioni për administrimin e shërbimeve dhe teknologjinë e Informacionit në sektor*	metodologjisë së përcaktuar nga ERRU.	*Plani ofatmesëm deri në 2027:* *1.5 % e fondit të pagave do të alokohet për trajnimin e vazhdueshem të personelit në nivel qëndror, rajonal dhe lokal.* *Plani afatgjatë deri në 2030:* *2 % e fondit të pagave do të alokohet për trajnimin e vazhdueshem të personelit në nivel qëndror, rajonal dhe lokal.*	*Plani deri në 2030:* *Zbatimi i plotë i legjislacionit dhe monitorimi*
REZULTATET / MASAT PRIORITARE	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**
Rritja e cilësisë së furnizimit me ujë për popullatën, në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërive rajonale *Rezultatet e parashikuara:* *Orët e furnizimit me ujë në të gjitha zonat ku ofrohet shërbimi në masën:* *Plani deri në 2025:* *18 orë/ditë* *Plani deri në 2030:* *24 orë/ditë*	***Rritja e aksesit të popullsisë të lidhur me një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura urban*** *Rezultatet e parashikuara:* *Mbulimi me sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura:* *Plani deri në 2025:* *16.5 %* *Plani deri në 2030:* *26 %*	***Ngritja e një sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë dhe impaktit të zbatimit të procesit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2024:* *Sisteme të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së operatorëve të shërbimit* *Plani deri në 2027:* *Informatizimi dhe ngritja e një platforme transparence të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së shërbimeve që ofrohen dhe qëndrueshmërisë financiare*	***Rritja e performancës në arkëtim*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2024:* *Sistem i unifikuar i faturimit në të gjithë shoqëritë rajonale (50%)* *Plani deri në 2027:* *Lexim (aksesi) online i faturës nga konsumatorët për të gjithë shoqëritë dhe mundësia e kryerjes së pagesës online për të gjithë shoqëritë rajonale UK.* *Plani deri në 2025:* *Nivelt arkëtimit korrent: 90%* *Plani deri në 2030:* *Nivelt arkëtimit korrent: 100%*	***Zbatimi i programit kombëtar të certifikimit sipas objektivave që janë përcaktuar për secilën shoqëri rajonale*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani afatshkurtër deri në 2024:* *Manuali i riskikuar për trajnimin dhe çertifikimin e punonjësve të shoqërive rajonale UK.* *Plani ofatmesëm deri në 2027:* *Programi i certifikimit funksional dhe i administruar nga Aqjencia.* *Plani afatgjatë deri në 2030:* *Stafe profesionale dhe të certifikuara*	***Zbatimi i mekanizmave për forcimin dhe përfshirjen gjinore, si dhe të pjesëmarrjes së komunitetëve lokale, në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në sektor*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani afatshkurtër deri në 2024:* *Studimi kombëtar për barazinë gjinore në sektorin e ujit* *Plani ofatmesëm deri në 2025:* *Përqindja e përfaqësimit të gjave në Këshillat Mbikqyrës është 50%* *Plani afatgjatë deri në 2030:* *Platforme funksionale komunikimi dhe përfaqësimi të njësive dhe komuniteteve lokale në proceset e planifikimit dhe miradministrimin e shërbimeve*
Hartimi dhe zbatimi i planeve rajonale për reodukdimin I nhvelit të Ujit Pa të Arduara *Rezultatet e parashikuara:* *Uji pa të ardhura:* *Plani deri në 2025: 60 %* *Plani deri në 2030: 45%*	***Hartimi i planeve për përdorimin e ujit me efikasitet duke rritur ndjeshëm ripërdorimin e tij sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2025:* *Rregullore për ripërdorimin e ujit;* *Plani deri në 2030:* *Model efektiv ekonomik per ofrimin dhe administrimin e shërbimeve sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.*	***Krijimi i rregulloreve dhe standardeve tip proceduriale të mënyrës së operimit*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2025:* *Hartimi dhe miratimi i manualeve tip të proceduravë që do të rrisin eficiencën e përmbushjes së detyrimeve operacionale*	***Hartimi dhe zbatimi efektiv i një sistemi të unifikuar të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së aseteve*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2025:* *Standarde të unifikuar për vlerësimin të aseteve* *Plani deri në 2027:* *Sistemi i digjitalizuar për administrimin e aseteve funksional në 10 shoqëri rajonale* *Plani deri në 2030:* *Sistemi i digjitalizuar për administrimin e aseteve funksional në të gjithë shoqëritë rajonale*	***Implementimi i strukturave organizative me eficience dhe efektivitet më të larë në shoqeritë rajonale*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani deri në 2024:* *Implementimi nga strukturat rajonale të një forme të re më efektive dhe eficiente organizimi të mbështetur dhe mbi risitë teknologjike*	***Hartimi dhe zbatimi i paketave të ndërgjegjësimit dhe informimit për qytetarët.*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani afatshkurtër deri në 2024:* *Plani kombëtar për informimin dhe ndërgjegjësimin.* *Plani ofatmesëm deri në 2027:* *Platforme sensibilizuese në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.*
REZULTATET / MASAT PRIORITARE	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**	**REZULTATET / MASAT PRIORITARE**
Përmirësimi i cilësisë së ujit të pijshëm *Rezultatet e parashikuara:*			***Implementimi i një qasje të re në investimet në sektor drejt reduktimit të konsumit të energjisë, nëpërmjet investimeve për furnizimin me energji nga***	***Hartimi dhe zbatimi i një plani të detajuar për transformimin digjital dhe i një qasje të integruar për sigurinë kibernetike për administrimin e shërbimeve të***	***Përmirësimi i akteve ligjore dhe rregulatore të nevojshme për të lehtësuar procesin e riorganizimit të shërbimeve në baza rajonale.***

Plani deri në 2025: *Ngritja e 15 laboratorëve rajonal për cilësinë e ujit.* *Plani deri në 2030:* *Përmbushja e kushteve për garantimin e cilësisë së ujit në përputhje me standardet më të mira* *Garantimi i zonave higjieno sanitare të sigurisë*			***fotovoltaikë, vendosjes se pompave sipas kritereve te BE dhe instalimi i programit SCADA që rrit efektshmerine e tyre*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani afatshkurtër deri në 2024:* *Plani për efiçensën e energjisë për të gjithë shoqëritë rajonale* *Plani deri në 2025:* *Ndërtimi i sisteme alternative për furnizimin me energji elektrike për 5 shoqëri rajonale* *Plani deri në 2030:* *Programi për efiçencën e energjisë funksional në të gjithë shoqëritë rajonale*	***furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.*** *Rezultatet e parashikuara:* *Plani afatshkurtër deri në 2024:* *konceptimi i infrastrukturës TIK dhe trajnimeve të nevojshme sipas axhendës kombëtare për digjitalizimin e shërbimeve për furnizimin me ujë dhe kanalizime* *Plani afatmesëm deri në 2027:* *Implementimi i platformës digjitale për administrimin e shërbimeve në nivel qëndror, rajonal dhe lokal, që ndërveprojnë në menyrë efektive* *Plani afatgjatë deri në 2030:* *80% e sistemeve infrastrukturore për furnizimin me ujë dhe kanalizimet, të automatizuara*	*Rezultatet e parashikuara:* *Plani afatshkurtër deri 2025:* *Miratim i gjithë paketës rregullatore dhe standardeve* *në funksion të aktiviteit për ofrimin e shërbimeve*

Tabela 3
Objektivat Strategjike dhe Indikatorët e Performancës

Nr	Objektivat Strategjike / Indikatorët e vlerësueshëm me %	Viti Bazë 2021	Plani Viti 2022	Plani Viti 2023	Plani Viti 2024	Plani Viti 2025	Plani Viti 2026	Plani Viti 2027	Plani Viti 2028	Plani Viti 2029	Plani Viti 2030
1	***Përshkrimi i qëllimit të politikës*** **Zgjerimi i numrit të konsumatorëve që kanë akses në sistemet e furnizimit me ujë dhe përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit**										
1.1	Mbulimi me Ujësjellës (Niveli Kombëtar)	77.7%	78.3%	79.7%	80.8%	82.0%	83.5%	85.1%	87.7%	88%	90%
1.2	Mbulimi me Ujësjellës për zonat urbane	92.0%	93.0%	94.0%	94.5%	95.0%	95.5%	96.0%	97.0%	98.0%	99.0%
1.3	Mbulimi me Ujësjellës për zonat rurale	57.9%	58.0%	60.0%	62.0%	64.0%	67.0%	70.0%	75.0%	80.0%	85.0%
1.4	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	15	15.5	16	17	18	19	20	21	22.5	24
1.5	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë (orë/ditë) në zonat urbane	16	17	18	19	20	21	22	23	24	24
1.6	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë (orë/ditë) në zonat rurale	12	13	14	15	16	17	18	19	20	24
1.7	Reduktimi i Ujit pa të Ardhura	65.4%	64.0%	63.0%	62.0%	60.0%	57.0%	52.0%	50.0%	48.0%	45.0%
1.8	Niveli i matjes së konsumit të ujit shprehur në numër lidhjesh	78.4%	80.0%	82.0%	85.0%	87.0%	90.0%	93.0%	95.0%	97.0%	100.0%
1.9	Sisteme automatike të dezinfektimit të ujit të pijshëm për të gjitha shoqëritë rajonale UK	-	-	30%	50%	70%	90%	100%	100%	100%	100%
1.10	Ngritja e Laboratoreve Rajonal për Cilësinë e Ujit të Pijshëm (15)	-	-	30%	50%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
1.11	Plane për Sigurinë e Ujit të përfunduara për të gjitha Shoqëritë UK	-	-	10%	20%	40%	60%	80%	90%	100%	100%
2	***Përshkrimi i qëllimit të politikës*** **Zgjerimi i numrit të konsumatorëve që kanë akses në sistemet e grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urban dhepërmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit**										
2.1	Mbulimi me Kanalizime (Niveli Kombëtar)	53.0%	53.5%	54.0%	54.5%	55.5%	56.8%	58.8%	60.8%	62.8%	65.5%
2.2	Mbulimi me Kanalizime për zonat urbane	82.4%	83.0%	83.5%	84.0%	84.5%	85.0%	87.0%	89.0%	91.0%	93.0%
2.3	Mbulimi me Kanalizime për zonat rurale	12.6%	13.0%	13.5%	14.0%	15.0%	18.0%	20.0%	22.0%	24.0%	26.0%
2.4	Mbulimi me Trajtim të Ujërave të Përdorura nga ITUP	14.4%	15.0%	15.5%	16.0%	16.5%	18.0%	20.0%	22.0%	24.0%	26.0%
2.5	Hartimi i planeve për përdorimin e ujit me efikasitet në të gjithë sektorët, duke siguruar furnizim te qëndrueshëm dhe duke rritur ndjeshëm ripërdorimin e tij sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.	-	-	5.0%	10.0%	20.0%	30.0%	45.0%	60.0%	80.0%	100.0%

Nr	Objektivat Strategjike / Indikatorët e vlerësueshëm me %	Viti Bazë 2021	Viti 2022	Plani Viti 2023	Plani Viti 2024	Plani Viti 2025	Plani Viti 2026	Plani Viti 2027	Plani Viti 2028	Plani Viti 2029	Plani Viti 2030
3	***Përshkrimi i qëllimit të politikës*** **Zbatimi i programit për riorganizimin e shërbimeve në baza rajonale (agregimi)**										
3.1	Zhvillimi dhe nxitja e një programi të bashkërenduar me NJQV për riorganizimin shoqërive egzistuese në shoqëri rajonale, si Subjekte të Kompetencave të Perbashkëta	-	67%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
3.2	Ristrukturimi dhe reformimi institucional në funksion të zbatimit të programit për riorganizimin e shërbimeve në baza rajonale	-	30.0%	40.0%	50.0%	60.0%	70.0%	80.0%	90.0%	100.0%	100.0%
3.3	Ngritja e një sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë dhe impaktit të zbatimit të procesit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale	-	-	50.0%	70.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
3.4	Krijimi i rregulloreve dhe standardeve tip proceduriale të mënyrës së operimit							100%	100%	100%	100%
4	***Përshkrimi i qëllimit të politikës*** **Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare, përballueshmërisë së shërbimeve dhe administrimit të aseteve**										
4.1	Mbulimi i Kostove te Operimit dhe Mirembajtjes (O&M) me Arketimet Korente	80.0%	85%	90%	95%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
4.2	Mbulimi i Kostove Totale te Operimit (KTO perfshire shpenzimet per shlyerjen e kredive dhe fondet per rezervat kapitale) me Arketimet Korente	58.3%	60%	64%	68%	72%	75%	80%	85%	90%	95%
4.3	Rikonceptim dhe vendosje e tarifave të unifikuara per shoqëritë rajonale UK	-	-	35.0%	70.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.4	Rritje e normës së Arkëtimit Korent	72.4%	75.0%	77.0%	85.0%	90.0%	93.0%	96.0%	99.0%	100.0%	100.0%
4.5	Sistem i unifikuar i faturimit në të gjithë shoqërite rajonale UK	-	-	50.0%	75.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.6	Leximi (aksesi) online i faturës për të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	30.0%	50.0%	75.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.7	Sistemi i pagesës onlinë për të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	-	20.0%	30.0%	40.0%	50.0%	60.0%	80.0%	90.0%	100.0%

Nr	Objektivat Strategjike / Indikatorët e vlerësueshëm me %	Viti Bazë 2021	Viti 2022	Plani Viti 2023	Plani Viti 2024	Plani Viti 2025	Plani Viti 2026	Plani Viti 2027	Plani Viti 2028	Plani Viti 2029	Plani Viti 2030
4.8	Standarte të unifikuar për vlerësimin të aseteve në të gjithë shoqërite rajonale UK.	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.9	Sistemi i digjitalizuar për administrimin e aseteve funksional në shoqëritë rajonale UK.	-	20.0%	40.0%	60.0%	70.0%	80.0%	90.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.10	Auditim I Energjisë dhe plani për eficensën e energjisë për të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	-	20.0%	50.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.11	Ndërtimi i sisteme alternative për furnizimin me energji elektrike për 5 shoqëri rajonale UK.	-	-	20.0%	50.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.12	Programi për eficiencën e energjisë funksionale në të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	-	20.0%	35.0%	50.0%	60.0%	70.0%	80.0%	90.0%	100.0%
5	***Përshkrimi i qëllimit të politikës***										
	Rritja e kapaciteteve dhe mirëadministrimi i shërbimeve										
5.1	Plani kombëtar i hartuar për zhvillimin e kapaciteteve në nivel qendror rajonal dhe lokal.	-	-	50%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
5.2	Platforma për zhvillimin e kapaciteteve funksionale dhe e administruar nga AKUM.	-	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%
5.3	Rritja e Buxhetit te alokuar per trajnimin e Stafit te Shoqerive UK (e shprehur si % e buxhetit total te pagave)	-	-	1.0%	1.2%	1.4%	1.5%	1.5%	1.7%	1.8%	2.0%
5.4	Manuali i rishikuar për trajnimin dhe certifikimin e punonjësve të shoqërive rajonale UK.	-	-	50 %	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.5	Programi i certifikimit funksional dhe i administruar nga AKUM.	-	-	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.6	Stafi administrues dhe operues i çdo shoqërie rajonale është i trajnuar dhe certifikuar.	-	-	-	30%	60%	80%	100%	100%	100%	100%
5.7	Strukturë e unifikuar dhe e miratuar në të gjithë shoqërite rajonale UK.	-	20.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.8	Plan dhe buxhet i vënë në dispozicion për infrastrukturën TIK dhe trajnimet e nevojshme sipas axhendes kombetare për digjitalizimin e shërbimeve për furnizimin me ujë dhe kanalizime.	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.9	Platforma digjitale per administrimin e shërbimeve në nivel qëndror, rajonal dhe lokal, që ndërveprojnë në mënyrë efektive.	-	-	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.10	Sistemeve infrastrukturore për furnizimin me ujë dhe kanalizimet, të automatizuara.	-	-	10.0%	20.0%	30.0%	40.0%	50.0%	60.0%	70.0%	80.0%

Nr	Objektivat Strategjike / Indikatorët e vlerësueshëm me %	Viti Bazë 2021	Viti 2022	Plani Viti 2023	Plani Viti 2024	Plani Viti 2025	Plani Viti 2026	Plani Viti 2027	Plani Viti 2028	Plani Viti 2029	Plani Viti 2030
6	***Përshkrimi i qëllimit të politikës***										
	Përmirësimi dhe përditësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator										
6.1	Miratim në parlament i projektligjit për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.	-	50%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.2	Miratim dhe zbatim i akteve ligjorë dhe nënligjorë në zbatim të ligjit për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.	-	-	-	50%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.3	Harmonizimi i plotë i kuadrit ligjor kombëtar për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në përputhje me direktivat europiane	-	-	-	50%	70%	90%	100%	100%	100%	100%
6.4	Studimi Kombëtar për të adresuar Barazinë Gjinore	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.5	Përqindja e përfaqësimit të grave në Këshillat Mbikqyrës është 50%.	-	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.6	Plani kombëtar për informimin dhe ndërgjegjësimin.	-	-	50%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.7	Platformë vjetore për organizimin e fushatave sensibilizuese në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.	-	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.8	Platformë funksionale komunikimi dhe përfaqësimi të njësive dhe komuniteteve lokale në proceset e planifikimit dhe miradministrimin e shërbimeve.	-	-	-	10%	30%	50%	70%	80%	90%	100%
6.9	Aktet e nevojshme rregullatore përkatësisht për licencimin, vendosjen e tarifave, rregullave uniforme etj, janë plotësisht efektive në funksion të aktivitetit për ofrimin e shërbimeve.	-	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Tabela 4: Projektet/Programet kombëtare të zhvillimit për zbatimin e strategjisë

Investimet mbështetëse te politikave strategjike; PBA 2024-2026

Në /000 Lekë

Grupi	Programi	Emri I institucionit	Titulli i projektit	Vlera totale e projektit	Progresi financiar deri ne 2022	Buxheti i miratuar për 2023	Totali i shpenzimeve të investimeve kapitale			
							2024	2025	2026	2027
			Ministria e Infrastruktures dhe energjise							
			Furnizimi me uje dhe kanalizime							
			Totali për programin FB + FH	124,018,254	34,188,934	14,746,246	15,986,266	17,557,825	17,081,326	24,457,655
			Tavanet financim I brendshem	64,518,857	20,242,114	7,317,972	8,813,602	9,423,601	8,947,102	9,774,465
06	06370	AKUM	REFORMA E UJIT		1,000	46,460	50,000	50,000		
06	06370	AKUM	REFORMA E UJIT (Pagesa e kapitalit per SKPUK)		61,200	15,300	0	0		
06	06370	AKUM	REFORMA E UJIT (Ekspert per Transferimin e Aktivitetit sipasVKM)		39,168	15,000	0	0		
06	06370	AKUM	Objekte ne vazhdim	50,777,571	20,140,746	6,436,345	7,348,070	7,565,424	7,202,809	2,245,209
06	06370	AKUM	Objekte te reja	13,741,285	-	-	675,531	958,177	919,293	7,529,255
06	06370	AKUM	Kosto Lokale	-	-	20,000	10,000	25,000	25,000	
06	06370	AKUM	Tvsh	-	-	786,866	730,000	825,000	800,000	
06	06370	AKUM	Tavanet Financimi i Huaj	59,499,396	13,946,820,003	7,428,274	7,172,664	8,134,224	8,134,224	14,683,190

Tabela 5: Investimet përbërese të planeve strategjike për zbatimin e direktivave për ujin e pijshëm dhe ujërat e ndotura

Tabela 5.1. Kosto të investimeve kapitale – Zgjerimi i infrastrukturës (në EUR)

Shoqëri Rajonale (të reja)	Prodhimi I ujit (puse/burime)	Dizinfektimi i ujit	Linjat e dërgimit / Rrjeti shpërndares	Rezervuare	Lidhje shërbimi	Zonat e Mbrojtjes Sanitare (ZMS)	Total	Total 2025-2030
Berat	239,639	1,110,000	7,167,697	356,727	433,270	78,000	**9,385,333**	99,000
Diber	122,141	1,590,000	8,156,536	977,027	479,269	110,000	**11,434,973**	403,000
Durres	421,934	810,000	17,466,606	581,163	1,693,117	60,000	**21,032,819**	8,223,704
Elbasan	1,025,463	1,935,000	25,553,955	1,486,770	1,567,558	136,000	**31,704,746**	965,000
Fier	1,209,835	660,000	27,289,597	1,749,550	2,057,839	51,000	**33,017,821**	4,003,484
Gjirokaster	103,603	1,500,000	4,999,932	681,385	288,789	102,000	**7,675,709**	129,000
Korce	0	2,160,000	3,510,337	80,349	210,936	147,000	**6,108,622**	8,000
Kukes	0	1,020,000	2,165,425	77,574	125,204	71,000	**3,459,203**	533,000
Lezhe	355,060	750,000	10,360,371	510,204	693,737	55,000	**12,724,372**	234,830
Lushnje	811,814	540,000	13,624,181	823,918	953,076	41,000	**16,793,990**	133,000
Pogradec	0	675,000	62,075	0	3,860	47,000	**787,935**	1,000
Sarande	0	435,000	1,813,382	1,211	156,297	30,000	**2,435,890**	1,748,222
Shkoder	1,073,519	1,635,000	30,515,534	1,675,580	2,076,062	111,000	**37,086,694**	4,905,104
Tirane	1,018,501	1,230,000	60,406,526	1,839,744	7,204,311	92,000	**71,791,083**	50,200,999
Vlore	253,840	780,000	5,712,299	353,949	400,523	54,000	**7,554,611**	2,850,064
Total	**6,635,348**	**16,830,000**	**218,804,454**	**11,195,150**	**18,343,849**	**1,185,000**	**272,993,801**	**74,437,405**

Tabela 5.2. Kosto të investimeve kapitale – Rehabilitimi i infrastrukturës (në EUR)

Shoqëri Rajonale (të reja)	Prodhimi I ujit	Dizinfektimi/ Trajtimi I ujit	Linjat e dërgimit	Rrjeti shpërndares	Stacionet e pompimit	Rezervuare	Lidhje shërbimi	Total	Total 2025-2030
Berat	2,797,399	90,000	7,594,018	27,056,744	3,274,867	4,242,980	3,558,690	**48,614,698**	60,000
Diber	2,501,053	60,000	7,137,806	11,960,017	376,518	2,712,500	2,058,210	**26,806,103**	3,218,362
Durres	911,750	560,000	14,694,584	56,521,239	5,288,819	4,901,540	11,273,310	**94,151,241**	74,338,765
Elbasan	4,468,102	90,000	12,200,384	39,348,440	4,006,148	4,109,000	6,379,290	**70,601,365**	610,301
Fier	1,917,915	120,000	14,220,486	27,023,698	5,791,679	3,496,500	4,727,070	**57,297,348**	185,140
Gjirokaster	5,591,505	30,000	11,504,404	19,293,531	1,370,524	4,153,450	2,484,990	**44,428,403**	0
Korce	4451373.96	60,000	13,449,159	17,914,844	2,300,105	3,163,020	4,764,060	**46,102,562**	0
Kukes	2585379.89	60,000	6,132,641	23,332,673	1,591,415	1,084,440	1,063,890	**35,850,439**	13,421,033
Lezhe	2,111,160	60,000	5,036,850	27,141,723	853,440	3,102,400	2,521,620	**40,827,193**	1,026,935
Lushnje	1,034,795	30,000	3,050,677	18,898,774	2,126,907	1,340,500	2,644,740	**29,126,394**	212,974
Pogradec	905354.838	30,000	677,856	7,031,816	553062.666	1,193,500	1,583,820	**11,975,409**	0
Sarande	1675794.18	0	3,082,453	14,263,727	730,444	1,942,500	2,527,740	**24,222,659**	2,893,220
Shkoder	2,933,875	30,000	14,136,058	34,207,434	4,109,900	4,779,600	3,891,870	**64,088,737**	39,775,152
Tirane	1,439,451	90,000	8,753,540	112,044,842	6,138,912	13,819,400	25,106,940	**167,393,085**	15,504,810
Vlore	1,899,966	0	12,006,280	38,619,676	3,248,093	2,973,600	6,052,320	**64,799,935**	49,612,461
Total	**37,224,875**	**1,310,000**	**133,677,197**	**474,659,178**	**41,760,833**	**57,014,930**	**80,638,560**	**826,285,573**	**200,859,153**

Tabela 5.3. Investimet përbërese të planit strategjik për zbatimin e direktivës për trajtimin e ujrave të ndotura urbane

Lloji I Investimit	**Kosto Totale (milion Euro)**	**2025-2030 (milion Euro)**	**2031-2040 (milion Euro)**	**2041-2050 (milion Euro)**
Grumbullim I ujrave të ndotura	1,196.91	219.04	549.89	427.99
Trajtimi I ujrave të ndotura	670.14	139.59	326.78	203.78
Paisje laboratorike	1.00	1.00	-	-
Totali Net Kosto e investimeve kapitale	1,868.06	359.62	876.67	631.77
Kosto inxhinierike dhe shtesa	467.01	89.91	219.17	157.94
Kosto totale e investimeve kapitale	**2,335.07**	**449.53**	**1,095.83**	**789.71**
Masa institucionale (Legala, Politikat etj)	19.5	8.8	10.7	0.0
Grand Totali (milion Euro)	**2,354.57**	**458.33**	**1,106.53**	**789.71**

4. Zbatimi, përgjegjësia e institucioneve, llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi

Hyrje

Ky kapitull paraqet disa udhëzime për mënyrën se si do të zbatohet, monitorohet dhe përditësohet Strategjia aktuale gjatë zbatimit të saj. Është krijuar një sistem koherent monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë që të sigurohet një arritje efikase dhe efektive e objektivave të strategjisë. Bashkërendimi i përgjithshëm i aktiviteteve në lidhje me strategjinë është përgjegjësi e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Çdo vit, MIE do të raportojë mbi përparimin në përmbushjen e objektivave, sa I përket aspektit cilësor dhe sasior të strategjise dhe planeve përkatëse, si dhe do të informojnë rregullisht Kryeministrin mbi zhvillimet në sektor.

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018 "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektoril/ndërsektorial të integruar", u miratua urdhri i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 217, datë 24.05.2019 "Për ngritjen e sekretariatit teknik, në kuadër të funksionimit të grupit tematik reforma e ujesjelles kanalizimeve", ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise luan rolin e sekretariatit teknik për grupin tematik "reforma në sektorin ujësjellës kanalizime".

Me urdherin e Ministri të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.77, datë 20.04.2022 u ngrit Grupi Tematik për Reformën e Riorganizimit të Ujësjellës Kanalizimeve sha, i cili luan edhe rolin e Komitetit Sektorial të Monitorimit të IPA-s për Reformën e Ujit, që drejtohet nga zëvendësministër i infrastrukturës dhe energjisë.

4.1 Planet e detajuara të zbatimit

Siç paraqitet Aneksin 1, çdo Objektiv Strategjik detajohet në Masat Prioritare dhe për cdo Masë Prioritare përcaktohen Planet e Veprimit. Institucionet përgjegjëse, duke përfshirë një Institucion Përgjegjës kryesor (lider), gjithashtu identifikohen dhe përcaktohen për të mbikqyrur zbatimin dhe monitorimin e Planeve e Veprimit për të arritur rezultatet e parashikuara (targetet) të vendosura për afate kohore të shkurtra, të mesme dhe të gjata.

Institucioni Përgjegjës kryesor do të hartojë një plan zbatimi të detajuar për secilën prej Masave Prioritare të përcaktuara, ku do të përshkruhet në mënyre të plotë si do të realizohet arritja e rezultateve të parashikuar. Këto plane të detajuara të zbatimit do të përfshijnë një qasje graduale në përputhje me rezultatet që parashikohet të arrihen për periudhat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Këto plane duhet të përpunohen brenda tre muajve pas miratimit të këtij dokumenti dhe do të konsultohen në vijim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

4.2 Monitorimi dhe Raportimi i Strategjisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për vleresimin, monitorimin e progresit dhe zbatimin e kësaj Strategjie në bashkëpunim me institucionet e ndryshme përgjegjëse.

Monitorimi luan një rol kyç në vlerësimin dhe raportimin e progresit në zbatimin e një strategjie. Për më tepër, ai u ofron palëve të interesuara, në të gjitha nivelet, informacion kyç në lidhje me përparimin e zbatimit dhe sfidat e mundshme, duke bërë të mundur ndërmarrjen e veprime korrigjuese sa herë që është e nevojshme. Procesi i monitorimit duhet të jetë i vazhdueshëm, i qëndrueshëm, i fokusuar dhe i disiplinuar.

Tabela 6: Proçesi i monitorimit

Karakteristikat e proçesit të monitorimit	Veprimet operacionale
I vazhdueshëm	Të kryhet mbi baza vjetore
I qëndrueshëm	Të përdoret e njëjta bazë dhe burim të dhënash në cdo kohë
I fokusuar	Të krahasohen arritjet me rezultatet e parashikuara
I disiplinuar	Të ndiqet një mekanizëm i veçantë monitorimi

- ***Proçes i vazhdueshëm***

Për të monitoruar zbatimin dhe progresin e Strategjisë Kombëtare, Institucioni Përgjegjës kryesor do të përgatitë një raportim vjetor që detajon arritjet në lidhje me Masat Prioritare të caktuara dhe Planet e Veprimit përkatëse.

- ***Proçes i qëndrueshëm***

Institucioni përgjegjës kryesor do të përdorë të njëjtën bazë dhe burim të të dhënave për të monitoruar dhe raportuar përmirësimet dhe rezultatet e arritura në lidhje me masat prioritare të përcaktuara dhe planet e veprimit përkatëse. Në të vërtetë, vendosja e standardeve të qarta për raportimin e të dhënave është kritike për një monitorim efektiv.

- ***Proçes i fokusuar***

Për raportim, progresi i arritur për çdo Masë Prioritare dhe Planet e Veprimit përkatës duhet të jetë qartësisht të detajuara, për të bërë të mundur krahasimin dhe vlerësimin kundrejt Objektivave të Parashikuara në periudhat afat të shkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

- ***Proçes i disiplinuar***

Institucioni përgjegjës kryesor duhet të ndjekë një mekanizëm specifik monitorimi për raportin vjetor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë siç paraqitet në Figurën 5-1 si më poshtë.

Procesi i Monitorimit



4.3. Përditësimi i Strategjisë

Qëllimi përfundimtar i procesit të monitorimit dhe raportimit të Strategjisë, i përshkruar më sipër, është që të sigurohet se zbatimi i Strategjisë dhe përmirësimet e arritura janë realizuar në mënyrë efektive siç është planifikuar.

Kur raporti i përgatitur nga Institucioni Përgjegjës kryesor tregon një devijim ndërmjet rezultateve të parashikuar të ndërmjetem dhe progresit të realizuar, duhet të kryhet një

analize e thellë për të evidentuar shkakun dhe arsyet për devijimin e vërejtur. Kjo diagnozë duhet gjithashtu të përfshijë dhe të përshkruajë veprimet e përshtatshme korrigjuese që duhen ndërmarrë për t'iu përgjigjur problemeve eventuale dhe çështjeve që janë evidentuar dhe ende sigurojnë arritjen e rezultateve të parashikuara. Kur është e nevojshme, rezultatet e parashikuar për afat të shkurtër, të mesëm ose të gjatë mund të rregullohen, duke çuar kështu në një përditësim të Strategjisë. Është e rëndësishme të dallohen veprimet korrigjuese nga përditësimi i Strategjisë. Veprimet korrigjuese nuk synojnë të modifikojnë Objektivat Strategjikë të Strategjisë Kombëtare, por të modifikojnë Planet e Veprimit për të siguruar arritjen e Objektivave Strategjike. Strategjia duhet të përditësohet vetëm kur veprimet korrigjuese mendohet të jenë të pamjaftueshme për të lejuar që Institucionet Përgjegjëse të arrijnë Rezultatet e Parashikuar në kohën e duhur dhe në koston e parashikuar.

Analiza e progresit dhe propozimi i veprimeve korrigjuese do të përgatitet nga Institucioni Përgjegjës kryesor dhe më pas do të diskutohet, rishikohet dhe vlerësohet me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë gjatë një takimi pune përmbledhës të strategjisë.
Në fund të çdo viti, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të konsolidojë raportimin e bërë nga Institucionet Përgjegjëse për të zhvilluar një dokument operacional, duke theksuar progresin e bërë për të arritur të gjitha rezultatet e parashikuara të ndërmjetme dhe identifikimin e boshllëqeve të parealizuara si dhe veprimet korrigjuese të miratuara dhe të zbatuara. Ky dokument përcjellës do të ndihmojë në vlerësimin e efektivitetit të Planeve të Veprimit për të arritur Rezultatet e Parashikuara dhe do të përdoret për të hartae çdo vit një version të përditësuar të Strategjisë Kombëtare.

Procesi i plotë i përditësimit përshkruhet si më poshtë nw mwnyrw skematike.

Procesi i Përditësimit



Tabela 7: Pashaporta e Indikatorëve që do Raportohen nga MIE në Kuadër të SKZHI 2023-2030 dhe që lidhen me SGD 6

Lidhur me indikatorët në kuadër të SKZHI 2023-2030 , dy janë indikatorët për të cilat duhet të raportohet nga sektori UK:

1. Aksesi në Furnizimin me ujë të pijshëm
2. Aksesi në Trajtimin e ujërave të ndotura sipas zonave urbane dhe rurale

Tabela 7.1: Aksesi në Furnizimin me ujë të pijshëm

Inventari i Indikatoreve Furnizimi me Ujë													
Dokumenti Strategjik Referues	Sektorët	Nr.	Treguesit	Institucioni përgjegjës	Përcaktimi/Matja	Burimi	Viti bazë 2021		Vlera e fundit e disponueshme		Synimi 2025	Synimi 2030	Periodiciteti
							2021	Vlera duhet të përcaktohet për vitin 2021	Viti	Vlera	Vlera	Vlera	
Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrim 2023-2030	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	1.1	Mbulimi me Ujësjellës (Niveli Kombëtar)	MIE	% e popullsisë që furnizohet me ujë në zonat urbane dhe rurale	MIE	2021	77.7%	2022	78.3%	82.0%	90%	vjetorë
		1.2	Mbulimi me Ujësjellës për zonat urbane		% e popullsisë që furnizohet me ujë në zonat urbane			92.0%		93.0%	95.0%	99.0%	vjetorë
		1.3	Mbulimi me Ujësjellës për zonat rurale	MIE	% e popullsisë që furnizohet me ujë në zonat rurale	MIE	2021	57.9%	2022	58.0%	64.0%	85.0%	vjetorë
		1.4	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	MIE	Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në zonat urbane dhe rurale	MIE	2021	15	2022	15.5	18	24	vjetorë
		1.5	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë (orë/ditë) për zonat urbane	MIE	Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në zonat urbane	MIE	2021	16	2022	17	20	24	vjetorë
		1.6	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë (orë/ditë) për zonat rurale	MIE	Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në zonat rurale	MIE	2021	12	2022	13	16	24	vjetorë
		1.7	Reduktimi i Ujit pa të Ardhura	MIE	% e UPA si pasojë e reduktimit të saj	MIE	2021	65.4%	2022	64.0%	60.0%	45.0%	vjetorë
		1.8	Niveli i matjes së konsumit të ujit shprehur në numër lidhjesh	MIE	% e popullsisë që matet konsumi I ujit	MIE	2021	78.4%	2022	80.0%	87.0%	100.0%	vjetorë
		1.9	Sisteme automatike të dezinfektimit të ujit të pijshëm për të gjitha shoqëritë rajonale UK	MIE	% e operatorëve/shoqërive që kanë sisteme automatike të dezinfektimit të ujit të pijshëm	MIE	2021	-	2022	-	70%	100%	vjetorë
		1.10	Ngritja e Laboratoreve Rajonal për Cilësinë e Ujit të Pijshëm (15)	MIE	% e operatorëve/shoqërive që kanë laboratoreve rajonal për cilësinë e ujit të pijshëm	MIE	2021	-	2022	-	100%	100%	vjetorë
		1.11	Plane për Sigurinë e Ujit të përfunduara për të gjitha Shoqëritë UK	MIE	% e operatorëve/shoqërive që kanë Plane për Sigurinë e Ujit	MIE	2021	-		-	40%	100%	vjetorë

Tabela 7.2: Aksesi në Trajtimin e ujërave të ndotura sipas zonave urbane dhe rurale

Inventari i Indikatoreve Kanalizime													
Dokumenti Strategjik Referues	Sektorët	Nr.	Treguesit	Institucioni përgjegjës	Përcaktimi/Matja	Burimi	Viti bazë 2021		Vlera e fundit e disponueshme		Synimi 2025	Synimi 2030	Periodiciteti
							2021	Vlera duhet të përcaktohet për vitin 2021	Viti	Vlera	Vlera	Vlera	
Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrim 2023-2030 Deklaratat e Politikave te Programeve, DPP, PBA 2023-2025	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	2.1	Mbulimi me Kanalizime (Niveli Kombëtar)	MIE	% e popullsisë mbulohet me shërbimin e kanalizimeve zonat urbane dhe rurale	MIE	2021	53.0%	2022	53.5%	55.5%	65.5%	vjetorë
		2.2	Mbulimi me Kanalizime për zonat urbane		% e popullsisë mbulohet me shërbimin e kanalizimeve zonat urbane			82.4%		83.0%	84.5%	93.0%	vjetorë
		2.3	Mbulimi me Kanalizime për zonat rurale	MIE	% e popullsisë mbulohet me shërbimin e kanalizimeve zonat rurale	MIE	2021	12.6%	2022	13.0%	15.0%	26.0%	vjetorë
		2.4	Mbulimi me Trajtim të Ujërave të Përdorura nga ITUP	MIE	% e popullsisë mbulohet me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotur urban në zonat urbane dhe rurale	MIE	2021	14.4%	2022	15.0%	16.5%	26.0%	vjetorë
		2.5	Hartimi i planeve për përdorimin e ujit me efikasitet në të gjithë sektorët, duke siguruar furnizim te qëndrueshëm dhe duke rritur ndjeshëm ripërdorimin e tij sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.	MIE	% e operatorëve/shoqërive që kanë plane për përdorimin e ujit me efikasitet në të gjithë sektorët, duke siguruar furnizim te qëndrueshëm dhe duke rritur ndjeshëm ripërdorimin e tij sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.	MIE	2021	-	2022	-	20.0%	100.0%	vjetorë

Plani i veprimit dhe burimet financiare për zbatim

5. Planet e Veprimit në mbështetje të Masave Prioritare

Ky kapitull i Strategjisë Sektoriale paraqet Planet e Veprimit për zbatimin e Masave Prioritare të identifikuara si kusht për arritjen e Objektivave Strategjike. Çështjet e mëposhtme adresohen si mëposhtë:

- Çfarë kërkohet për zbatimin e masës priotitare
- Kush është përgjegjës për zbatimin e masës prioritare
- Kur duhet (dhe mund) të zbatohet masa prioritare, dhe
- Sa do të kushtojë zbatimi i masave prioritare
- Sa do mbulohen nga PBA e rradhës;
- Sa eshte hendeku fiianciar.

Plani i veprimit i detajuar paraqitet në aneksin 1 të strategjisë.

5.1. Nevojat dhe Burimet e Financimit

Ky kapitull i Strategjisë Sektoriale paraqet shpërndarjen e burimeve sipas Vizionit, Misionit, Qëllimet e Politikës dhe Masave Prioritare, të cilat janë trajtuar më parë në këtë dokument, si dhe ndikimet e tyre në lidhje me nevojat për financim në të ardhmen. Këto nevoja për financim mund të mbulohen drejtpërdrejt nga Thesari i Shtetit, nga Donatorët si grante, kredi apo çdo kapital tjetër i parashikuar dhe fondet për asistencë teknike.

Strategjia Sektoriale tashme përfaqëson një angazhim për shpërndarjen e shpenzimeve publike në koordinim të plote me buxhetin vjetor ose afatmesëm. Roli i Strategjisë Sektoriale, sa i përket përcaktimit të nivelit të parashikuara të shpenzimeve kapitale, është të shërbejë si një dokument referimi që orienton planet e ardhshme për shpenzimet buxhetore. Megjithatë, Strategjia Sektoriale shërben për të paraqitur prioritetet në mënyrë të qartë. Në këtë mënyrë, në ndikimet fiskale të politikave të ndërmarra dhe Masave Prioritare janë marrë parasysh të gjitha burimet e mundshme të financimit si dhe eshte percaktuar hendeku financiar.

5.2. Nevojat Kapitale për arritjen e Qëllimeve të Politikës dhe Masave Prioritare

Pas përcaktimit të Treguesve të Performancës, të dhënat e vitit bazë dhe niveli Treguesve të Performancës i përcaktuar si target i arritshëm në vitin 2030, u bë e mundur të përcaktohej nëse do të kishte nevojë për shpenzime kapitale dhe korente për të arritur nivelet e synuara. Në rastet ku kishte nevojë për shpenzime kapitale, u vendos një nivel i matshëm për përcaktimin e këtyre shpenzimeve. Për secilën Masë Prioritare që ndikon në shpenzime kapitale, merret në konsideratë në mënyrë të arsyeshme konvertimin e nivelit të synuar në një kosto kapitale, për shembull: rritja e mbulimit me uji në zonat urbane. Në këtë shembull, numri i lidhjeve të reja të nevojshme për të arritur nivelin e synuar të treguesit të performancës në secilin vit, shumëzohet me një kosto kapitale për njësi të vlerësuar për çdo lidhje të re të shtuar.

Tabela e mëposhtme paraqet kostot kapitale për njësi të përdorura në Modelin Financiar me qëllim llogaritjen e kostove të investimeve kapitale për secilin Objektiv Strategjik:

Tabela 8: Kostot Kapitale për Njësi të përdorura për llogaritjen e Nevojave Kapitale

Kosto	Për lidhje	Për person
	Euro	Euro
Rrjeti Ujësjellës	2,000	600
Rrjeti i Kanalizimeve	4,000	1000
Impianti i Trajtimit	1,000	270
Ujëmatës Familjar	100	100
Ujëmatës Prodhimi	5,000	-
Ujëmatës Zonal	1,000	-

Kostot për njësi për Rrjetin e ri të Furnizimit me Ujë/Kanalizime dhe Lidhjet e Kanalizimeve të lidhura me ITUN janë bazuar në Projektet e Investimeve Kapitale të realizuara kohët e fundit në Shqipëri nga Banka Botërore dhe KfË.

Kosto për njësi për Ujëmatësit Familjar, Ujëmatësit e Prodhimit dhe Ujëmatësit Zonal janë bazuar në Raportin "Plani Kombëtar i Veprimit për Reduktimin e Ujit pa të Ardhura në Shqipëri" hartuar në vitin 2018 nga Qeveria e Shqipërisë me mbështetjen e USAID.

Niveli i Shpenzimeve Kapitale të parashikuara për Rehabilitimin e Rrjetit të Furnizimit me Ujë, është kryesisht rezultat i Planifikimit për Reduktimin e Humbjeve Teknike. Bazuar në "Strategjinë e Financimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve në Shqipëri" supozohet se për reduktimin e Humbjeve Teknike me 1%, nevojitet rehabilitimi i 93km rrjet ujësjellësi.

Për të parashikuar Shpenzimet Korente dhe Kapitale të nevojshme për të arritur Objektivat Strategjikë, janë marrë në konsideratë normat e mëposhtme:

- Norma vjetore e rritjes së popullësisë (INSTAT) është 0.0% (të dhënat e INSTAT referojnë trend në ulje të popullsisë 2017-2020).
- Një lidhje e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve përbëhet nga 4.1 persona (bazuar në të dhënat vjetore të vitit 2021 nga AKUM)
- Një ujëmatës zonal (DMA) për 1,500 lidhje
- Popullsia totale në juridiksionin e bashkive 4,355,649 banorë sipas të dhënave të AKUM (2021) të rakorduara edhe me të dhënat e Rregjistrit të Gjëndjes Civile.

5.3. Nevojat Korente dhe Kapitale

Duke pasur parasysh faktin se Shqipëria nuk ka kapacite të mjaftueshëm në burime njerëzore në institucionet e saj, për të ndërmarrë disa nga planet e veprimit që nuk kërkojnë kapital, do të nevojiten shpenzime kapitale shtesë në formën e asistencës teknike dhe shpenzime kapitale të patrupëzuara. Këto shpenzime të veçanta janë përshkruar në disa prej Planeve të Veprimit dhe janë përmbledhur më poshtë në Tabelën 9 sipas afateve kohore dhe objektivave të parashikuara gjatë periudhës së planifikimit.

5.4. Nevojat Korente dhe Kapitale Totale të Investimeve për Periudhën e Planifikimit

Në Tabelwn 9 janë paraqitur nevojat korente dhe kapitale totale të investimeve në afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, duke marrë në konsideratë:

- Investimet kapitale "të reja" për arritjen e objektivave strategjike të përcaktuara;
- Kapitali i nevojshëm për investimet e "rinovimit, riparimit dhe zëvendësimit"
- Investimet kapitale në formën e asistencës teknike.

Investimet “e reja” dhe investimet për “rinovim, riparim dhe zëvendësim" janë grupuar dhe quajtur “kosto të infrastrukturës” në tabelën e mëposhtme.
Në Strategjinë Kombëtare të Sektorit Ujësjellës Kanalizime 2023-2030, kosto e përgjithshme arrin në rreth **161,832,691,076 Lekë**, ku kostot kapitale zëne **92%** të totali dhe kostot korente **8%**.

Struktura përbërëse e kostove të strategjise sipas Tabeles 9 më poshtë:

Tabela 9: Nevojat Korente dhe Kapitale (në Lekë)

Qëllimi i Politikës	Lloji i kostos	Kosto Totale	Kosto e Planifikuar	Tavanet Buxhetore Planifikuar per vitin 2026	Tavanet Buxhetore Planifikuar per vitin 2027	Tavanet Buxhetore Planifikuar per vitin 2028	Tavanet Buxhetore Planifikuar per vitin 2029	Tavanet Buxhetore Planifikuar per vitin 2030	Hendeku Financiar
		2022-2030	PBA 2023-2025						2026-2030
		Buxheti dhe Donatoret	Buxheti dhe Donatoret	Buxheti dhe Donatoret					Buxheti dhe Donatoret
Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit të furnizimit me ujë	Korente	7,134,646,912	4,933,125,209	4,382,166,797	4,382,166,797	4,382,166,797	4,382,166,797	4,382,166,798	1,138,767,452
	Kapitale	63,644,206,620	42,796,126,883						
Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura për popullsinë.	Korente	4,488,690,740	1,328,575,756	12,317,385,228	12,317,385,228	12,317,385,228	12,317,385,228	12,317,385,227	14,364,821,848
	Kapitale	84,748,814,804	11,957,181,800						
Zbatimi i programit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.	Korente	28,500,000	16,500,000	2,400,000	2,400,000	2,400,000	2,400,000	2,400,000	0
	Kapitale	45,000,000	45,000,000						
Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare dhe përballueshmërisë së shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura sipas parimeve të kontrollit dhe mbulimit të plotë të kostove operacionale.	Korente	551,495,000	0	190,050,519	190,050,519	190,050,519	190,050,519	190,050,519	127,742,408
	Kapitale	526,500,000	0						
Rritja e kapaciteteve dhe miradministrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.	Korente	534,105,000	0	99,984,456	99,984,456	99,984,456	99,984,456	99,984,456	34,182,720
	Kapitale	0	0						
Përmirësimi i qeverisjes dhe kuadrit ligjor/rregullator të sektorit	Korente	130,732,000	89,080,000	8,013,000	8,013,000	8,013,000	8,013,000	8,013,000	1,587,000
	Kapitale	0	0						
TOTALI [Lekë]		161,832,691,076	61,165,589,648	*17,000,000,000*	*17,000,000,000*	*17,000,000,000*	*17,000,000,000*	*17,000,000,000*	*15,667,101,428*
TOTALI [Euro]		1,444,934,742	546,121,336	151,785,714	151,785,714	151,785,714	151,785,714	151,785,714	139,884,834
1 euro 112 Leke									

5.5. Burimi i Financimit

Rritja e nivelit të shërbimit ndaj përdoruesve nënkupton kosto më të larta operimi dhe mirëmbajtje dhe për investimet në shërbimin e furnizimit me ujë. Këto kosto mund të financohen përmes tarifave, taksave dhe transfertave, e ashtuquajtura korniza "3T" hartuar nga OECD (2009).

- Taksat: Fonde të mbledhura nga taksat kombëtare (buxheti i shtetit) që përdoren për të financuar sektorin UK. Për shkak të kufizimeve domethënëse fiskale, fondet e disponueshme që vijnë nga taksat për të financuar sektorin UK janë gjithnjë e më të reduktuara.
- Tarifat: tarifat e konsumatorit ose pagesat (shërbimi i furnizimit me ujë - tarifa për lidhje dhe shërbimin e ofruar – tarifa aforfe / volumetrike) përdoren për të financuar sektorin UK. Ky është burimi më i qëndrueshëm i financimit të sektorit. Megjithatë, çështja e përballueshmërisë dhe përqasja politike e tarifave duhe të merren parasysh.
- Transfertat: grandet nga burime të huaja, asistenca teknike për zhvillim mund të sigurojnë fonde për sektorin UK. Kryesisht këto transferta bëhen përmes programeve dypalëshe dhe përmes Instrumentit të Bashkimit Evropian për Programin e Para-aderimit II (IPA II). Transferta të tilla mund të financojnë një pjesë të shpenzimeve kapitale, por nuk mund të përdoren për të financuar shpenzimet operacionale. Vlen të theksohet se **kreditë shërbejnë vetëm për të zhvendosur pagesat e parave në kohë**. Përfundimisht kreditë duhet të paguhen nga taksat ose tarifat. Kreditë nuk përbëjnë një burim përfundimtar financimi, por janë më tepër një marrëveshje për të shtyrë pagesat nga taksat ose tarifat.

Bazuar në Strategjinë Financiare të Sektorit UK, shpërndarja e burimeve të financimit për të mbuluar të gjitha shpenzimet kapitale të nevojshme, sipas kategorive të mësipërme, do të jetë si më poshtë:

Tabela 10: Burimet e Financimit

Burimi i Financimit	Shpërndarja (në %)
Taksat	25%
Transfertat	30%
Tarifat	45%

Në Tabelën 10 paraqitet shpërndarja e Financimit për të gjithë sektorin duke përfshirë OPEX dhe CAPEX. Shpenzimet Kapitale të nevojshme për të arritur objektivat strategjik të kësaj Strategjie do të financohen kryesisht nga Taksat dhe Transfertat. Tarifat do të jenë burimi kryesor për financimin e Shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes në periudhën afatshkurtër. Më pas, gradualisht niveli i mbulimit të O&M me të ardhurat do të arrijë 100%, kështu që tarifat do të përdoren si burim financimi shtesë për CAPEX.

5.6. Struktura e Tarifave dhe Përballueshmëria

Strategjia Kombëtare e Sektorit UK përfshin gjithashtu përmirësime në vendosjen e tarifave në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Nivelin e mbulimit të kostove nga tarifat.
- Tarifa që bazohen në kosto.
- Politikat tarifore dhe përcaktimi i tarifave do të sigurojnë që shërbimet UK të jenë të përballueshme në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, ku thuhet se *"Tarifat duhet të jenë të përballueshme duke patur parasysh që fatura ujit dhe*

kanalizimeve duhet të jetë jo më shumë se 5 për qind e të ardhurave familjare për familjet me të ardhurat më të ulta"

Aktualisht, situata financiare në shumë shoqëri është e pakënaqshëm pasi të ardhurat e tyre nuk mbulojnë as shpenzimet direkte të operimit. Është e nevojshme që çdo shoqëri UK të mbulojë të paktën kostot direkte operative, por edhe amortizimin dhe pagesat e interesit në rastet kur ato mund të kenë përfituar grante dhe hua për investime.

IV. VLERA E BANESËS PËR TË CILËN LLOGARITET SHUMA E KREDISË

Vlera e banesës për të cilën llogaritet shuma e kredisë bëhet referuar çmimeve mesatare referuese për metër katror, sipas aneksit 1, të vendimit nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme, të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", të ndryshuar, dhe sipërfaqes për përbërje familjare, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

V. RREGULLAT PËR BASHKËRENDIMIN E PUNËS DHE TË PROCEDURAVE SË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE ME MINISTRITË PËRGJEGJËSE PËR STREHIMIN DHE PËR FINANCAT

1. Me miratimin e tavaneve buxhetore dhe nivelin e interesit që do të paguajë punonjësi i administratës, ministri përgjegjës i financave dhe ai përgjegjës për strehimin bëjnë vlerësimet për numrin e kredive të reja që mund të subvencionohen në një vit për punonjës të administratës publike dhe i propozon Këshillit të Ministrave kuotat e përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve, përfitues në administratën publike.

2. Kredia lehtësuese konvertohet në kredi tregtare për rastet, si më poshtë vijon:

a) Drejtpërdrejt në rastet e parashikuara në pikën 3, të nenit 64/4, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", të ndryshuar;

b) Në rastet kur konstatohen deklarime të rreme, sipas pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi;

c) Kur, pas kalimit të afatit 5-vjeçar nga data e lidhjes së kontratës së kredisë, përfituesi largohet me dorëheqje nga vendi i punës. Përjashtim bën rasti kur largimi me dorëheqje pas afatit 5-vjeçar ndodh gjatë vitit të fundit para përfundimit të kontratës së kredisë.

3. Burimet njerëzore të institucionit ku punonjësi i administratës publike ka përfituar kredi të lehtësuar, por është larguar nga detyra, sipas pikës 2, të këtij kreu, njoftojnë Entin Kombëtar të Banesave brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja dijeni, si institucionin monitorues të programit, për ndërprerjen e subvencionimit të kredisë nga buxheti i shtetit. Enti Kombëtar i Banesave e përcjell këtë informacion pranë bankës ku punonjësi ka përfituar kredinë e lehtësuar, si dhe ministrinë përgjegjëse për strehimin.

4. Enti Kombëtar i Banesave realizon verifikime periodike, duke bashkërenduar punën për marrjen e informacionit lidhur me marrëdhënien e punësimit të përfituesve që kanë kredi të lehtësuar me burimet njerëzore të institucionit ku punonjësi është i punësuar.

5. Zbatimi i programit për financimin e interesave të kredive që subvencionohen nga shteti realizohet me bankën/bankat me të cilat lidhet marrëveshja, sipas këtij vendimi.

6. Marrëveshja me bankën lidhet nga ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për strehimin, nëpërmjet përzgjedhjes së ofertës fituese për interesin më të favorshëm për buxhetin e shtetit, si dhe me kushtet më të favorshme për përfituesin, sipas tabelës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Përzgjedhja e bankës/bankave fituese bëhet nga komisioni që ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për financat. Komisioni ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

a) dy përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për financat dhe strehimin, një prej të cilëve kryetar;

b) një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë;

c) një përfaqësues i Bankës së Shqipërisë;

ç) një përfaqësues i Entit Kombëtar të Banesave.

8. Komisioni asistohet nga drejtoria përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për financat.

9. Zbatimi i programit për financimin e interesave të kredive që subvencionohen nga shteti monitorohet nga Enti Kombëtar i Banesave. Banka i dërgon Entit Kombëtar të Banesave raportimet e rregullta tremujore:

a) listën emërore të miratuar për kredi brenda atij muaji;

b) listën emërore të kredive të refuzuara;

c) kopje të kontratës së kreditimit për kreditë e lidhura, si dhe plan-pagesën përkatëse;

ç) vlerën e subvencionit të përllogaritur që duhet të paguhet për çdo përfitues të kredisë;

d) parashikimin vjetor të subvencionit të interesave, si dhe plan-pagesën e kredisë së vitit përkatës për kontratat ekzistuese.

10. Enti Kombëtar i Banesave verifikon përputhshmërinë e listave të përfituesve të dërguara nga banka me listat e dërguara nga struktura përkatëse që trajton administratën publike dhe informon me shkrim ministrinë përgjegjëse për strehimin për ecurinë e programit të kreditimit.

11. Fondi i përcaktuar për subvencionin e kredive të lehtësuara për blerjen e banesës për të punësuarit në administratën publike planifikohet në buxhetin përkatës vjetor të ministrisë përgjegjëse për strehimin.

12. Fondi për subvencionin e kredive të lehtësuara për blerjen e banesës për të punësuarit në administratën publike disbursohet nga ministria përgjegjëse për financat çdo tremujor nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave.

VI. DISPOZITA KALIMTARE

1. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të bëjë të mundur funksionimin e aplikimit *on-line* dhe zhvillimin e procedurave nëpërmjet portalit "*e-Albania*".

2. Deri në datën e fillimit të zbatimit të sistemit *on-line* në portalin "*e-Albania*", të përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, procedura e paraqitjes së kërkesës për kredi të lehtësuar për administratën publike do të kryhet sipas pikave 3 dhe 4 të këtij kreu.

3. Pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 469, datë 26.7.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve, përfitues në administratën publike, për vitin 2023", publikon kuotat në portalin "*e-Albania*" dhe në faqen zyrtare të institucionit.

4. Afati i paraqitjes së kërkesës për kuotat e miratuara dhe të shpallura për çdo institucion është 30 (tridhjetë) ditë nga publikimi i kuotave. Kërkesa paraqitet pranë institucionit ku punonjësi është i punësuar, sipas organizimit të brendshëm të institucionit dhe i drejtohet strukturës së ngritur me urdhër të titullarit përgjegjës për trajtimin e kërkesave për kredi për strehim.

5. Vendimi nr. 452, datë 9.7.2004, i Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e dhënies së kredisë për strehim ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe masën e kësaj kredie", shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Enti Kombëtar i Banesave dhe çdo institucion tjetër i administratës publike, përfitues nga programi i kredive të lehtësuara, për blerjen e banesës për të punësuarit në administratën publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Tabela nr. 1

SIPËRFAQJA E APARTAMENTIT QË PËRFITON I PUNËSUARI NË ADMINISTRATË PËR EFEKT SUBVENCIONIMI TË INTERESAVE TË KREDISË

Tipi i njësisë së banimit	N – Numri i anëtarëve të familjes	Sipërfaqe neto
Studio	1	70
1+1	1–2	90
2+1	3–4	130
3+1	4–6	160

Tabela nr. 2

PIKËZIMI PËR BANKAT

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	**Kostoja më e ulët për buxhetin e shtetit**	**85**
A	Interesi më i ulët, i shprehur me formulën BTh + i%, ku "i" është marzhi (spread) njëvjeçar i ofruar nga banka, i cili nuk duhet të jetë **më i lartë se 1%**	
1.2	**Kostoja më e ulët dhe lehtësitë për përfituesit**	**15**
A	Shuma e kredisë ne raport me vlerën e banesës, ku përqindja më e lartë përfiton vlerësim më të lartë (përqindja më e lartë)	
B	Afati i shlyerjes së kredisë (numri më i madh i muajve)	
C	Të ardhurat mujore minimale (formula që rezulton me të ardhurat minimale të pranueshme)	
Ç	Komisioni i disbursimit (vlera më e ulët)	
D	Komisioni për vlerësimin e kolateralit (vlera më e ulët)	
E	Komision kredie (vlera më e ulët/frekuenca më e ulët)	
F	Komision llogarie (vlera më e ulët/frekuenca më e ulët)	
G	Lloji i kolateralit që pranohet nga banka (fleksibiliteti më i lartë)	
H	Banka duhet të ofrojë shërbimin me shtrirje sa më të gjerë, si dhe të ketë degë në nivel qendër qarku	
I	Kolaterali – banka, sipas rasteve që mund të paraqiten, t'i japë mundësi klientit/familjes, të hipotekojë "gradualisht" një pronë në ndërtim	

VENDIM
Nr. 474, datë 1.8.2023

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË PASURIVE 1/54 DHE 1/44, ME VENDNDODHJE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE TIRANË, ZONA KADASTRALE 8160, DHE PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 219, DATË 21.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pasurive 1/54 dhe 1/44, me vendndodhje në njësinë administrative Tiranë, zona kadastrale 8160, sipas formularit, gjithsej, 1 (një) fletë, dhe plan-rilevimeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Pasuritë e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi i shtohen listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të

njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës", të ndryshuar.

3. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Identifikoi: Albana Hoxha (përgjegjës sektori) Rolf Hyseni (Specialist)
Ervin Nikolla Drejtor i Dajakut

Supervizoi: Alban Dokushi,Drejtor (Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Asetevë dhe Licencimit)

Bashkia : Tiranë

Fusha e perdorimit te Prones Social Kulturore

Aprovoi: Enon Veliaj (Kryetar)

	A			B			C					
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11		
1	8160 Q.R-11,12	1/54	Truall	Lulishte ish piramida	23647		Sherbim	Bashkia Tiranë	Bashkia Tiranë	v.27, fq 131 shtet		
	Q-12	1/44	Truall		185		Sherbim	Bashkia Tiranë	Bashkia Tiranë	v.15, fq 48 shtet		


PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
PRONARI: SHTET
DATE 08.06.2023
QELLIMI: TRANSFERIM
VENDNDODHJA
BASHKIA: TIRANË
DVASHK/ZVASHK: TIRANË JUG
ZONA KADASTRALE: 8160
NUMRI PASURISE: 1/44
INDEX HARTE: TR-Q-12
TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE: TRUALL
SIP. PASURISE = 185 m2
SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT __m2
NUMRI KATEVE__
NUMRI PEMEVE___
X = 485055.60
Y = 4576454.47
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE
X = 485149.76
Y = 4576454.47
N
1/54
1/53
1/44
1/8
1/9
Rr. "Lek Dukagjini"
2/34
1/37
X = 485055.60
Y = 4576389.11
SH 1:500
X = 485149.76
Y = 4576389.11
Nr. ORIENTIMI PERDORIMI TIPI KUFIRIT KUFITARI ID/NIPT SHENIME TE REALIZUESIT
1 VERI VERI: 1/54
2 LINDJE LINDJE: 1/54
3 JUG JUG: 1/54
4 PERENDIM PERENDIM: 1/54
REALIZOI PER BASHKINË TIRANË
EMRI: RAIF HALIDINI
SPECIALISTI: ING. TOPOGRAF
REALIZOI PER ASHK
SPECIALISTI _____
DVASHK _____
NENSHKRIMI _____
KONFIRMOI
PERGJEGJESI/DREJTORI_____
NENSHKRIMI / VULA _____
TEKNOLOGJIA E MATJEVE: ORTOFOTO E MATJE DISTANCASH
PERCAKTIMI KUFIRIT:_____
SHENIME TE VECANTA:
PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET
KONFIRMOI
DREJTORI I DPJAL: ALBAN DOKUSHI
NENSHKRIMI / VULA


PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
PRONARI: SHTET
DATE 08.06.2023
QELLIMI: TRANSFERIM
VENDNDODHJA
BASHKIA: TIRANË
DVASHK/ZVASHK: TIRANË JUG
ZONA KADASTRALE: 8160
NUMRI PASURISE: 1/54
INDEX HARTE: TR-Q,R-11,12
TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE: TRUALL
SIP.PASURISE= 23647 m2
SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT:_____m2
NUMRI KATEVE_____
NUMRI PEMEVE_____
X = 484915.95
Y = 4576573.15
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE
X = 485142.68
Y = 4576573.15
N
BULEVARDI "DESHMORET E KOMBIT"
Rr. "Lek Dukagjini"
1/1
1/2
1/3
1/4
1/5
1/6
1/8
1/9
1/10
1/12
1/13
1/14
1/15
1/16
1/37
1/44
1/53
1/54
2/30
2/31
X = 484915.95
Y = 4576358.02
SH 1:1000
X = 485142.68
Y = 4576358.02
Nr. ORIENTIMI
1 VERI
2 LINDJE
3 JUG
4 PERENDIM
PERDORIMI
TIPI KUFIRIT
KUFITARI
VERI: 1/4;1/5;1/3;1/6
LINDJE: 1/8
JUG: 1/2;1/15;1/37;1/10
PERENDIM: 1/2
ID/NIPT
SHENIME TE REALIZUESIT
REALIZOI PER BASHKINË TIRANË
EMRI: RAIF HALIDINI
SPECIALISTI: ING. TOPOGRAF
REALIZOI PER ASHK
SPECIALISTI _____
DVASHK _____
NENSHKRIMI _____
KONFIRMOI
PERGJEGJESI/DREJTORI_____
NENSHKRIMI / VULA _____
TEKNOLOGJIA E MATJEVE: ORTOFOTO E MATJE DISTANCASH
PERCAKTIMI KUFIRIT:_____
SHENIME TE VECANTA:
PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET
KONFIRMOI
DREJTORI I DPJAL: ALBAN DOKUSHI
NENSHKRIMI / VULA

VENDIM
Nr. 483, datë 1.8.2023

PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. SHKËLQIM AGOLLI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", dhe të vendimit nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2023", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Shkëlqim Agolli, në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 435, datë 25.7.2023

PËR MIRATIMIN E "RREGULLORES PËR METODOLOGJINË E PËRCAKTIMIT TË MASËS SË DËNIMIT NË PROCESIN E INSPEKTIMIT TË ZYRËS SË MBROJTJES NGA RREZATIMET PËR SUBJEKTET QË USHTROJNË VEPRIMTARI ME BURIME RREZATIMI JONIZUES PA LICENCË"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 48, pika 8, të ligjit nr. 10433, datë 16.6. 2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 10, pika 2, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative",

URDHËROJ:

1. Miratimin e "Rregullores për metodologjinë e përcaktimit të masës së dënimit në procesin e inspektimit të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet për subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime rrezatimi jonizues pa licencë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

RREGULLORE
PËR METODOLOGJINË E PËRCAKTIMIT TË MASËS SË DËNIMIT NË PROCESIN E INSPEKTIMIT TË ZYRËS SË MBROJTJES NGA RREZATIMET PËR SUBJEKTET QË USHTROJNË VEPRIMTARI ME BURIME RREZATIMI JONIZUES PA LICENCË

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të parashikojë parimet dhe kriteret e përgjithshme mbi të cilat bazohet Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, këtu e në vijim "ZMR", për përcaktimin e masës së dënimit administrativ në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar; nenit 48/8 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; nenit 7/1, 10, 18 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative", si dhe rregulloreve përkatëse në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese.

Neni 2
Parimet bazë

1. Parimet themelore në bazë të të cilave udhëhiqet ZMR-ja janë: ligjshmëria, barazia dhe mosdiskriminimi, proporcionaliteti, objektiviteti,

mbrojtja e të dhënave personale; parimi i drejtësisë dhe paanësisë.

2. Në përcaktimin e masës së dënimit, në rastin kur ligji ka parashikuar kufij minimalë e maksimalë të vlerës së gjobës, ZMR-ja shqyrton kundërvajtjen administrative duke marrë parasysh:

a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;

b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;

c) rëndësinë e kundërvajtjes;

d) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

Neni 3
Kriteret për caktimin e masës së dënimit administrativ

1. Rriskun që paraqet veprimtaria bazuar në frekuencën e rriskut dhe pajisjet/burimet radioaktive që ka në përdorim subjekti i inspektuar.

2. Rreziku që mund të krijohet për shëndetin e punonjësve, të popullatës dhe dëmtimi i mjedisit.

3. Nëse subjekti kundërvajtjes rezulton, se është i dënuar /i padënuar administrativisht për shkeljen e konstatuar.

Neni 4
Mënyra e caktimit të dënimit

1. Sanksioni administrativ që zbatohet për çdo shkelje caktohet duke respektuar parimin e propocionalitetit në raport me shkeljen e konstatuar, nenin 10 të ligjit nr. 8025/1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues", të ndryshuar, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative", mbi kriteret për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, si dhe parashikimet e kësaj Rregulloreje.

2. Në rastin kur subjekti vijon të kryejë aktivitetin pa licencë dhe rezulton të jetë përsëritës i së njëjtës shkelje administrative, ZMR-ja vendos dënimin maksimal me gjobë, duke mbajtur në konsideratë rrethanat rënduese, rriskun që paraqet veprimtaria me burime rrezatimi jonizues, sipas parashikimeve të kësaj Rregulloreje.

3. Subjekti informal që ushtron veprimtari me burime rrezatimi jonizues, i cili refuzon të identifikohet apo në rastet kur ZMR-ja e ka të vështirë e të pamundur identifikimin e tij, ka të drejtën të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e kontrollit të identitetit të personit që ka kryer kundërvajtjen administrative, bazuar në nenet 37 dhe 42 të ligjit nr. 1043,3 datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

4. Përveç sanksionit administrativ të vendosur për secilën nga kundërvajtjet e parashikuara në këtë Rregullore, ZMR-ja merr masa urgjente kur subjektit të inspektuar i konstatohen nivele të larta të rrezatimit tej normave të lejuara, ndotje të mjedisit që kërcënojnë shëndetin e popullatës, apo situata që krijojnë emergjencë radiologjike.

Neni 5
Sanksionet administrative

1. Sanksionet administrative për kundërvajtjet e parashikuara në këtë Rregullore janë:

a) paralajmërim;

b) dënim administrativ ku sanksionohet masa e gjobës;

c) dënim administrativ bllokim/pezullim aktiviteti.

2. Sanksioni "paralajmërim" është akt administrativ që ka për qëllim këshillimin, paralajmërimin dhe lënien e afatit për kundërvajtësit, për të respektuar/zbatuar parashikimet e ligjit nr. 8025/1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues", të ndryshuar, duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit publik, apo kur ekzistojnë rrethanat lehtësuese.

3. Në rast të ushtrimit të veprimtarisë me burime rrezatimi jonizues, në kundërshtim me nenet 4 dhe 5 të ligjit nr. 8025/1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues", të ndryshuar, ose përsëritjeje të kryerjes të së njëjtës kundërvajtje apo të një kundërvajtjeje administrative tjetër sipas kësaj rregulloreje apo legjislacionit në fuqi, jepet sanksioni administrativ me gjobë.

4. Dënimi administrativ bllokim pezullim aktiviteti përcaktohet si masë urgjente në pikën 7/b të VKM-së nr. 10/2010, "Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime rrezatimi jonizues", në rastet kur subjektit i konstatohen nivele të larta të rrezatimit tej normave të lejuara, ndotje të mjedisit që kërcënojnë shëndetin e popullatës, apo situata emergjente.

Neni 6
Lloji dhe masa e dënimit për kundërvajtjet administrative

1. Dënimi administrativ kryesor "Paralajmërim" për subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime rrezatimi jonizues, kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X ose burime radioaktive që nuk janë të pajisur me licencë ose subjekte informale, që inspektohen për herë të parë, ju përcaktohet afati deri në 60 ditë për aplikimin në ZMR dhe dorëzimin e plotë të dokumentacionit për t'u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë me burime të rrezatimit jonizues.

2. Dënimi administrativ kryesor "Gjobë", në masën 100.000 lekë, për subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime rrezatimi jonizues (gjeneratorë me rreze X, burime radioaktive kategoria 4, 5), të cilëve:

a) ju ka përfunduar afati i licencës dhe nuk kanë zbatuar plotësisht parashikimet sipas nenit 6, pika 1, të kësaj Rregullore;

b) kanë aplikuar për licencë/rinovim licence, por nuk e kanë përfunduar procedurën administrative brenda afatit për t'u pajisur me licencë dhe nuk kanë zbatuar plotësisht parashikimet sipas nenit 6, pika 1, të kësaj Rregullore.

3. Dënimi administrativ kryesor "Gjobë", në masën 200.000, për subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime rrezatimi jonizues (burime radioaktive kategoria 3), të cilëve:

a) ju ka përfunduar afati i licencës dhe nuk kanë zbatuar plotësisht parashikimet sipas nenit 6 pika 1 të kësaj Rregullore;

b) kanë aplikuar për licencë/rinovim licence, por nuk e kanë përfunduar procedurën administrative brenda afatit për t'u pajisur me licencë dhe nuk kanë zbatuar plotësisht parashikimet sipas nenit 6, pika 1, të kësaj Rregullore.

4. Dënimi administrativ kryesor "Gjobë", në masën 300.000, subjektit të inspektuar që ushtron veprimtarinë me burime rrezatimi jonizues pa licencë (burime radioaktive kategoritë 1 dhe 2) të cilëve:

a) ju ka përfunduar afati i licencës dhe nuk kanë zbatuar plotësisht parashikimet sipas nenit 6, pika 1, të kësaj Rregullore;

b) kanë aplikuar për licencë/rinovim licence, por nuk e kanë përfunduar procedurën administrative brenda afatit për t'u pajisur me licencë dhe nuk kanë zbatuar plotësisht parashikimet sipas nenit 6, pika 1, të kësaj Rregullore.

5. Dënimi administrativ kryesor "Bllokim i aktivitetit me burime rrezatimi jonizues". Dënimi administrativ kryesor "Bllokim i aktivitetit" hyn te masat urgjente dhe merret kur subjektit të inspektuar i konstatohen nivele të larta të rrezatimit tej normave të lejuara, ndotje të mjedisit që kërcënojnë shëndetin e popullatës, apo situatash emergjente etj., sipas nenit 43, pikat 1/a dhe b, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Dënimi administrativ kryesor "Bllokim i aktivitetit" aplikohet si dënim në subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues të kategorive I, II ose III deri në momentin e ushtrimit të veprimtarisë, në përputhje me kërkesat ligjore. Bllokimi i aktivitetit mund të shoqërohet edhe me dënime të tjera plotësuese.

Neni 7
Rrethanat lehtësuese

1. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethana lehtësuese jepet dënimi administrativ me paralajmërim ose dënimi administrativ në minimum të masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje. Rrethana lehtësuese janë rrethanat si vijon:

a) kundërvajtësi është në proces administrativ për rinovimin e licencës dhe nuk rezulton përsëritës i kësaj shkelje më parë;

b) kundërvajtësi ka eliminuar vullnetarisht pasojat e ardhura nga shkelja e kryer, subjekti ka qenë në pamundësi objektive për të rinovuar licencën (për shkak të rrethanave të rënda personale).

Neni 8
Rrethanat rënduese

1. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethana rënduese, jepet dënimi maksimal i masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje. Rrethana rënduese janë rrethanat si vijon:

a) kundërvajtësi vazhdon veprimtarinë e paligjshme edhe mbas kërkesës për ta ndërprerë atë;

b) veprimtaria me burime rrezatimi jonizues paraqet rrisk të lartë;

c) subjekti është ripërsëritës i së njëjtës shkelje.

URDHËR
Nr. 439, datë 25.7.2023

PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE, NËNPRODUKTEVE TË TYRE, MATERIALIT BIOLOGJIK, EMBRIONEVE, MISHIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA KOSOVA

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në nenet 42 dhe 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve e kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Kosovës:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Kosovë	Gjilan*	
Kosovë	Prizren*	

1.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

1.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe

vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit.

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.

1.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e

Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 440, datë 25.7.2023

PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE, NËNPRODUKTEVE TË TYRE, MATERIALIT BIOLOGJIK, EMBRIONEVE, MISHIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA MAQEDONIA E VERIUT

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenet 42 dhe 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Maqedonisë së Veriut:

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë***	**Ndarja administrative e nivelit të tretë**
Češinovo-Obleševo	Ularci*	
Delcevo*		
Karbinci	Karbinci*	
Kočani*		
Kratovo*		
Gostivar*		
Kriva Palanka*		
Kumanovo	Kumanovo*	
Kumanovo	Dolno Konjare*	
Kumanovo	Ljubodrag*	
Kumanovo	Tabanovce*	
Kumanovo	Recica*	
Makedonska Kamenica	Moshtica*	
Makedonska Kamenica	Preseka*	
Makedonska Kamenica	Glavovica*	
Novo Selo	Novo Selo	
Probištip	Drenok*	
Probištip	Shtalkovica*	
Probištip	Stalkovica*	
Rankovce	Otosnica*	
Staro Nagoričane	Staro Nagoričane*	
Staro Nagoričane	Arbanasko*	
Staro Nagoričane	Tromegja*	
Štip	Štip*	
Vinitsa	Vinitsa*	
Vinitsa	Vinicka Krshla*	
Vrapčište*		
Novatsi*		

Shënime. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet

1.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së sipas rastit.

1.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.

1.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe

janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Urdhri nr. 440, datë 25.7.2023, "Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Maqedonia e Veriut", shfuqizohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 115
Datë: 2023/08/02 15:14:00
9ea8d66a-bb88-4ef8-a1d7-7b20a6eb413f

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 480 lekë